

**ISBN 978-9989-857-12-6**

**Titulli:** Raport alternativ i organizatave joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për gjendjen e të drejtave të fëmijut në Republikën e Maqedonisë

**Botues:** Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi - Republika e Maqedonisë

**Drejtor egzekutiv dhe themelues:** M-r Dragi Zmijanac

**Autor:** Koalicioni nacional për të drejtat e fëmijut

**Mentor/editues:** Gordana Pirkovska Zmijanac

**Ekipi i projektit:** Tatjana Janevska, katerina Koneska, Jagoda Naskovska, Angelina Çalakovska, Roza Vasilevska

**Redaktimi:** Svetlana Mulkueen, Ketii Jandrijeska Jovanova

**Përkthim dhe lektorim:** Florim Ismailovski

**Dizajnimi i kopertinës:** Besnik Selmani

**Pregaditje grafikuere dhe shtypje:** Jugorekllam

**Tirazhi:** 100 copë

**Adresa e botuesit:**

Ambasada e Parë e fëmijëve në botë MEGJASHI  
1000 Shkup, Kosta Novakoviç 22 a, Maqedoni  
Tel. +389 2 2465 316; i-mejli/faks: +389 2 2463 900  
SOS telefoni për të rinj dhe fëmijë: 0800 1 2222  
[info@childrensembassy.org.mk](mailto:info@childrensembassy.org.mk)  
[www.childrensembassy.org.mk](http://www.childrensembassy.org.mk)

**Raport alternativ i organizatave  
joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për  
gjendjen e të drejtave të fëmiut në  
Republikën e Maqedonisë**

## PARATHËNIE

Para Jush është raporti Alternativ ose i a.q. Raport në hije të pregaditura nga koalicioni Nacional i organizatave joqeveritare për të drejtat e fëmiut.

Konventa për të drejtat e fëmiut - KDF u soll nga Asambleja e Përgjithshme e KB me 20.11.1989 dhe hyri në fuqi me 2.9.1990. Të drejtat e shënuara në KDF i definojnë parimet univerzale dhe normat për statusin e fëmiut. Sot, sa më shumë bëhet e qartë se qeveritë vetë nuk kanë mundësi që vetë dhe në mënyrë të plotë ti sigurojnë të drejtat e fëmiut pa pjesëmarrjen e shoqërisë në përgjithësi dhe në këtë drejtim OJQ-të luajnë rol fundamental në implementimin e KDF. Ajo është njëra nga shkaqet plus të cilët mundësuan që nga KDF sot të bëhet instrumenti më i rrespektuar gjerësisht me parimet e së cilit u pajtuan pothuajse të gjitha vendet. Republika e Maqedonisë u bashkangjiti KDF në Nëntorë të vitit 1993.

Me qëllim që të përparohet implementimi i KDF-së, u krijuan Protokole të veçanta me të cilat shtetet që i kanë ratifikuar duhet gjithashtu të raportojnë se si shkon implementimi i tyre. Protokoli Fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmiut për tregti më fëmijë, prostitucionin fëmijëror dhe pornografinë fëmijërore u soll në Nju Jork me 25 Maj të vitit 2000, ndërsa i ratifikuar nga ana e Republikës së Maqedonisë me 17 tetor të vitit 2003. Protokoli fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmiut për involvim të fëmijëve në konflikte të armatosura u soll në Nju Jork me 25 Maj të vitit 2000, ndërsa u ratifikuar nga republika e Maqedonisë me 12 Janar të viti 2004. Në pajtim me nenin 118 të Kushtetutë së republikës së Maqedonisë: “Marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me Ligj”.

Raportin e parë për gjendjen me të drejtat e fëmijëve, shteti nënshkrues patjetër duhet që ta dërgoje 2 vite pas ratifikimit të Konventës. Më tej, raporte kërkohen çdo 5 vite, me mundësi për

raporte shtesë në ndërmjet-periudhë, nëse kjo është e nevojshme. Në vitin 2007, Republika e Maqedonisë e dorëzoi raportin e dytë periodik për KDF, ndërsa në vitin 2008 raportet Inicuese për protokolet fakultative.

Të gjitha raportet i shqyrton Komiteti për të drejtat e fëmijut praën OKB-së, i cili mblidhet disa herë në vit në Gjenevë. Kur do ti fitojë Komiteti raportet shtetërore, më tej kërkon informata të shkruara nga organizatat joqeveritare ose ndërqeveritare. Për këtë qëllim OJQ-të nëpër gjithë botën mblidhen në koalicione Nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijut (koalicioni i Maqedonisë u formua me 13 nëntor të vitit 1997 me zyrën e saj -sekretariatit në ambasadën Fëmijërore Megjashi) që të mundën më së miri të përgjigjen në kërkesat e Komitetit. Nga koalicionet nacionale në veçanti kërkohen informata të rëndësishme dhe të besueshme nga lëmitë ku raporti shtetëror nuk jep sqarime të mjaftueshme, dhe nga lëmi të cilat nuk janë të përfshira, ose sipas mendimit të anëtareve të koalicionit janë të përfshira, por nuk janë plotësisht të sakta. Gjithashtu duhet që ti ndihmojnë Komitetit që të fitojë një pamje të qartë për atë se këta raporte a e tregojnë situatën reale të fëmijëve dhe të fitohet qasje alternative për raportin qeveritar, të vendos prioritete dhe ti përcaktoje pyetjet kryesore deri te qeveritë.

Gjatë kohës së takimit preliminary, Komiteti për të drejtat e fëmijut i merr parasysh të gjitha informatat e rëndësishme nga OJQ-të. Më pas, në takimin plenar, Komiteti i thërret përfaqësuesit e qeverive që të përgjigjen në pyetje të caktuara, por gjithashtu i thërret edhe nga një ose dy përfaqësues nga koalicionet joqeveritare. Në fund të dialogut, Komiteti i pregadit aspektet kryesore dhe rekomandimet deri te Qeveria.

Gjatë kohës së takimeve preliminare, anëtarët e Komitetit pregadisnin një listë të pyetjeve të cilat dërgohen deri te qeveritë. Nga qeveritë kërkohet që të përgjigjen në ata pyetje me shkrim. Rolin që e kanë OJQ-të shihet edhe në këtë që vijon: në rast se situatë në vend është serioze, me rrezik që të vazhdojë të keqësohet, organizata joqeveritare mund që të kërkojë procedurë urgjente nga Komiteti. Ai mund ta vizitojë shtetin ose t'ia bart komunikimin

ndonjë organi tjetër të OKB-së, përkatësisht nga Qeveria të kërkojë informata shitesë për gjendjen. Qeveria ka kohë që të përgjigjet para se procedura e Komitetit të bëhet publike. Komiteti nuk përgjigjet për raste individuale.

Me qëllim që në mënyrë adekuate të përgjigjet në kërkesat e Komitetit për të drejtat e fëmiut, në Vjeshtë të vitit 2008 ambasada e Parë fëmijërore në botë Megjashi filloi me realizimin e projektit Ndërtimin e kulturës së pjesëmarrjes fëmijërore si pjesë e programit për Mbrojtje dhe promovim të të drejtave të fëmiut. Aktivitetet ishin të drejtuara kah inkuadrimi më aktiv në procesin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve, jo vetëm nga organizatat qytetare, por edhe nga fëmijët dhe të rinjtë dhe pjesëmarrja e tyre aktive në hartimin e çështjeve shoqërore nga lëmi të ndryshme, e të cilat janë në interes të fëmiut. Për të pregaditur një raport më gjithëpërfshirës, ambasada e Fëmijëve Megjashi u ofroi numrit më të madh të organizatave të cilat janë aktive në lëmi të ndryshme të të drejtave të fëmiut, që të kyçen në Koalicion dhe bashkarisht ti pregadisnin raportet. U mbajtën tre trajnime dhe tre punëtori të drejtuara kah përfundimi i kapaciteteve të OQ në monitorimin e implementimit të Konventës për të drejtat e fëmiut nga OKB, protokolet Fakultative dhe instrumentet tjera internacionale të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmiut.

Si rezultat i gjithë procesit të pregaditjes, në fund dolën raportet alternative të cilat i keni para Jush. Ata paraqesin qasje të sublimuara të anëtareve të koalicionit për gjendjen me të drejtat e fëmiut në republikën e Maqedonisë. Të pregaditen këta raporte nuk ishte lehtë, përveç koordinimit me të gjitha organizatat, vështirësi paraqiste edhe ajo se për çka më së tepërmi duhet që të alarmojmë, duke i pasur parasysh problemet e shumta në lidhje me implementimin e të drejtave të fëmiut në Republikën e Maqedonisë.

I faleminderojmë Delegacionit të Unionit Evropian dhe UNICEF-it për mbështetjen në procesin e hartimit të këtyre raporteve.

Gordana Pirkovska Zmijanac  
Menaxhuese e programit dhe themeluese  
Ambasada e Parë për fëmijë në botë Megjashi

## PËRMBAJTJA:

<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>3</b>
<b>QASJE NDAJ PËRPLIMIT TË RAPORTIT ALTERNATIV</b> .....	<b>11</b>
<b>TABELA E SHKURTESAVE</b> .....	<b>13</b>
<b>1. HYRJE</b> .....	<b>15</b>
<b>2. REZIME</b> .....	<b>16</b>
<b>3. MASAT E PËRGJITHSHME TË IMPLEMENTIMIT</b> .....	<b>17</b>
3.1 KORRNIZA LIGJORE.....	17
3.2 REALIZIMI IT Ë DREJTAVE DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE NË VEND..	19
3.3 PLANI NACIONAL PËR AKSION : IMPLEMENTIMI, KOORDINIMI DHE EVALUIMI .....	20
3.4 STRUKTURAT E PAVARURA MONITORUESE.....	21
3.5 AVOKATI I POPULLIT .....	23
3.6 BUXHETI .....	25
3.7 EVIDENTIMI, GRUMBULLIMI DHE SELEKTIMI IT Ë DHËNAVE.....	26
3.8 BASHKËPUNIMI .....	28
a) <i>Bashkëpunimi me sektorin qytetar</i> .....	28
b) <i>Bashkëpunimi ndërkombëtar</i> .....	29
3.9 SHPËRNDARJA E KONVENTËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE TRAJNIMI .	30
<b>4. DEFINIMI I TERMIT FËMI</b> .....	<b>34</b>
<b>5. PARIME TË PËRGJITHSHME</b> .....	<b>37</b>
5.1 BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI (NENI 2) .....	37
5.2 INTERESI MË I MIRË U FËMIUT (NENI 3).....	39
5.3 E DREJTA E FËMIUT NË PJESËMARRJE DHE RRESPEKTIMI I MENDIMIT TË FËMIUT (NENI 12) .....	40
<b>6. LIRITË DHE TË DREJTAT E QYTETARËVE</b> .....	<b>43</b>
6.1 E DREJTA NË EMËR DHE IDENTITET (NENI 7 DHE 8) .....	43
6.2 LIRIA E SHPREHJES (NENI 12 DHE 13) DHE E DREJTA E INFORMIMIT (NENI 17) .....	46
6.3 LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE FESË (NENI 14) .....	48
6.4 LIRIA E SHOQËRIMIT DHE TUBIMIT PAQËSOR (NENI 15) .....	49
6.5 E DREJTA E PRIVATËSISË (NENI 16).....	50
6.6 MBROJTJA NGA TORTURA OSE VEPRIM TJETËR I ASHPËR, JONJERËZOR, VEPRIMIT DEGRADUES OSE DËNIMIT (NENI 37 A).....	52
6.7 FËMIJË TË PRIVUAR NGA LIRIA DHE NDËSHKIMI I TË MITURVE (NENI 37) ...	55
a) <i>Shtëpia edukativo-përmirësuese - Tetovë</i> .....	55

<i>6) Burgu për të mitur - Ohër</i> .....	58
<b>7. AMBIENTI FAMILJAR DHE KUJDESI ALTERNATIV</b> .....	<b>60</b>
7.1 AMBIENTI FAMILJAR .....	60
7.2 SHËRBIME ALTERNATIVE PËR FËMIJËT E PRIVUAR NGA PËRKUJDESJA PRINDËRORË (NENI 20) .....	62
7.3 ADOPTIMI I VENDIT DHE ADOPTIMI I HUAJ (NENI 21) .....	66
7.4 KEQPËRDORIMI I FËMIJËVE, LËNJA PAS DORE DHE DHUNA (NENI 19) .....	67
<i>a) Dhunë në arsim</i> .....	67
<i>b) Dhuna në familje</i> .....	70
<b>8. SHËNDETËSIA DHE NDIHMA SOCIALE</b> .....	<b>72</b>
8.1 SHËNDETI DHE SHËRBIMET SHËNDETËSORE (NENI 24) .....	72
8.2 SHËNDETI I ADOLESCENTËVE .....	74
<i>a) Hulumtimi global për shëndetin e adoleshentëve</i> .....	74
<i>b) Aktivitete për mbrojtje nga HIV/SIDA</i> .....	76
8.3 FËMIJË MË NEVOJA TË POSAÇME (NENI 23) .....	77
8.4 SIGURIM SOCIAL DHE SHËRBIME E ENTE PËR MBROJTJEN SOCIALE TË FËMIUT (NENI 18.3 DHE 26) .....	79
8.5 STANDARDET JETËSORE (NENI 27) .....	82
<b>9. ARSIMI, KOHA E LIRË DHE AKTIVITETET KULTURORE ( NENI 28, 29 DHE 31)</b> .....	<b>84</b>
9.1 ARSIMI FILLOR .....	84
9.2 ARSIMI I MESËM .....	88
9.3 REKREIM, SPORT DHE AKTIVITETE KULTURORE .....	91
<b>10. MASA SPECIALE MBROJTËSE</b> .....	<b>93</b>
10.1 REFUGJATË DHE FËMIJË TË ZHVENDOSUR NË BRENDI (NENI 22) .....	93
10.2 EKSPLOATIMI EKONOMIK (NENI 32) .....	94
<i>a) Fëmijët e rrugës</i> .....	96
10.3 EKSPLOATIMI SEKSUAL DHE TREGTIA ME FËMIJË (NENI 34 DHE 35) .....	98
10.4 SHFRYTËZIMI I FËMIJËVE NË PRODHIMIN ILLEGAL DHE TREGTINË ME DROGA DHE SUPSTANCA NARKOTIKE (NENI 33) .....	99
<i>a) Adoleshentë të cilat injektojnë droga</i> .....	102
10.5 JURISPRUDENCA PËR TË MITUR (NENI 37, 39 DHE 40) .....	105
10.6 FËMIJË QË U PËRKASIN MINORITETEVE .....	107
<b>REKOMANDIME KRYESORE:</b> .....	<b>108</b>
<b>RAPORT ALTERNATIV</b> .....	<b>110</b>
<b>I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NDAJ RAPORTIT INICUES TË REPUBLICËS SË MAQEDONISË SIPAS PROTOKOLIT FAKULTATIV TË KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIUT NË LIDHJE ME TREGTINË ME FËMIJË, PROSTITUCIONIN FËMIJËROR DHE PORNOGRAFINË FËMIJËRORE</b> .....	<b>110</b>



<b>(NGA SHKURTI I VITIT 2008).....</b>	<b>110</b>
<b>TABELA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>111</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>112</b>
<b>2. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME.....</b>	<b>114</b>
<b>3. TË DHËNA, ANALIZA DHE STATISTIKA.....</b>	<b>115</b>
3.1 PROSTITUCIONI I FSHEHUR DHE TREGTIA ME NJERËZ .....	115
3.2 KEQTRAJTIMI SEKSUAL DHE PEDOFILIA.....	119
<b>4. MASA TË PËRGJITHSHME TË IMPLEMENTIMIT.....</b>	<b>121</b>
<b>5. PARANDALIMI .....</b>	<b>122</b>
<b>6. NDALESA .....</b>	<b>125</b>
<b>7. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE .....</b>	<b>126</b>
<b>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME:.....</b>	<b>132</b>
<b>TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NDAJ RAPORTIT INICUES SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PAS PROTOKOLIT FAKULTATIV NDAJ KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIUT PËR INVOLVIM TË FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA (NGA NËNTORI I VITIT 2008).....</b>	<b>134</b>
<b>TABELA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>135</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>136</b>
<b>2. PARANDALIMI .....</b>	<b>139</b>
<b>3. MBROJTJA, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI.....</b>	<b>141</b>
3.1. REFUGJATËT NGA KOSOVA .....	141
3.2 PERSONA TË ZHVENDOSUR NË BRENDI (PZHB).....	142
3.3 MASA PËR MBROJTJE.....	145
<b>4. DISEMINIMI I PROTOKOLIT DHE TRAJNIME.....</b>	<b>146</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>147</b>
<b>INFORMATA PËR ORGANIZATAT - ANËTARE TË KOALICIONIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E FËMIUT .....</b>	<b>149</b>

***Koalicioni nacional për të drejtat e fëmijut  
Republika e Maqedonisë***

*i koordinuar nga Ambasada e Parë e fëmijëve në botë MEGJASHI*

*1000 Shkup, Kosta Novakoviç 22 a, Maqedoni*

*Tel. +389 2 2465 316; i-mejli/faks: +389 2 2463 900*

[info@childrensembassy.org.mk](mailto:info@childrensembassy.org.mk)

[ëëë.childrensembassy.org.mk](http://ëëë.childrensembassy.org.mk)

**RAPORT ALTERNATIV**

i organizatave joqeveritare ndaj Raportit të Dytë periodik shtetëror sipas Konventës për të drejtat e fëmijut ( nga Qershori 2007) dhe ndaj gjendjes së të drejtave të fëmijut në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2009

**Shkup, 2009**

## **Qasje ndaj përplimit të raportit Alternativ**

Raporti Alternativ i OJQ-ve sipas raportit të Dytë periodik shtetëror pas Konventës për të drejtat e fëmijut dhe për gjendjen me të drejtat e fëmijut deri në vitin 2009 është i përpiluar nga koalicioni Nacional për të drejtat e fëmijut - Republika e Maqedonisë - KNDF (Koalicion joformal e formuar në vitin 1997) si aktivitet nga projekti i ambasadës së Parë në botë MEGJASHI. Për nevojat e përpilimit të këtij raporti në vitin 200- u zgjerua dhe u riformua ky KNDF me orgqanizata të reja anëtare dhe dy koalicione ( të gjitha janë anëtare të reja përveç Këshillit për preventivë nga delikuenca për të mitur nga Kavadari dhe ambasada e parë e fëmijëve në bitë Megjashi).

Në përpilimin e raportit Alternativ morrën pjesë (21) organizata qytetare dhe (2) koalicione të organizatave qytetare:

- 1. Asociacioni për Inicijativa Demokratike (ADI) - Gostivar**
- 2. Asociacioni për edukatë shëndetësore dhe kërkim - HERA- Shkup**
- 3. Inicijativa qytetare e grave Antiko - Kërçovë**
- 4. Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë - Shkup (koalicion i 17 OJQve)**
- 5. Lajfstart - Manastir**
- 6. Maqedonia pa diskriminim (bashkësi e 11 OJQve)**
- 7. Forumi rinor edukativ - Shkup**
- 8. Dera e Hapur - La Strasa - Shkup**
- 9. Hapeni dritaret - Skopje**
- 10. Post polio grupi për mbështetjen e Polio Plus - Shkup**
- 11. Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi - Shkup**
- 12. Phurt - Delçevë**
- 13. Këshilli për preventivë nga delikuenca për të mitur - Kavadar**

- 14. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë - Shkup.**
- 15. HOPS Opcione për jetë të shëndoshë - Shkup**
- 16. Shoqata Humanitare Nëna - Kumanovë**
- 17. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Dibër.**
- 18. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Gostivar.**
- 19. Qendra për bashkëpunim Ballkanik “ Loja” - Tetovë**
- 20. Qendra për iniciativë qytetare - Prilep**
- 21. Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve - Shkup**
- 22. Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë**
- 23. Shellter qendra - Shkup**

Metodologjikisht ky raport e ndjek strukturën e raportit të Dytë periodic shtetëror pas Konventës për të drejtat e famiut.

## TABELA E SHKURTESAVE

<b>AID</b>	Adoleshentë të cilat injektojnë droga
<b>BPSH</b>	Bruto Prodhimi Shtetërorë
<b>OQ</b>	Organizata Qytetare
<b>PFM</b>	Parlamenti i fëmijëve në Maqedoni
<b>PF</b>	Parlamenti i Fëmijëve
<b>EU</b>	Unioni Europian
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>KPF</b>	Konventa për të drejtat e fëmijut
<b>ENP</b>	Enti ndëshkimor përmirësues
<b>KPT</b>	Komiteti për parandalim nga tortura
<b>Konventa 182</b>	Konventa kundër formave më të këqija të punës fëmijërore
<b>PID</b>	Persona të cilët injektojnë droga
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MPPS</b>	Ministria për punë dhe politikë sociale
<b>MASH</b>	Ministria për Arsim dhe Shkencë
<b>HMK</b>	Hulumtim Multiindikues dhe Kllasterik
<b>AMSHA</b>	Akademia Maqedonase e shkencës dhe arteve
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>PNA</b>	Plani Nacional për Aksion
<b>PN</b>	Plani Nacional
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OECD</b>	Organizata Ekonomike për Bashkëpunim dhe Zhvllim
<b>OPAC</b>	Protokoli Fakultativ për kyçjen e fëmijëve në aktivitete dhe konflikte të armatosura
<b>OJPH</b>	Organizata joqeveritare “ Porta e Hapur”
<b>OPSC</b>	Protokoli Fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionit ne fëmijë dhe pornografinë fëmijërore
<b>Megjashi</b>	Ambasada e Parë fëmijërore në botë „Megjashi“
<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë

<b>ESHMSH</b>	Enti Shtetërorë për mbrojtje shëndetësore
<b>KR</b>	Këshilli Radioudifuziv
<b>SPB</b>	Spektori i punëve të brendshme
<b>SNS</b>	Sëmundje ngjitëse seksuale
<b>UNICEF</b>	Fond për fëmijë pranë Kombeve të bashkuara
<b>UNGAS</b>	Sesioni Special i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për HIV - SIDË-n
<b>HERA</b>	Asociacioni për edukatë dhe hulumtim shëndetësorë
<b>HOPS</b>	Organizata Joqeveritare “ Opcione për jetë të shëndoshë”
<b>CSR</b>	Qendra për punë sociale

## 1. HYRJJE

<sup>1</sup> Republika e Maqedonisë (RM) në vitet e fundit tejkaloi shumë pengesa politike dhe ekonomike, por nga pikëpamja e të drejtave të fëmiut përparimi është i kufizuar. Evidenca që është e dhënë në Analizën e gjendjes me fëmijtë në RM nga Shkkurti i vitit 2008<sup>1</sup> argumenton se situata me fëmijët në Maqedoni në shumë gjëra bëhet më e vështirë. Edhe përkundër reformave të shumta ligjore dhe hartimin e politikave, fëmijët dhe familjet e tyre, veçanërisht fëmijët e varfur dhe familjet e varfura i lëshojnë të drejtat e realizimit të së drejtës në perkujdesje shëndetësore dhe edukim si dhe të drejtat për pjesëmarrje dhe kyçje.

<sup>2</sup> Gjatë përpilimit të raportit inicues në vitin 1996 nga ana e shtetit ishin të konsultuara organizatat qytetare, por gjatë hartimit të raportit të dytë periodik në vitin 2007 ky konsultim ishte i lënë pas dore.

<sup>3</sup> Në raportin e dytë periodik shteti nuk jep një pamje për gjendjen aktuale të të drejtave të fëmiut për atë se cka ka bërë por vetëm për atë se çka planifikon që në të ardhmen të bëjë. I gjithë raporti më së tepërmi është i orientuar kah ndryshimet ligjore dhe kah ajo se çka parashikojnë këta norma ligjore, ndërsa më pak ose në disa pjesë të veçanta aspak nuk përmendet se si këta norma ligjore aplikohen në praktikë.

<sup>4</sup> Poashtu, në disa vitet e fundit, jo çdo herë përputheshin lëmitë e interesit të shtetit me politikat e implementuara, kështu ndoshte që në disa raste të egzistojë një qëllim, të përmbarohen politika të tjera, ndërsa të sillen zgjidhje ligjore krejtësisht të ndryshme. Si shembull do ta përmendim qëllimin e shtetit që ta lehtësoje realizimin e së drejtës së fëmiut në emrin e tij personal me bartje të ingerencave nga Ministria e punëve të brendshme (MPB) në Ministrinë e drejtësisë. Ky qëllim ishte i shpallur publikisht, por në bazë të ndryshimeve më të reja ligjore paraqitja e fëmiut të posalindur

---

<sup>1</sup> UNICEF

prapëseprap mbetet në ingerenca të MPB, por dënimet për kundërvajtje u rritën. Kjo na shtyn në atë se praktikisht edhe pse egzistojnë ndryshime në ligje, të njejtat nuk janë pozitive dhe të njejtat rezultojnë në demotivimin e qytetarëve.

<sup>5</sup> Ndryshimet kadrovike në administratën publike tregojnë se nuk vlerësohet shumë ekspertiza dhe njohuria e njerëzve, veçanërisht në lëminë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

## **2. REZIME**

<sup>6</sup> Këtë vit Konventa për të drejtate fëmijut (KDF) e kremtoi 20 vjetorin e saj. Për fat të keq, në RM edhepërkundër përpjekjeve për përmirësimin e të drejtave të fëmijëve dhe ndryshimeve të shumta ligjore, ende të drejtat e fëmijëve në tërësi nuk janë të mbrojtura. Në disa raste kjo ndodh për shkak të lëshimeve ligjore, por në disa raste ku egziston një kornizë e mirë ligjore ndodh që lëshimi të bëhet gjatë implementimit të Ligjit.

<sup>7</sup> Raporti Alternativ përmban një numër të madh të problemeve me të cilat ballafaqohen fëmijtë në RM dhe rekomandime se si të tejkalohen të njejtat. Para së gjithash jepet një përshkrim i gjendjes dhe nevojës që të punohet në lëminë e ratifikimit të të gjitha dokumenteve ndërkombëtare të cilat i sigurojnë mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, si edhe krijimin e kornizës së tërësishme ligjore në Republikë. Këtu bën pjesë edhe nevoja për ratifikimin e Konventës së Këshillit Europian për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual, ratifikimin e Konventës për mbrojtje të të drejtave të personave me nevoja të posaçme në suaza të OKB dhe sjelljen e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi përmes të cilit do të dizajnohen masa të cilat nuk do të lënë zbrazëtira ligjore për tolerimin e cilitdo lloj të diskriminimit. Poashtu, është e nevojshme të bëhet edhe plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit mbi familjen, Ligjit për mbrojtje sociale, Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve etj. Gjithashtu, formimi i Avokatit të Popullit për fëmijë si një institucion i posaçëm i cili në tërësi do të përkushtohet në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është njëra nga rekomandimet



më të rëndësishme për çka më detalisht është e sqaruar në raportin Alternativ.

<sup>8</sup> Përceç problemeve të përgjithshme dhe rekomandimeve që i përmban raporti, janë të përpunuara edhe mjaft probleme specifike nga tejkalimi i së cilëve varet edhe niveli i mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të fëmijëve.

### **3. MASAT E PËRGJITHSHME TË IMPLEMENTIMIT**

#### ***3.1 Korrniza Ligjore***

<sup>9</sup> Si pjesë e procesit eurointegruar korrniza ligjore vazhdimisht ndryshon. Këta ndryshime janë të shpeshta dhe të shpejta dhe të njëjtat bëhen pa analizë të gjendjes paraprake dhe përcaktimit të nevojave reale. Nuk ka të vendosur një sistem për ndjekjen e asaj se si implementohen ligjet, as që kemi informatë se është bërë analizë adekuate sa mjete janë të nevojshme për implementimin e ligjeve. Vetëm si shembull të ndryshimit të ligjeve janë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi familjen, Ligjit për mbrojtje sociale, Kodit penal (KP), Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, Ligjin mbi arsimin fillor, Ligjin mbi arsimin e mesëm, sjelljen e Ligjit për të drejtat e të miturve etj.

<sup>10</sup> Në vitin 2009 u sollën ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi mbrojtjen e fëmijëve. Ligji në vend që të kufizohet vetëm në trajtimin e ngushtë të të drejtave të fëmijëve, ai përpunon çështje nga sfera e marrëdhënieve të punës, organizimin e foshnjoreve, mbrojtjen gjyqësore dhe kompetencat e gjyqeve, sfera sociale, mosdiskriminimi e të ngjajshme. Me të njëjtën krijohet konfuzion për qytetarët që është e kundërt me qëllimin përshkak të së cilit propozohen këta ndryshime, e ajo është mbrojtje më e madhe e të drejtave të fëmijëve në një procedurë të qartë dhe koncize.

<sup>11</sup> Në këto ndryshime propozohet që të shtohet një nen i ri i cili e siguron të drejtën e fëmijut që ta shpreh mendimin e tij në pajtim me

një procedurë të caktuar dhe me ligj, pa mos precizuar në cilën procedurë gjyqësore, para cilit organ dhe në pajtim me cilin ligj. Kjo zgjidhje apsolutisht është e paaplikueshme në praktikë dhe e njëjta edhe një herë është e dënuar që ta fitojë epitetin “ fjali e vdekur në letër” në vend se të përfaqësojë përmirësimin e të drejtave të fëmijëve.

<sup>12</sup> Në lidhje me definimin e terimt fëmi, në propozim ndryshimet është ofruar një zgjidhje e pakënaqshme për të cilën reagan edhe ekspertët e pranishëm kur si fëmijë konsiderohet personi deri në mbushjen e moshës 18 vjeçare, por “ personi me të meta në zhvillimin trupor dhe mental llogaritet si fëmijë deri në mbushjen e moshës 26 vjeçare”. Është e paqartë pse është ofruar ky definicion i çuditshëm kur legjislacioni i vendit njih një procedurë të hjekjes së aftësisë afariste për të cilën të drejtë ekskluzive për të vendosur në lidhje me këtë ka organi gjyqësor.

<sup>13</sup> Më tej propozohen një sërë nenesh në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga diskriminimi. Edhe ta lëmë pas dore dilemën se pse normohet diskriminimi në veçanti në këtë ligj kur është në sjellje e sipër Ligji kundër diskriminimit, prapë mbisundon mendimi i ekspertëve se ndryshimet e ofruara krijojnë më tepër konfuzion sesa që metevërtetë i mbrojnë fëmijtë.

<sup>14</sup> Kështu në nenin e njëjtë rregullohet ndalimi i diskriminimit së bashku me llojet e tjera të ndalesave ( Shoqërimi fetar, përdorimi i substancave narkotike, aktivitete ushtarake e të ngjajshme), që në fund të lihet mundësia që secili qytetarë të paraqesë para organit kompetent çfarëdo forme të diskriminimt. Prap logjikisht shtrohet pyetja se kush është ai organ ku qytetari mund të paraqesë diskriminimin dhe në çfarë procedure.

<sup>15</sup> Edhe pse qytetari mund të paraqesë çfarëdo forme tjetër të diskriminimit, prap definicionet e veçanta të diskriminimit të direkt dhe indirekt taksativisht u përkasin vetëm rasteve të diskriminimit përshkak të përkatësisë racore, etnike etj.

<sup>16</sup> Poashtu, në ligj rregullohet se diskriminimi gjatë kryerjes së

detyrës zyrtare është bazë për përgjësi disiplinore dhe më tutje udhëzohet që mbrojtje të kërkohet në procedurën administrative, që në nenin tjetër të përcaktohen edhe llojet e padive që mund të parashtrihen në Procedurën gjyqësore civile.

<sup>17</sup> Jo më pak keqardhëse janë edhe ndryshimet e propozuara në dispozitat kundërvajtëse të ofruara nga njëri prej ekspertëve që kanë punuar në hartimin e ligjit. Kështu, me të njejtat dispozita rregullohet dënimi i barabartë ose më i lartë për kryerjen e kundërvajtjes administrative se sa për maltretim fizik ose psikik, ndëshkim ose veprim tjetër jonjerëzorë ose keqpërdorimin e fëmijëve.

<sup>18</sup> Shembulli më poshtë ilustron se si qëndrimet për të drejtat e fëmijëve negativisht ndikojnë në implementimin e Konventës.

**SHEMBULLI 1:**

Fëmiut i cili ka paraqitur dhunë familjare i është thënë dënimi me mbykqyrje të forcuar nga ana e prindërve nën kontrollin e organit social, përshkak se Qendra ka vlerësuar se "...familja ka potencial që të kujdeset për të miturin, i mituri gjindet në shtëpi, ndërsa me tërë familjen punohet në tejkalimin e konfliktit", ndërsa nga kontrollimi i mjekut, i bërë pas një viti që nga moment ii paraqitjes së rastit, është përcaktuar se fëmiu seksualisht ka qenë i keqtrajtuar nga ana e më tepër personave (nga të cilat njëri mund të jetë edhe babai) dhe i është shënuar terapi me tableta Dijazepam nën mbikqyrjen e prindërve. Pas kësaj mase fëmiu ka tentuar që të bëjë vetëvrasje.

**Rekomandimi 1:**

Ndryshime urgjente të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

***3.2 Realizimi i të drejtave dhe funksionimi i institucioneve në vend***

<sup>19</sup> Në lidhje me punën e gjyqeve dhe Prokurorisë publike patjetër e kemi të potencojmë se asnjëri nga këto organe gjatë punës së tyre nuk e përdor KDF. Bile ka raste ku të njejtat na sqarojnë se rregullat ligjore janë më të forta sesa Konventa dhe mu për këtë të njejtën nuk mundën që ta aplikojnë në mënyrë direkte. Si shembull

do ta përmendim një rast në Prokurorinë themelore në Shtip dhe në gjykatën Themelore të Shtipit, ku ishte hedhur poshtë padia penale e paditëses për veprën penale “Sulm gjinor ndaj fëmijut” me sqarimin se sipas KP të RM-së fëmijë konsiderohet individi deri në moshën 14 vjeçare.

<sup>20</sup> Patjetër duhet të potencojmë se mbikqyrja ndaj punës së Qendrave për punë sociale (QPS), në bazë të Ligjit për mbrojtje sociale është nën kompetencën e Ministrisë për punë dhe politikë sociale (MPPS). Për fat të keq, edhepërkundër egzistimit të normave ligjore për aktivitetet të cilat Ministria mund që ti merr në rast të veprimit kundërligjorë nga ana e qendrave, Ministria rrallë reagon me aktivitete konkrete për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

#### **SHEMBULLI 2:**

E palejueshme është që nga ana e MPPS, e cila ka aq ingerenca dhe kompetenca, e para së gjithash OBLIGIM QË TË KUJDESET PËR TË DREJTAT E FËMIUT, në kallzimin tonë se egzistojnë thyerje të të drejtave nga ndonjë person në një lëndë konkrete ndaj të drejtave të fëmijut që të jeo sqarim se lënda është e mbyllur duke marrë parasyshtë atë se nuk ka prova se personi në fjalë e ka kryer veprën penale dhe nuk kanë përcaktuar asnjë lloj malltretimi, ndërsa nga ana tjetër Inspektorati shtetëror për arsim( i cili ka dalë në shkollë) dhe ka konstatuar se “egziston dyshimi se edukuesi ka kryer maltretim fizik dhe psiqik ndaj fëmijëve nga ky institucion edukues” dhe ka propozuar që edukuesi të largohet nga vendi i punës dhe kundër tij të ngrihet procedura kundërvajtëse, ndërsa njëkohësisht ka ngritur edhe kallzim penal kundër edukuesit deri te Prokuroria publike themelore.

### ***3.3 Plani nacional për aksion : implementimi, koordinimi dhe evaluimi***

<sup>21</sup> Përshkak të brengosjes se nuk egziston mekanizëm përgjegjës për vlerësimin dhe koordinimin e implementimit të Konventës, Komiteti rekomandoi që shteti tja transferojë përgjegjësinë kryesore për koordinim dhe vlerësim të aplikimit të konventës në një mekanizëm.

<sup>22</sup> RM solli planin Nacional për aksion (PNA) për fëmijtë (2006-2015) në të cilin është potencuar se me miratimin e tij do të ketë për qëllim që të forcohet roli i fëmijëve dhe të jipet prioritet absolut të drejtave dhe intereseve të tyre, ndërsa për realizimin e planit në të gjitha fazat etij, është e nevojshme kyçja e të gjitha faktorëve relevant dhe resurseve që janë në disponim nga sektori qeveritar dhe joqeveritar në vend.

<sup>23</sup> Mirëpo në sjelljen e planit Nacional (PN) dhe përcaktimit të aktiviteteve të cilat duhet që të ndërmerren me qëllim që të mbrohen të drejtat e fëmijëve u harrua participimi i fëmijëve dhe të njejtit aspak nuk ishin të kyçur në procedurën për sjelljen e planit.

<sup>24</sup> Në vitin 2007 u formua komisioni Nacional për të drejtat e fëmijëve me qëllim që të përforcohet implementimi i planit.

### ***3.4 Strukturat e pavarura monitoruese***

<sup>25</sup> Qeveria e RM-së, duke vepruar sipas rekomandimeve të komitetit për të drejtat e fëmijëve të OKB në seancën e 28-të të mbajtur me 05.05.2005, solli vendim për formimin e komisionit Nacional për hartimin dhe implementimin e PNA për fëmijët në RM.

<sup>26</sup> Me qëllim që të rritet kredibiliteti i komisionit Nacional dhe që ti mundësojë autoritet më të madh në kryerjen e funksioneve Qeveria e RM-së në seancën e mbajtur më 17.09.2007 solli vendim të ri për themelimin e Komisionit Nacional për të drejtat e fëmijëve në RM. Në pajtim me këtë vendim, rolin koordinues e ka Sekretari gjeneral i Qeverisë, ndërsa anëtarët e Komisionit nga ministrinë kompetente dhe institucione tjera janë nga rradhët e punonjësve shtetërorë me titull këshilltarë shtetërorë. Avokati i popullit të RM-së, i obliguar për të drejtat e fëmijëve, UNICEF dhe shoqatat e qytetarëve: Ambasada e Parë e fëmijëve në botë Megjashi (APFB) dhe Parlamenti i fëmijëve në Maqedoni (PFM), poashtu janë anëtarë të Komisionit Nacional.

<sup>27</sup> Në punën e Komisionit nuk janë të inkuadruar përfaqësuesit e autoriteteve të decentralizimit edhe përkundër asaj se pjesa më e

madhe e obligimeve janë të ndërlidhura ngushtë me aktivitetet e komunave.

<sup>28</sup> Roli i këtij Komisioni sillet në marrjen vesh rreth disa aktiviteteve të cilat nuk janë prioritet të Komisionit, siç është për shembull hartimi i një broshure për të drejtate fëmijut. Komisioni për përgaditjen e broshurës mbajti katër mbledhje në vend se ta definojë gjendjen me të drejtat e fëmijëve dhe të reagojë deri tek të gjitha institucionet për implementimin e KDF.

<sup>29</sup> Raporti i Komisionit nuk është i hapur për publikun. Në raportin për vitin 2008 deri tek i cili erdhi APFB dhe PFM kryesisht janë të dhëna vetëm konstatime nga rrethi i punës së ministrive, ndërsa nuk janë të locuara problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët në shtet dhe propozime për tejkalimin e tyre. Raportet dërgohen dhe mbarojnë në Qeveri pa asnjëfarë hapash tjera për aksion. Në atë mënyrë Komisioni vendoset në rolin e mbrojtësit të shtetit, në vend që ta mbikqyrë implementimin e të drejtave të fëmijëve. Ajo disponon me një buxhet mjaft të vogël, është konstatuar se nuk egzistojnë plane dhe politika specifike për realizim në lidhje me disa çështje që kanë të bëjnë me fëmijët.

<sup>30</sup> Më tej vetë struktura e komisionit Nacional është në kundërshtim me rregullat e Konventës, pasi që në të kanë të drejtë që të marrin pjesë APFB dhe PFM, ekspertë për fëmijë dhe institucione tjera shkencore dhe edukative nga kjo lëmi, por nuk kanë të drejtë në marrjen e vendimeve. Poashtu, fëmijët nuk marrin pjesë në komisionin Nacional.

<sup>31</sup> Konsiderojmë se pavarësisht nga ajo që Komisioni për të drejtat e fëmijëve e ngrit nivelin me participimin e këshilltarëve shtetërorë dhe ka dhënë detyrime që ta monitorojë implementimin e KDF, si edhe afirmimin e PN, nuk meriton që ta kryejë këtë funksion si mbikqyrës, pasi që njëherit i ka rolet e hartuesit, implementuesit dhe monitoruesit. Në veçanti është ajo që në këtë komision anëtare janë vetëm dy organizata qytetare të cilat marrin pjesë në diskutimet për implementimin e KDF dhe afirmimin e PNA, por pa të drejtë të

vendimmarrjes. patjetër duhet që të potencohet fakti se roli afirmativ i Komisionit është shumë i dobët, pothuajse i padukshëm.

<sup>32</sup> Në lidhje me PNA mungon definimi faktografik në lidhje me principet, përkatësisht se si realizohet PNA në lidhje me parimet (në veçanti mendojmë në parimin e pjesëmarrjes së fëmijëve).

### **Rekomandimi 2:**

Pavarësia më e madhe dhe transparenca e komisionit Nacional.

Kyçje aktive e fëmijëve në punën e saj.

Rritja e numrit të OJQ-ve të cilët marrin pjesë në punën e komisionit Nacional dhe dhënien e së drejtës për vendimmarrje të OJQ-ve.

### ***3.5 Avokati i popullit***

<sup>33</sup> Në lidhje me Avokatin e Popullit, nga ana e OJQ-ve është konstatuar se egziston motivim më i madh dhe bashkëpunim me këtë institucion, por rekomandohet rritja e ingerencave të tij. Është e nevojshme që të bëhet ngritja dhe ekipimi i zyrës e cila punon në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, e para së gjithash specializimi i tyre vetëm në këtë lëmi (avokati i popullit i cili punon në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, punon edhe në lëmi tjera siç është shëndetësia etj.)

<sup>34</sup> Edhe pse APFB që në vitin 1996 zotohej për formimin e një institucioni të veçantë Avokati i popullit për fëmijë (ombudsman për fëmijë), ky institucion është i sjellur vetëm në nivel të njërit nga zavendësit e avokatit popullor. Edhe pse Qeveria në raportin e saj jep informata për mbrojtësin e të drejtave të fëmijëve dhe punën e tij, patjetër duhet që të përmendim se bëhet fjalë për një departament të veçantë i cili merret me të drejtat e fëmijëve, por zavendës avokati popullor i cili punon në të drejtat e fëmijëve, punon edhe në lëndët nga shëndetësia dhe nga lëmitë e tjera tematike.

<sup>35</sup> Avokati popullor i fëmijëve duhet që të ketë ingerenca që të bëjë hetime, të ngrejë padi penale, të udhëheqë procedura dhe të bëjë mbikqyrje dhe në rezultatin përfundimtar të procedurës.

<sup>36</sup> Në lidhje me egzistimin e Zyrës për mbrojtjen e të drejtave të fëmiut në kuadër të institucionit avokati i popullit konsiderojmë se egziston nevoja për ngritjen e ndërgjegjes në këtë zyrë, si tek fëmijët ashtu edhe tek prindërit, por edhe tek shkollat e ndryshme.

<sup>37</sup> Poashtu, do të kishim dashtur që ta potencojmë faktin se egziston mundësia ligjore dhe obligimi për paraqitjen e veprave penale: Neni 142<sup>2</sup> nga KP parasheh se organet shtetërore, institucionet që bëjnë autorizime publike dhe personat e tjerë juridik janë të obliguara që ti paraqesin veprat penale për të cilat bëhet ndjekja ose ex-officio (sipas detyrës zyrtare) për të cilat janë të lajmëruar ose për të cilat do të marrin vesh në ndonjë mënyrë tjetër.

<sup>38</sup> Në bazë të të dhënave me të cilat disponon Koalicioni, avokati popullor gjatë gjitha këtyre viteve ka paraqitur vetëm dy deri në tre padi penale. Në asnjërin nga rastet të cilat i kemi ne - anëtarët e Koalicionit, avokati i Popullit nuk ka paraqitur padi penale në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmiut. Pas mosreagimit të tij, OJQ-të janë të detyruara që në mënyrë të pavarur të ngrejë padi penale deri tek prokuroria Publike.

### **Rekomandimi 3:**

Të formohet avokati popullor për fëmijësi institucion i veçantë dhe i ndarë i cili tërësisht do u përkushtohet mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

---

2

#### **Neni 142**

(1) Organet shtetërore, institucionet që bëjnë autorizime publike dhe subjektet e tjera juridike janë të obliguar që ti paraqesin veprat penale për të cilat ndjekja behet në mënyrë zyrtare, për të cilat janë të informuar ose për të cilat do të kuptojnë në ndonjë mënyrë tjetër.

(2) Duke paraqitur padi, paraqitësit nga paragrafi 1 i këtij Neni do ti numërojnë dëshmitë që i kanë të njohura dhe do të ndërmarrin masa për tu ballafaquar me gjurmët e veprës penale, mjetet mbi të cilët ose me ndihmën e së cilëve është kryer vepra penale dhe dëshmitë e tjera.

(3) Secili është i obliguar që të paraqesë veprën penale për të cilin ndjeket sipas detyrës zyrtare.

(4) Me ligj përshkruhen rastet në të cilat mosparaqitja e veprës penale paraqet vepër penale.



### 3.6 Buxheti

<sup>39</sup> Edhe përkundër egzistimit të trendeve pozitive në buxhetet dhe shpenzimet në disa lëmi, sikurse janë mjetet e ndara për arsimim, shëndetësinë parabdakuese, në disa lëmi raporti i pregaditur nga ana e UNICEF-it përcaktoi një pakujdesi në punën buxhetuese. Sipas përvojës së OJQve<sup>3</sup> të cilat marrin pjesë në pregaditjen e këtij raporti, por edhe sipas Shkimit të shpenzimeve publike të dedikuara për fëmijët, Shkurt 2009 UNICEF, lëmitë të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme janë:

<sup>40</sup> Arsimi

- Një pjesë e rëndësishme e rritjes së fondeve për sektorin e arsimit është kanalizuar në dy programet kryesore të qeverisë: arsimin të detyrueshëm të mesëm dhe projektin Kompjutor për secilin fëmijë. Investimet në dimensione të tjera të cilësisë në arsimin, si të tilla janë fondet e dedikuara për Byronë për Zhvillimin e Arsimit për zhvillimin e kurrikulumeve dhe trajnim të mësimitdhënësve ose investimeve në ndërtimin e godinave shkollore dhe rindërtimin e tyre, janë rritur, por jo me të njëjtin ritëm.

Duke marrë parasysh rezultatet e dobëta arsimore të nxënësve, veçanërisht mësimin e shkrim-leximit themelor, duket se është më e rëndësishme që të investohet në komponentet themelore të cilësisë së arsimit.

- Zhvillimi i hershëm i fëmijërisë (nëpërmjet të finansimit të qendrave parashkollore dhe për kujdesin e fëmijëve) nuk është i financuar sa duhet, sidomos duke pasur parasysh kthimin e madh të investimeve në zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e fëmijës. Përkundër të gjitha mjeteve në arsim të cilat janë mbi mesataren e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), fondet e destinuar për zhvillimin e fëmijërisë së hershme janë dukshëm nën mesataren e OECD-së .

\*Edhe pse janë caktuar fonde të veçanta për arsimimin dhe zhvillimin e fëmijëve romë, këto fonde janë të vogla, si një

---

<sup>3</sup> Pamje e të dalave publike të dedikuara për fëmijët, Shkurt 2009 UNICEF

pjesëmarrje në nevojat e rëndësishme nga investimet për promovimin e zhvillimit të fëmijut. ka nevojë për të promovuar zhvillimin e fëmijës.

- Nuk ka kujdes të veçantë në lidhje me ershimin i cili do të promovojë përfshirjen e të gjithëve, e veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët Romë.

<sup>41</sup> Mbrojtja sociale

- Fondet të cilat janë të ndara për QPS janë mjaft të vogla dhe të njejtat janë të pamjaftueshme për punë, duke i marrë parasysh kompetencat e shumta me të cilat është përgjegjëse.

<sup>42</sup> Pjesëmarrja e shoqërisë civile

- Promovimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në monitorimin e buxhetit dhe sigurimin e shërbimeve on drejt sigurimit më efektiv të shërbimeve dhe shfrytëzimit më adekuat të mjeteve.

<sup>43</sup> Buxhetet egzistuese nuk përputhen me gjendjet momentale dhe të ardhshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Në vetë buxhetin sipas ministrive nuk parashihet rregull me të cilën do të përcaktohet se sa mjete alokohen vetem për fëmijët dhe saktësisht sa nga pjesa e buxhetit në mënyrë strikte është i ndarë vetëm për fëmijë.

**Rekomandimi 4:**

Formimi i një artikulli të veçantë në buxhet me një përqindje saktë të përcaktuar i cili do të jetë i dedikuar për fëmijët -Buxhet për fëmijë.

Një pamje më e mirë ndaj mjeteve të cilat në mënyrë direkte janë të ndara për fëmijët.

### ***3.7 Evidentimi, grumbullimi dhe selektimi i të dhënave***

<sup>44</sup> Siç mund të shihet nga Analiza e fëmijëve në RM<sup>4</sup> egziston mungesë e të dhënave kualitative, të mbledhura në mënyrë rutinore,

---

<sup>4</sup> UNICEF 2008

të ndara në së paku sipas moshës, gjinisë, arsimimit dhe statusit ekonomik. Është arritur një përparim sa i përket të dhënave statistikore sociale, përmes zhvillimit të projektit për informata zhvillimore dhe përmes projektit për edukim statistikor në suaza të Entit Shtetërorë për statistikë, por prapë duhet që edhe shumë të punohet në këtë fushë.

<sup>45</sup> Bashkëpunimi në mes atyre që sigurojnë të dhënat ndonjëherë është joadekuat përshkak të garimit të vetë departamenteve në brendi, si dhe mungesës së koordinimit ndërmjet ministrive pamundëson akumulimin e të dhënave dhe themelimin e sistemeve punuese të cilat i plotësojnë kërkesat minimale për një pako të të dhënave nacionale.

<sup>46</sup> Nuk do të mund të thuhet shumë edhe për të dhënat në sektorin shëndetësor, edukativ dhe social, pasi që ata nuk grumbullohen gjithmonë në mënyrë rutinore, ndërsa në disa raste ata thjeshtë edhe nuk egzistojnë. Të dhënat në nivel nacional grumbullohen në mënyrë rutinore nga ana e Ministrisë së shëndetësisë, Ministrisë së ekonomisë dhe MPPS dhe para së gjithash janë të pjesëshme, e ndonjëherë edhe nuk janë objective.

<sup>47</sup> MPPS me departamentet e saja të shumta ballafaqohet me probleme të bgjajshme gjatë grumbullimit të të dhënave dhe monitorimit të programeve. Për shembull, QPS në mënyrë rutinore nuk mbledhin të dhëna për persona të ndryshëm, që do të mund të përdroreshin për analiza në nivel qendror, ndërsa monitorimi i programeve dhe e valuimi vazhdimisht janë të lëna pas dore, që pa ndonjë qëllim sjell deri te mbrojtja e transaksioneve joetike dhe ilegale dhe i pengon reformat në sektor.

<sup>48</sup> Nga përvoja e OJQ-ve të cilët punuan në këtë raport vërehet mungesa e një sistemi për evudencë, grumbullimin dhe selektimin e të dhënave statistikore te QPS, komunat, shkollat dhe institucione tjera shtetërore nga lëmia e interesit. Tërësisht mungonte evidence e fëmijëve viktime nga veprat penale e cila duhet që të evidentohet nga MPPS, ndërsa në bashkëpunim me QPS. Në kuadër të qendrave

bëhet evidentimi i saktë dhe i vazhdueshëm vetëm për shfrytëzuesit e së drejtës në ndihmë sociale, e jo edhe për viktimat.

<sup>49</sup> Që të fitohet pamja e veçantë për situatën me të drejtat e fëmijut, por edhe në drejtim të mbrojtjes më kualitative të të drejtave të fëmijëve është e nevojshme që në vazhdimsi të bëhet evidentimi për numrin e fëmijëve viktimat edhe atë më precizimin se për çfarë lloji të keqpërdorimit dhe thyerjes së të drejtave të fëmijut bëhet fjalë. Gjithashtu, statistika oficiale për personat me nevoja speciale (fëmijë me nevoja speciale) nuk e jep pamjen e vërtetë, pasi që numri i fëmijëve përcaktohet sipas llojit të nevojave të veçanta dhe sipas mënyrës së realizimit të të drejtave të tyre. Prapë planifikohet që për Evidentimin e ardhshëm në vitin 2011 të bëhet edhe një statistikë e tillë.

<sup>50</sup> Në lidhje me statistikën që ka të bëjë me personat, fëmijët me rrezik, fëmijët e rrugës, viktimat nga tregtia me njerëz, viktimat nga dhuna familjare, viktimat nga pedofilia etj, vërehet, përkatësisht egzistojnë implikime pozitive që të determinohet numri i saktë i fëmijëve. Nuk egziston evidence e fëmijëve të cilët nuk janë të kyçura në sistemin edukativo-arsimor.

### **Rekomandimi 5:**

Përforcimi i sistemeve për grumbullimin dhe analizën e të dhënave në nivel nacional dhe lokal për të promovuar sjelljen e politikave të bazuara në dëshmi.

## ***3.8 Bashkëpunimi***

### **a) Bashkëpunimi me sektorin qytetar**

<sup>51</sup> Egzistojnë situatë të bashkëpunimit të Qeverisë me OJQ-të në dy tre vitet e fundit. Ky bashkëpunim është i ngarkuar me administratën e ngadalësuar shtetërore dhe procedurat burokratike.

<sup>52</sup> Shembull pozitiv për bashkëpunim të Qeverisë me OJQ-të është edhe pregatitja e PNA kundër pedofilisë dhe implementimit të një

pjesë të aktiviteteve nga kjo strategji ku implementues direkt janë edhe organizatat qytetare (OQ), përkrah atyre shtetërore.

<sup>53</sup> Nga buxheti i përgjithshëm i paraparë për OQ i cili arrin 15 milion denarë, Qeveria pa ndonjë kriter i ndanë këta mjete në fund të vitit. OJQ-të për këta mjete aplikojnë në fillim të vitit dhe deri në fund të vitit nuk dijnë aspak se a do të jenë të zgjedhura për implementimin e aktiviteteve të cilat i kanë paraparë në vitin vijues.

<sup>54</sup> Në bazë të analizës nga viti 2008 , Qeveria ka vendosur që vetëm 5% nga këta mjete tu ndahen OJQ-ve të cilat kujdesen për të drejtat e fëmijëve ose të cilat punojnë me fëmijë. 70-80 % nga OJQ-të të cilat i fitojnë mjetet janë të panjohura për publikun, ndërsa 90% nga to nuk dërgojnë raporte vjetore ose mendime nga revizorët të cilat do të mund të shpallen publikut më të gjerë. Egziston dyshimi se këta OJQ janë të afërta me Qeverinë dhe nga gjithsej 6000 OJQ të regjistruara vetëm 80 fitojnë mjete.

<sup>55</sup> Qeveria nuk e merr parasysh rolin e departamentit të saj për bashkëpunim me OJQ-të dhe përpjekjet e tyre që mjetet e buxhetit të harxhohen në mënyrë transparente dhe të përgjigjshme dhe të definojnë kriteret për shpërndarjen e mjeteve buxhetore të dedikuara për OQ. Kjo mënyrë e bashkëpunimit formalisht egziston, por vetë fakti se ky Koalicion nuk është e lënë pas dore nga çfarëdo qoftë bashkëpunimi flet vetë për gjendjen reale dhe transparencën e së njejtës.

## **6) Bashkëpunimi ndërkombëtar**

<sup>56</sup> Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar të RM-së me shtete tjera në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, m për fat të keq patjetër duhet që të konstatojmë se e njejtja ose nuk egziston fare ose nuk ka transparencë në lidhje me bashkëpunimin ndërshtetëror pasi që në public është e dukshme se mungon një informatë për një bashkëpunim të tillë.

### **Rekomandimi 6:**

- Bashkëpunimi Inter-parlamentar mes vendeve që kanë ratifikuar Konventën.
- Bashkëpunimi në mes të qeverive të vendeve që kanë ratifikuar Konventën.
- Bashkëpunim i synuar dhe i vazhdueshëm bashkëpunimin i shtetit dhe OJQ-ve me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.
- Bashkëpunimi ndërmjet organizatave qytetare të cilat punojnë në lëminë e të drejtave të fëmijut dhe shtetit.
- Qeveria të hartojë kritere për kushtet e finansimit të barabartë të OJQ-ve të cilat punojnë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijut, të cilat praktikojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe e respektojnë mendimin e fëmijëve dhe zmadhimin e mjeteve për OJQ-të të cilat punojnë me fëmijë.
- Qasje transparente deri te mjetet nga të gjitha Ministrinë të dedikuara për OJQ-të.

### ***3.9 Shpërndarja e Konventës mbi të drejtat e fëmijëve dhe trajnimi***

<sup>57</sup> Në lidhje me informimin për egzistimin e Konventës dhe të drejtave të cilat ajo i parashikon, patjetër duhet përmendur se ajo është e ulët edhe tek institucionet shtetërore, komunat, shkollat, prindërit, mediumet, si edhe tek shërbyesit shtetërorë që e praktikojnë KPF-në.

<sup>58</sup> Hulumtimi<sup>5</sup> tregon se shkalla e njoftimit të fëmijëve me Konventën është shumë e ulët. Edhe pse Maqedonia e ratifikoi KPF në vitin 1993 dhe morri për obligim për shpërndarjen e saj të gjerë edhe pse si pjesë e obligueshme e programit arsimor në arsimin fillor në klasën e tretë mësohet njësia mësimore për të drejtat e fëmijut në lëndën Njoftimi me rretin dhe në klasën e shtatë përmes lëndës Shoqëri Civile, përqindja e nxënësve të cilët nuk janë të njoftuar me

---

5

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20pravata%20na%20decat a%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminac ija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

të drejtat e fëmijëve është shumë e lartë. Të dhënat nga hulumtimi janë të treguara në tabelën më poshtë. Në rast kur grumbullimi i përqindjeve është më i madh se 100% atëherë anketuesi është përgjigjur në më tepër se një opcion.

<b>PYETJE</b>	<b>PËRGJIGJE</b>
A jeni të njoftuar me të drejtat e fëmiut?	<b>31,21% JO</b>
Cilat të drejta të fëmiut i keni të njohura?	mbi <b>70%</b> nuk janë përgjigjur në këtë pyetje
A keni ndëgjuar për Konventën për të drejtat e fëmiut?	<b>53% PO</b> <b>38,5% JO</b>
Prej nga fiton informata për të drejtat e fëmiut?	<b>68,9%</b> nga shkolla <b>46,5%</b> nga televizionet <b>39,1%</b> nga shtëpia <b>28,9%</b> nëpërmjet të internetit <b>25,6%</b> revistat <b>10,2%</b> Organizatat qytetare
Ku ke ndëgjuar për Konventën për të drejtat e fëmiut?	<b>61,2%</b> nga shkolla <b>60,7%</b> nga mediat <b>42,6%</b> nëpërmjet të internetit <b>33,3 %</b> prej shtëpie <b>21,3%</b> në veb faqen e ambasadës së Parë në botë <b>21,1%</b> nga organizatat qytetare
Kur të është cenuar ndonjë e drejtë e ytja, a u ke drejtuar në shkollën tënde?	<b>65% JO</b>
Ku jeni drejtuar kur u është cenuar ndonjë e drejtë?	<b>49,7%</b> tek prindërit <b>13,5%</b> në polici <b>9,1%</b> në shkollë
Kush është i obliguar që ti garantojë/ sigurojë të drejtat e fëmiut?	<b>71,2%</b> shteti <b>68,3%</b> familja <b>46,8%</b> shkolla <b>19,6%</b> organizatat qytetare
Sipas jush të drejtat e famiut a i kSipas jush të drejtat e famiut a i kyçin edhe përgjegjësitë?	<b>82,5% PO</b>
Çka paraqet përgjegjësia sipas teje?	<b>63,9%</b> ti kryejmë obligimet personale <b>61,8%</b> të sillemi me rrespekt ndaj

	të tjerëve <b>46,8%</b> ti rrespektojmë të drejtat e të tjerëve <b>20,2%</b> të kontribuojë për rrespektimin e të drejtave të të tjerëve
--	---

**Tabela 1: Të dhëna nga hulumtimi në temën “njoftimi me të drejtat e fëmijut”**

<sup>59</sup> APFBM doli me një shpallje<sup>6</sup> nga hulumtimi<sup>7</sup> se mbi 70% të fëmijëve në moshë shkollore nuk i njohin të drejtat e tyre, ndërsa të tjerat e dijnë se kanë të drejta por nuk kanë informata të sakta për to. Fëmijët edhe kur mund të identifikojnë se ndonjë e drejtë e tyre është e thyer nuk dijnë ku të drejtohen që ta mbrojnë atë të drejtë. Është interesante e dhëna se fëmijët më së tepërmi kanë njohuri për të drejtat e fëmijëve nga shkollat, ndërsa diku rreth 65% nga ata, nëse do u kishte qenë e thyer nuk do tu kishin drejtuar në shkollë. Ky konkluzion paraqet një problem serioz, pasi që parashtrohet pyetja: Si fëmijët do të tentojnë për të drejtat e tyre nëse nuk i njohin dhe nëse nuk munden që ti mbrojnë në institucionet ku e kalojnë kohën më të madhe të ditës? Fëmijët i identifikojnë shtetin dhe familjen si sigurues të të drejtave të tyre dhe janë të ndërgjigshëm se të drejtat i inkuadrojnë edhe përgjegjësitë e tyre.

<sup>60</sup> Qeveria në suaza të kompetencave të saja ndërmorri masa për kycjen e fëmijëve në të gjitha sferat e jetës, veçanërisht në arsim dhe në veprimtaritë sociale, zhvillon forma për preventim nga dhuna familjare. Por me ligj nuk është e rregulluar punësimi i defektologëve që të realizohet kycja në tërësi. Ka tentime për edukim të kuadrove mësimdhënëse për stabilizimin e punës me fëmijtë që kanë pengesa në zhvillim, por nevoja nga defektologët është e patjetërsueshme.

<sup>6</sup> <http://childresembassy.org.mk/?ItemID=DED8E0F2EA1A2B4DB67BFA37D65147EB>

<sup>7</sup> <http://www.childresembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20privata%20na%20decat%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childresembassy.org.mk/WBStorage/Files/Perceptija%20na%20privata.%20diskriminacija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>



<sup>61</sup> Me qëllim të detektimit dhe pengesës së dhunës familjare dhe formave më të rënda të keqpërdorimit, është e nevojshme kyçja e punëtorëve social në procesin edukativo-arsimor i cili do të mundte të vërejë në familjet disfunktionale të fëmijëve që nga moshja e hershme e tyre.

<sup>62</sup> Peroneli profesional i punësuar në QPS i inkuadron edhe punëtorët social dhe psikologët, sociologët dhe juristët. Mirëpo të dhënat nga Studimi i UNICEF-it nga viti 2007 për varfërinë e fëmijëve treguan se vetëm 18 nga QPS në të gjithë vendin kanë një ekip të kompletuar profesionale i cili punon, ndërsa të tjerët punojnë pa ose me një numër të kufizuar të personelit të kualifikuar dhe profesional.

<sup>63</sup> Mosegzistimi i personelit të trajnuar paraqet brengosje të madhe dhe ka implikacione serioze në kuptim të kualitetit dhe sigurimit të shërbimeve për mbrojtje. Në vitet e fundit profesionistët nga QPS fituan një sërë trajnimesh por ende egziston një zbrazëtirë e madhe në kuptim të njohurive profesionale dhe shkathtësive të tyre. Profesionistët të kyçur në sektorin për shërbime sociale, vazhdimisht tregojnë në nevojën për zhvillim dhe implementim efikas të standardeve dhe protokoleve për përkujdesjen e fëmijëve. Në këtë drejtim, zmadhimi i niveleve të personelit dhe përforcimit të kapacitetit institucional të QPS në masë të madhe do të kontribojë në rritjen e efikasitetit dhe sigurimit të shërbimeve më të mira.

<sup>64</sup> Sipas hulumtimit të APFBM, më tepër se 40% nga fëmijët që janë përfshirë në këtë anketë kanë qenë të rrahura nga ndonjë anëtarë i familjes, ndërsa rreth 30% kanë qenë verbalisht të lënduara.

### **Rekomanimi 7:**

- Trajnime të rregullta për institucionet shtetërore, komunat, shkollat, prindërit, mediumet, shërbyesit shtetërorë të cilët e implementojnë KPF-në.
- Shtypjen dhe shpërndarjen e KPF në më tepër gjuhë.
- Kampanja më të dukshme për ngritjen e vetëdijes dhe kuptimit të KPF-së.

## 4. DEFINIMI I TERMIT FËMI

<sup>65</sup> Në ligjin për të drejtat e të miturve nuk është dhënë definicion konkret për definicionin për fëmijën<sup>8</sup>. Në vend që ligjvënësi të parashikojë ashtu sikurse është e parashikuar në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve se fëmijë konsiderohet secili person deri në mbushjen e moshës 18 vjeçare, e më pas të bëjë gradacion të termeve varësisht nga mosha e fëmijëve, ai praktikon një qasje të komplikuar me përdorimin e disa termeve. Edhe në këtë ligj, por edhe në ligjet tjera të cilat i rregullojnë të drejtat e fëmijëve nuk egziston pajtueshmëri të terminologjisë dhe shpesh hasen termet: fëmijë, i mitur, person i mitur, individ i cili nuk është i moshës madhore.

<sup>66</sup> Ndryshe nga mbrojtja e garantuar ligjore gjatë procedurave gjyqësore pa marrë parasysh pëlqimin e prindit / kujdestarit, legjisllacionin maqedonas nuk parashikon mundësinë për të drejtat

---

### <sup>8</sup> Neni 12

Disa terme dhe shprehje të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien si vijon:

- i mitur është secili person në moshë deri 18 vjet i cili sipas Konventës për të drejtat e fëmijut, llogaitet si fëmij;

- fëmijë në rrezik është fëmiju i cili në kohën kryerjes së aktivitetit që me ligj është e përcaktuar si veprë penale ose thyerje të ligjit, ka mbushur shtatë, a nuk ka mbushur katërbëdhjetë vite; Fëmijë në rresik konsiderohet secili individ deri në mbushjen e moshës 14 vjeçare, i varur nga keqpërdorimi i drogave, substancave psiotrope ose alkohiol, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmijë-viktimitë e dhunës familjare dhe fëmijut të lënë pas dore e i cili gjendet në një situatë të tillë në të cilën është e ngarkuar ose e pamundësuar realizimi i kyçjes së sistemit për edukim ose është dhënë pas lypjes, bredhjes ose prostitucionit, e më së tepërmi për shkak të rolit edukues në familje, e me çka mund të vuhet deri në kundërshtim me Ligjin.

- I mituri më i ri është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprës penale që me ligj parashihet si veprë penale ose thyerje të ligjit ka pas të mbushur 14 vjet, por nuk ka pas të mbushura 16 vjet;

- I mituri më i ri është person ii cili në kohën e kryerjes së veprimt që me ligj është i paraparë si veprë penale për të cilën është i paraparë dënimi në të holla ose dënim me burg deri më tre vite, ka mbushur 14 a nuk ka mbushur 16 vjet ose i помлад малолетник vili është i varur nga drogat, supstancat psiotrope ose alkoholi, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i lënë pas dore i cili gjindet në aso situatë në të cilën është e vështirë ose e pamundur realizimi i funksionit edukues të familjes, e cila përshkak të katyre gjendjeve është ose mundet që të vijë në ndeshje me ligjin.

- i mituri i rritur është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimt që me ligj është i përcaktuar si veprë penale ose thyerje e tij, ka mbushur 16 vjet por jo edhe 18;

- i mituri i rritur në rrezik i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale që me ligj është e përcaktuar si veprë penale , për të cilën parashihet dënim në të hollë ose burg deri në tre vite, i ka të mbushura 16 vite, ndërsa nuk ka mbushur 18 vite ose i cili është i varur nga përdorimi i drogave, supstancave psiotrope ose alkoholit, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i lënë pas dore nga kujdesi socialo-edukativ i cili gjindet në asi lloj situatë ku është e vështirë ose e pamundshme realizimi i funksionit edukues të familjes, e cila përshkak gjendjeve të këtilla është ose mund të jetë në ndeshje me ligjin;

- I rritur i ri është personi i cili në kohën e thënies së aktgjykimit ka mbushur 18 vite, ndërsa nuk ka mbushur 21 vjet;

në fushën e kujdesit shëndetësor ose të konsultimit mjekësor (fëmijë apo të mitur nuk mund të ndikojnë në vendimin e mjekut që të raportojë të dhëna për gjendjen shëndetësore të prindërve). Ndërhyrjet kirurgjike dhe mjekësore të një i mitur mirre vetëm me pëlqimin e prindit / kujdestarit, dhe vendimi në raste urgjente me pajtimin e të paktën dy doktorëve të mjekësisë të cilët janë specialistë në degën përkatëse kirurgjikale mjekësore.

<sup>67</sup> Në lidhje me përkufizimin e fëmijës duhet të përmendet se sipas Kodit Penal të vitit 1996, nuk kishte asnjë përkufizim konkret për moshën e fëmijës viktimë e një krimi dhe nga një analogji e gabuar përdoret /referohet paragrafi që u përkiste fëmijëve autorë të kryerjes së krimeve apo Neni.71, sipas të cilit ndaj miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 14 vjet (fëmijë) nuk mund të iniciohen sanksioneve penale.

<sup>68</sup> Deri më vitin 2008 ka pasur disa raste ku viktima një fëmijë i moshës sapo të mbushur 14 vjeçare, por kur akuza penale ishte ngritur deri te Prokuroria Publike për veprën penale "sulm seksual mbi fëmi" u fitua përgjigjja se personi me mbushjen e moshës 14 vjeçare nuk është më fëmijë dhe prandaj u hodhën poshtë dhe akuzat penale, ndërsa autorët e krimit u dënuan për veprën penale "ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit".

<sup>69</sup> Në Kodin Penal ( "Gazeta zyrtare e Reoublikës së Maqedonisë" nr. 37/96, 80/99, 4 / 2002, 43/2003, 19/2004 dhe 73/2006), në nenin 122 pas paragrafit (19) shtohen katër alinea të reja (20) (21) (22) dhe (23), të cilat janë:

„(20) Nën termin viktimë e veprës penale nënkuptohet secili individ i cili ka fituar dëmtim, duke llogaritur këtu edhe lëndim trupor ose fizik, vuajtje emocionale, humbje materiale ose lëndim tjetër ose rrezikimin e lirive dhe të drejtave themelore si pasojë e veprës penale të kryer. ***Si fëmijë i cili është viktimi i veprës së kryer penale nënkuptohet person i mitur deri në moshën 18 vjeçare.***

<sup>70</sup> Për fat të keq në këtë periudhë nga viti 1996 deri në vitin 2008 u cenuan të drejtat e një numri të madh të fëmijëve në moshën ndërmjet 14 dhe 18 vjeçare të cilat ishin viktima të veprave penale,

port ë cilat ishin të refuzuar nga ana e organeve shtetërore me sqarimin se nuk janë fëmijë.

<sup>71</sup> Pas ndryshimeve më të reja të Ligjit për arsim të mesëm, me të cilat parashihet shkollimi i mesëm i obligueshëm, rrjedh edhe nevoja që punësimi i fëmijëve mbi moshën 15 vjeçare të jetë e rregulluar në pajtim me obligueshmërinë për shkollimin e mesëm, përkatësisht punëa e fëmijëve të mos e pengojë shkollimin e tyre të rregullt.

<sup>72</sup> Në lidhje me pajtueshmërinë e hyrjes në marrëdhënie seksuale, KP parasheh se deri në moshën 16 vjeçare i mituri nuk është mjaft i pjekur që të mund të pajtohet për hyrje në marrëdhënie seksuale. Deri në mbushjen e moshës 16 vjeçare as prindërit nuk mundën ë të japin pajtueshmëri, përkatësisht të lejojnë që fëmiu i tyre të jetojë në bashkësi jashtmartesore. Do të dënohen për vepër penale nga Neni 197 Jetë jashtmartesoreve me person të mitur dhe personi që ka hyrë në marrëdhënie seksuale me të mitur i cili nuk ka mbushur 16 vjet dhe për prindërit të cilat kanë lejuar jetë jashtmartesore personit të mitur. Në pajtim me këtë janë edhe rregullat sipas të cilëve vetëm i mituri i cili ka mbushur 16 vjet mund që të kërkojë leje para gjykatës për lidhjen e raporteve martesore.

### **Rekomandimi 8:**

- Harmonizim terminologjik të jurisprudencës me KPF dhe përdorimin e termit fëmijë për personin deri në moshën 18 vjeçare.
- të harmonizohet Ligji për marrëdhënie të punës për punë të përkohshme të fëmijëve me qëllim që të mos pengojë në arsimimin e rregullt të tyre, e njëheri të zhvillohen edhe shprehitë punuese.

## 5. PARIME TË PËRGJITHSHME

### 5.1 Barazia dhe mosdiskriminimi (Neni 2)

<sup>73</sup> Në pjesën më të madhe të ligjeve përmendet se është i ndaluar diskriminimi, por mungon implementimi i këtyre përcaktimeve. Prej me të 01.01.2010, hyn në fuqi edhe neni 7 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, por problemi me procedurën në të cilën do të përcaktohej diskriminimi ngelet e njejtë. Në një nen ligjvënës i thirret në procedurën administrative, ndërsa në nenin e ardhshëm jep të drejtë që të ngrihet padi para gjykatës kompetente.

<sup>74</sup> RM ende nuk e ka sjellur Ligjin për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit, edhe pse ajo është një nga kriteret politike për sigurimin e anëtarësimit të plotë të RM-së në UE.

<sup>75</sup> Sipas kësaj, rekomandohet që sa më shpejt të silllet ligji i tillë, ndërsa atë e tregoi edhe Raporti hulumtues: barometër për mundësi të njehta sipas të cilit më i përfaqësuar ishte diskriminimi politik me 75%, më pas vijonte diskriminimi sipas përkatësisë etnike, e më pas sipas moshës sipas së ciles këtu dhe me kategoritë e tjera bën pjesë edhe diskriminimi i fëmijëve.<sup>9</sup>

<sup>76</sup> Diskriminimi vërehet në më tepër nivele, por këtu do ti përmendim vetëm dy nga to:

- Fëmijët me nevoja të veçanta janë viktime të diskriminimit sipas më tepër bazave. Fëmijët me pengesa në zhvillimin psikofizik ballafaqohen me lënien pas dore nga familjet e tyre, shkollat dhe nga shoqëria më e gjerë. Egzistojnë raste kur fëmijë me pengesa janë viktime të keqpërdorimit seksual dhe fizik. Qasja ndaj këtyre fëmijëve shpesh është primitive dhe joadekuat i cili edhe më tej kontribon për vazhdimin e jotolerancës dhe diskriminimit social.

---

<sup>9</sup> <http://www.mcms.org.mk/en/our-work/research-and-publications/740-barometar-za-ednakvi-moznosti.html>

- Grupet e tjera të marginalizuara (Romë, individë që u përkasin grupeve më të vogla etnike) kanë qasje të vështirësuar ndaj mbrojtjes shëndetësore primare dhe arsimimit, e cila më së shpeshti është përshkak të varfërisë së madhe dhe problemeve tjera sociale me të cilat ballafaqohen.
- Vazhdon praktika e disa shkollave në arsimin fillor në më tepër qytete fëmijët Romë të cilët nuk e njohin mjaft gjuhën maqedonase, të cilat janë fëmijë të rasteve më të rënda sociale të shkruhen në paralele speciale. Në rastet më të shumta bëhet fjalë për fëmijë Rom të cilët nuk e kanë vendin aty, e me atë mundësohet ndarja dhe vlerësimi më i vogël i fëmijëve romë, të cilëve edhe më tej u është i kufizuar përparimi i tyre.
- Rasti më i ri me segregacionin e fëmijëve Romë doli në publik se në vitin 2009 kur ishte shpallur se fëmijët romë në Manastir janë të ndarë dhe të detyruar që të shkruhen vetëm në një shkollë.<sup>10</sup>

<sup>77</sup> Tabela 2 tregon rezultate nga hulumtimi i bërë i APFBM<sup>11</sup>:

<b>PYETJE</b>	<b>PËRGJIGJE</b>
A keni qënë të diskriminuar në ndonjë situatë edhe përshkak të çkafit?	<b>44%</b> përshkak të moshës <b>17%</b> përshkak të grupit etnik të cilës i përkasin <b>16%</b> përshkak të gjinisë <b>15%</b> përshkak të besimit fetar
A ndjeni diskriminim sipas gjinisë?	<b>19,1%</b> vajza <b>12,2%</b> djem

**Tabela 2: Të dhëna nga hulumtimi i bërë në temën "diskriminim"**

### **Rekomandimi 9:**

Të miratohen ligjet e përgjithshme antidiskriminuese në pajtim me kërkesat e UE-së (European Council Directive 2000/43/EC) dhe

<sup>10</sup> Komiteti i Helsinkit

<sup>11</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20privata%20na%20decata%20vo%20skolite%202009.pdf>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminacija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

KPF, si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare, me çka do të implementohet parimi i barazisë it ë gjitha njerëzve, duke i kycur këtu edhe fëmijët.

Është e nevojshme se në procesin e arsimimit ti përkushtohet vëmendje më e madhe rritjes së ndërgjegjes kuadrove pedagogjike dhe fëmijëve për çështje nga lëmia e (mos) diskriminimit, pasi që vetëm 1.3% nga fëmijët e kanë të njohur të drejtën e barazisë.<sup>12</sup>

## ***5.2 Interesi më i mirë u Fëmiut (Neni 3)***

<sup>78</sup> Legjislacioni i Maqedonisë përmban parimin eksplisit se duhet të mbahet llogari për mbrojtjen e së drejtës në jetë dhe zhvillim të fëmiut, mbrojtja e interesit më të mirë të fëmiut, sigurimin e minimum standardeve për secilin fëmijë nën kushte të barabarta, eliminimin e cilësdo formë të diskriminimit, respektimin e së drejtës së fëmiut në liri dhe sigurimin e personalitetit të tij, në mëndim personal dhe shprehjen e mendimit të vet, shoqërim dhe edukim, kushte për jetë të shëndoshë dhe realizimin e të drejtave të tjera sociale dhe lirive të fëmiut (Ligji mbi mbrojtjen e fëmijëve, Neni 3-a).

<sup>79</sup> Për fat të keq ky parim nuk është i vendosur në Ligjin mbi familjen i cili rregullon shumë çështje të rëndësishme për vlerësimin e interesit më të mirë të fëmiut (e drejta prindore, marrëdhëniet familjare, shkurorëzimi i martesës, adoptimi, kujdestaria etj.).

<sup>80</sup> Njëra nga institucionet më të përmendura e cila duhet të që të kujdeset për interesin më të mirë të të drejtave të fëmijëve është MPPS dhe QPS me ingerencat e tij. Përvojat e OJQ-ve në bashkëpunimin me qendrat dhe ministritë tregojnë pengesa të caktuara objektive dhe subjektive në realizimin e punës dhe në bazë të asaj ka perceptcion se të njejtat nuk kanë kapacitet, njohuri,

---

12

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20prvata%20na%20decat a%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminac ija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

dëshirë që metevërtetë ti kryejnë obligimet që u janë ndarë në lidhje me fëmijët.<sup>13</sup>

<sup>81</sup> Në lidhje me pasivitetin e tyre dhe joaftësinë që ti mbrojnë të drejtat e fëmijëve, Komiteti i Helsinkit veç ka dalur me raporte të veçanta për të drejtat e fëmiut<sup>14</sup>, ndërsa edhe rastet konkrete shpesh ishin të përmenduar në raportet e tyre mujore<sup>15</sup>.

<sup>82</sup> Poashtu janë të numërta edhe rastet me QPS e cila vetëm formalisht sjell Vendim për pamjen e fëmiut me njërin prind, përdërisa ai është i dhënë në përkujdesje dhe ruajtje tek prindi tjetër, që paraqet shembull kur nuk mbahet llogari për interesin më të mirë të fëmiut. Në rastet e shumta që janë të paraqitura deri tek Komiteti i Helsinkit dhe APBFM kemi cenimin e të drejtës së fëmiut që ta realizojë takimin e tij me prindin tjetër.

#### **Rekomandimi 10:**

- Rregullimi Ligjor u nevojës për punësim të punëtorëve social dhe defektologëve nëpër shkolla.
- Ekuipim të plotë të personelit profesional në të gjitha qendrat për punë sociale QPS.
- Qendrat për punë sociale duhet që të jenë prezente në teren deri tek të gjitha familjet disfunktionale dhe familjet në rrezik për parandalimin e dhunës që e durojnë fëmijët.

### ***5.3 E drejta e fëmiut në pjesëmarrje dhe rrespektimi i mendimit të fëmiut (neni 12)***

<sup>83</sup> Egzistojnë një numër i madh ndryshimeve ligjore të cilët e parashikojnë të drejtën e fëmiut në pjesëmarrje. Edhe përkundër këtyre normave ligjore në jurisprudencën e RM-së ende nuk është i siguruar implementimi i nenit 12 nga Konventa. Si rezultat i kësaj, fëmiu edhe më tej nuk trajtohet si subject i të drejtave por në masë

---

<sup>13</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=9F8117EED263D7428197C4126AFCB128>

<sup>14</sup> Komiteti i Helsinkit

<sup>15</sup> [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)



më të madhe e ka rolin e objektit pasiv, intereset dhe të drejtat e së cilëve varen nga prindërit, kujdestarët dhe organet shtetërore.

<sup>84</sup> Në Ligjin mbi familjen nuk është i parashikuar obligimi ligjor që fëmiju gjithmonë të ndëjohet kur sillet vendim për marrjen e tij nga njëri prinen deri tek shkursorëzimi i martesës.

<sup>85</sup> Në jurisprudencën e RM-së nuk parashihet obligimi që të konsultohet i mituri në lidhje me intervenimet medicinale ndaj tij, duke e pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e tij. Në nenin 50 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore parashikohet se intervenime kirurgjike dhe intervenime tjera medicinale mirren vetem me pajtimin me shkrim të personit të sëmurë, përkatësisht të prindit ose kujdestarit, nëse ai është i mitur ose i është hjekur aftësia për të vepruar. Bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme e lidhur me jetën dhe shëndetin e të miturit dhe mu për atë duhet të merret parasysh edhe i mituri, duke e marr parasysh moshën dhe pjekurinë e tij, të jep pajtimin e tij në lidhje me intervenimet medicinale.

<sup>86</sup> Në Ligjin për emrin personal parashihet që ndryshimi i emrit të të miturit të bëhet sipas kërkesës së prindërve të tij, adoptuesve ose kujdestarit të tij. I mituri mbi 10 vjet moshë duhet që të pajtohet me ndryshimin e emrit, por nuk mundet vetë të iniciojë procedurën për ndryshimin e emrit. Kjo është një zgjidhje jologjike, veçanërisht nëse mirret parasysh se i mituri me mbushjen e moshës 16 vjeçare i lejohet që të lidh martesë, që ka shumë më tepër pasoja nga ndryshimi i emrit.

<sup>87</sup> Njëri nga problemet kryesore për aplikimin e Nenit 12 nga Nonventa në vendin tonë është mosegzistimi i obligimit ligjor të paraparë që prindërit ta konsultojnë fëmijun kur sjellin vendime për të dhe për intereset e tij. Nga ana tjetër, patjetër duhet që të përmendet se egzistojnë forma të ndryshme të shoqërimit fëmijor (Parlamenti i fëmijëve, bordet shkollore, Organizata e fëmijëve) të cilët janë të formuara me qëllim që të ndëjohet zëri i fëmijëve për çështje që janë në interesin e tyre.

<sup>88</sup> Parlamenti i fëmijëve si asocijacion joqeveritar përbëhet nga: Parlamenti i fëmijëve të Maqedonisë - Shkup, degë të PF në qytete tjera të Maqedonisë si edhe klube të ambasadorëve të rinj dhe parlamentarëve në shkolla, në vendet më të vogla, fshatra dhe vende të banuara. Anëtarë të PFM mund të bëhet secili fëmijë në moshë prej 12 deri 19 vjeçare, me pajtimin paraprak të prindërve. PFM ka 42 PF nëpër qytetet e Maqedonisë dhe 8 në shkup me anëtarësi prej 8 deri më 10 000 anëtarë.

<sup>89</sup> Por edhe përkundër egzistimit të këtyre formave, të drejtat e fëmiut që të jetë i ndëgjuar shumë rrallë praktikohen nëpër shkolla dhe më gjerë. Atë e tregon edhe hulumtimi<sup>16</sup> i treguar në tabelën 3 më poshtë.

<b>PYETJE</b>	<b>PËRGJIGJE</b>
A egziston në vendin tuaj Parlamenti i fëmijëve (organizatë ose rreth debatues ose forma tjera të shoqërimit të fëmijëve)?	<b>19,8% PO</b> <b>33% JO</b> <b>47% NUK DIJNË</b>
A konsideroni se Parlamenti i fëmijëve kontribon në përmirësimin e të drejtave të fëmiut?	<b>34% nga 19,8% fëmijë që janë të njohur me këtë institucion konsiderojnë se kontribon</b>

**Tabela 3: Të dhëna nga hulumtimi i bërë në temën “Parlamenti i Fëmijëve”**

### **Rekomandimi 11:**

- Të parashihet obligim ligjor fëmiu ta tregojë mendimin e tij në procedurat kur sillet vendimi për marrjen e tij nga njëri prind ose kur sillet vendim se te cili prind do të mbetet të jetojë, nëse prindërit nuk jetojnë së bashku ose nëse vjen deri te shkurorëzimi i martesës.
- Në ligjinmbi familjen të vendoset një rregull se prindërit kanë obligim që ti konslutojnë dhe ti marrin parasysh mendimet, qëndrimet dhe dëshirat e fëmijëve, varësisht nga moshja dhe

<sup>16</sup>

<http://www.childrensbassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20prvata%20na%20decat a%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensbassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminac ija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

shkalla e pjekurisë së tyre kur sjellin vendime për tad he për intereset dhe të drejtat e tyre.

- I mituri, varësisht nga moshja e tij dhe shkalla e pjekurisë, të mundet vetë të inicojë procedurë për ndryshimin e emrit të tij.
- Në ligjin për mbrojtje shëndetësore të parashihet se për intervenimet kirurgjike dhe medicinale ndaj të miturve, përveç prindërve ose kujdestarëve, pajtim duhet të jep edhe i mituri, duke e marr parasyshë moshën dhe pjekurinë e tij.

## **6. LIRITË DHE TË DREJTAT E QYTETARËVE**

### ***6.1 E drejta në emër dhe identitet (Neni 7 dhe 8)***

<sup>90</sup> Në bazë të Raportit për hulumtimet e bëra (regjistrimit) të fëmijëve që nuk janë të regjistruara<sup>17</sup>, në RM ka fëmijë të cilat nuk janë të regjistruara dhe të cilat nuk kanë dokumentacion adekuat për identifikim. Numri më i madh i këtyre fëmijëve u takojnë grupeve të marginalizuara (etnike, sociale, statusore).

<sup>91</sup> Gjatë projektit janë identifikuar 840 fëmijë të cilët për momentin nuk posedojnë qartifikata nga evidentimi amë, ndërsa nga to 338 aspak nuk janë të regjistruara ose bile as që janë të lajmëruara. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët nuk posedojnë qartifikata nga evidentimi amë (840), 62% ishin pa Qartifikatë të lindjes, 32% janë fëmijë prindërit e së cilëve ose së paku njëri nga to kanë shtetësi maqedonase dhe 6% janë fëmijë prindërit e të cilëve ose njëri nga to nuk kanë shtetësi maqedonase.

<sup>92</sup> Shkaqet kryesore të përmendura për krijimin e situatës së tillë janë:

Mungesa e dokumentacionit nga ana e fëmijëve, mungesa e financave, prindërit jetojnë në bashkësi jashtmartesore pa ndonjë

---

<sup>17</sup> Raport për hulumtimin e bërë (regjistrimin) e fëmijëve të cilët nuk janë të regjistruara ose nuk kanë dokumentacion adekuat nga evidentimi amë. Projektin “regjistrimi gjatë lindje” UNICEF në realizim të Qendrës për të drejtat e njeriut dhe zgjedhjen e konfliketeve.

shkak të qartë për atë, nuk kanë fletëdëshmi për lëshimin e spitalit, frigë nga dënimet, mosnjohje, mosinteresimi i prindërve, i (e)lindur në kushte shtëpiake, mungesë e dëshmisë për atësi, mosrregullimi i statusit të vendbanimit, mosinformimit, mungesë e kohës, harxhime për udhëtim në qytet tjetër, procedurë e gjatë për nxjerrjen e dokumentacionit, raporte të parregulluara martesore, fëmiu që moti është i lindur, pamundësia që ta paraqesë fëmiun për shkak të sëmundjes, kërkimin e DNK-së për përcaktimin e afërsisë në gjini, mosinformim për të metat etj.

<sup>93</sup> Si disa nga problemet kryesore me të cilat u ballafaqua ky projekt u theksuan këta shkaqe:

- Zbulimi (identifikimi) i fëmijëve të cilët nuk janë të regjistruar. Sipas përvojës së deritanishme nga tereni momentalisht nuk është hartuar asnjë strategji për identifikimin e tyre dhe zbulimi i tyre është bërë rastësisht ose si rezultat i kampanjës momentale (projekt) të ndonjë organizate joqeveritare.
- Nuk egziston njëdëshirë politike e qartë për adresimin e problemit dhe se pushteti sillet pasivisht dhe në mënyrë të painteresuar.
- Barrierat administrative ishin të lidhura me trajtimin e këtij shërbimi si joprioritare dhe me përmbajtje jo të plotë të të punësuarve.
- Barrierat ligjore ishin të identifikuara si një pengesë e rëndësishme.
- Mosinformimi i qytetarëve.

<sup>94</sup> Sikurse mundet që të vërehet nga puna e përditshme në teren egzistojnë fëmijë pa dokumentacion, pjesa më e madhe e tyre janë Romë në republikën e Maqedonisë, një pjesë e madhe nga to nuk kanë mbrojtje shëndetësore të siguruar, nuk janë të kyçur në sistemin edukativ, edhe pse ligjet për shëndetësi tregojnë se nuk guxon të ketë qytetarë në RM i cili nuk do të ketë mbrojtje sociale. Ligjet për arsim thonë se nuk guxon fëmiu në moshën e arritur për arsimim të jetë jasht sistemit edukativ, duke mos e përshkruar dhe duke mos e marrur parasysh se egzistojnë fëmijë që janë të lindur dhe që jetojnë

në Maqedoni të cilët janë jasht sistemit edukativ dhe janë pa sigurim shëndetësor.

<sup>95</sup> Nga ana tjetër, sipas informative nga OJQ “Meseçina” nga Gostivari, në mes 3000 dhe 5000 Romë, Shqipëtarë dhe Turq në nivel të të gjithë teritorit të Maqedonisë nuk kanë dokumente personale, siç janë Qartifikata të lindjes nga Libri amë, kartonë për sigurim shëndetësor ose punësim, të cilët janë të nevojshëm për sigurimin social, mbrojtjen sociale dhe shërbime tjera sociale.

<sup>96</sup> Gjetja e mënyrës që të paraqiten sapo të lindurit e familjeve të varfura është e drejtë themelore e fëmijut, por edhe vend për qasje ndaj siguruesve të shërbimeve të cilat mund ta shfrytëzojnë kontaktin për fillimin e një sërë intervenimesh për të varfërit që kanë rezultate pozitive zhvilluese për fëmijët dhe shoqërinë në tërësi.<sup>18</sup> Nuk ka diskriminim më të madh nga ajo që shteti të mos mund të gjejë mënyrë që ta zgjidhe këtë çështje disa vite me rradhë, e për të secilin vit të tërëhjekin vëmendjen organizatat qytetare, Komisioni Evropian dhe organizata tjera ndërkombëtare në Maqedoni.

<sup>97</sup> Secilin vit rekomandimi është i njejtë, vetëm numrat janë të ndryshëm, a të ndryshëm janë vetëm për atë se familjet të cilat ballafaqohen me këtë problematikë jetese, i zgjerojnë familjet e tyre. Poashtu, ngelet pyetja pse shteti e hedh obligimin e tij vetëm prindit që ti paraqesin fëmijët e tyre gjatë lindjes. Është e nevojshme që me ligj të rregullohet ky obligim i shtetit dhe të parashihet paraqitja e fëmijëve nga ana e institucionit shëndetësor në të cilën është i lindur, ndërsa në të gjitha kushtet e tjera të formohen grupe mobile të cilët në teren do ta ndjekin gjendjen dhe do të bëjnë lajmërimin e fëmijëve të sapolindura.

### **Rekomandimi 12:**

- Zgjerimi i aktivitetit për identifikimin e fëmijëve të cilët nuk janë të regjistruar edhe në komuna tjera edhe tek bashkësitë tjera etnike.

---

<sup>18</sup> UNICEF

- Inicimin e ndryshimeve ligjore në drejtim të lehtësimit të paraqitjes.
- Mbledhja elektronike e të dhënave të nevojshme për regjistrim.
- Formimin e shërbimeve ndihmëse nëpër komuna për ndihmë gjatë regjistrimit.
- Përcaktimi i pakove stimuluese për paraqitjen e parë të fëmijut.
- Formimin, rregullimin dhe edukimin e njësive mobile të shërbimit të ofiqarit.

## ***6.2 Liria e shprehjes (neni 12 dhe 13) dhe e drejta e informimit (neni 17)***

<sup>98</sup> Në Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm nuk është e rregulluar pjesëmarrja aktive e fëmijëve në drejtim të së drejtës së formimit të mendimit të tyre dhe shprehjen e të njejtit. Kështu neni.6 të Ligjit mbi arsimin fillor nuk është planifikuar që të kërkohet mendimi i fëmijës në lidhje me transferimin nga një shkollë në tjetrën.

<sup>99</sup> Është e nevojshme që të bëhet ndryshim edhe të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në të gjitha pjesët që ofrojnë ndonjë formë e organizimit me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve, duke lejuar që fëmijët ta realizojnë të drejtën e tyre në shprehjen e mendimit të tyre.

<sup>100</sup> APFBM tenton që sipas Ligjit të ri mbi Shoqatat dhe Fondacionet fëmijë mbi 15 vite të mund të formojnë shoqata qytetarësh. Deri tani ky ligj këtë mundësi ua ofron vetëm të rriturve.

<sup>101</sup> Këshilli për radio difuzion (KR) si një organ i pavarur rregullator në fushën e transmetimit është i ngarkuar për të vëzhguar punën e mediave elektronike, por çdo ditë përballohet me përmbajtje të pahijshme televizive (me dhunë të tepruar), në lidhje me moshën dhe kohën e transmetimit që është potencialisht e dëmshme për zhvillimin e fëmijëve. Ne jemi të shqetësuar se KR në raste shumë të rralla të reagojnë me nismën e vet ose KR reagon pas ndërhyrjeve të organizatave civile për të drejtat e fëmijëve.

<sup>102</sup> Radio programi në gjuhën rome në 30 minuta në ditë, apo 3 orë dhe 30 minuta një javë nuk është kohë e mjaftueshme për të arritur qëllimet e informacionit. Në këto korniza kohore nuk ka hapësirë të mjaftueshme për prezentimin e emisioneve fëmijërore<sup>19</sup>.

<sup>103</sup> Hulumtimi<sup>20</sup> i bërë nga APFBM i tregoi këta të dhëna:

<b>PYETJE</b>	<b>PËRGJIGJE</b>
A jeni të njoftuar me SOS-telefonat ku mundeni të drejtoheni për ndihmë?	<b>60%</b> nuk janë të njoftuar
Cilat numra të telefonave për ndihmi i njihni ju?	<b>83%</b> nga të anketuarit e dijnë numrin e policisë
A jeni lajmëruar ndonjë herë në ndonjërin nga numrat për ndihmë dhe na cilat?	<b>30%</b> nga fëmijët janë drejtuar në ndonjërin nga telefonat për ndihmë, nga të cilat 76% hyn policia

**Tabela 4: të dhëna nga hulumtimi në temën " telefona për ndihmë"**

<sup>104</sup> Hulumtimi tregon se 55-77% e fëmijëve janë mjaft të informuar për çështjet e arsimit, varësia, parandalimin e HIV / SIDËS dhe sëmundjeve ngjitëse seksuale, kulturës dhe shëndetësisë. Kjo statistikë, megjithatë vlen për nxënësit që shkojnë në shkollë dhe të cilat janë pjesë e familjeve urbane.

<sup>105</sup> Përfitim në lidhje me informimin nuk kanë fëmijët e rrugës, nga grupet e rrezikuara dhe fëmijët nga vendet rurale.

### **Rekomandimi 13:**

- Ndëshkim i rreptë për stacionet televizive që nuk u përmbahen rregullores së detyrueshme për kategorizimin e duhur të programeve që kanë për qëllim audiencën e të miturve.

<sup>19</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=A3EF35A825543544BC3EDDDAEBC93593>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=9F5EC0F216636D4DBB6C57E120ABF85D>

<sup>20</sup>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20privata%20na%20decat a%20vo%20skolite%202009.pdf>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminac ija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

- Të jenë të informuar pa pagesë për përmbajtjet e përgatitura nga OJQ-të për të drejtat e fëmijëve
- Të miratohet një Ligj për mbrojtjen e fëmijëve në mediat e shtypura, ata elektronik dhe internetin.

### ***6.3 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 14)***

<sup>106</sup> Inkuadrimi i programeve të reja në këtë fushë nuk u pasuan me shpjegim të qëndrueshëm për arsyet bazë pse ndryshimet janë ndërmarrë, cilat janë përfitimet dhe objektivat, a u është shpjeguar mjaftueshëm mësimitdhënësve se çka pritet nga ta në realizimin e të njejtave, a janë marrë parasysh potencialet reale, specifiteti i shkollave. Për më tepër, çështja është nëse është mbajtur llogari për atë se çka i nevojitet një nxënësi në një moshë të caktuar, me potenciale dhe interese jo mjaft të formuara që të mundet me sukses të realizojë zhvillimin dhe suksesin e tij personal fizik, emocional dhe social dhe të vazhdojë me shkollimin e tij, e në fazën e mëtejshme të zhvillimit personal vetvetiu ta realizojë edhe përcaktimin fetar.

<sup>107</sup> Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në ditën e 08.07.2008 (gjatë pushimeve shkollore) i dërgoi një mesazh të shkruar të gjitha shkollave fillore, lëndë e të cilit ishte Obligimi i tyre, me të cilin shkollat kompetente obligohen që së bashku me mësimitdhënësit e paraleleve të nxënësve që kanë mbaruar klasën e katërt në vitin shkollor 2007/2008 të mbajnë takime me prindërit/kujdestarët e këtyre nxënësve më së voni deri me 11.07.2008, në të cilin do të plotësohen fletat anketuese ( të pregaditura nga ana e tyre dhe të lëshohen si shtesë ë shkrimit), me të cilat do të duhet që të zgjedhin një nga dy lëndët zgjedhore - njërin të paraparë për mësimesim ose njoftimin me religjionet. Më tej obligohen që rezultatet e grumbulluara për lëndën e zgjedhur në klasën e pestë të vitit shkollor 2008/2009 ta dorëzojnë deri te MASH, Sektorin për arsim fillor dhe të mesëm më së voni deri me të 15.07.2008.

<sup>108</sup> Nuk kishte ndonjë sqarim eksplicit nga Qeveria e RM-së dhe MASH se cilat ishin shkaqet për afatet e këtilla, cilat ishin shkaqet



për përshpejtimin e procesit të përgjithshëm të reformave dhe a ishin të nevojshme ky lloj i reformave në sistemin edukativ në shtetin tonë edhe atë mu në arsimin fillor edhe mu në këtë moment, veçanërisht pa ndonjë analizë të thellë të nevojave dhe intereseve.

<sup>109</sup> Pavarësisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RM-së e cila heq futjen e arsimit fetar në arsim, Qeveria e RM-së dhe MASH mjaft qetë, josistematikisht prapa dyerve të mbyllura dhe larg nga sytë dhe mendimet e publikut profesional dhe të përgjithëm, veçanërisht nga subjektet më të interesuar - prindërit dhe fëmijët, në kundërshtim me të gjitha dokumentet e brendshme dhe ndërkombëtare dhe rekomandimet, përsëri shpejt e shtyu mësimbesimin në arsimin fillor, me të zbutur edhe me një lëndë zgjedhore "Njoftim me religjionet" i cili edhe përkundër kësaj mbeti i mëshehur diku nën hije, duke marrë parasyshtë atë se të gjithë e predikojnë mësim-besimin.

<sup>110</sup> Me vënien e lëndës së Mësimbesimit nëpër shkolla nuk u rrespektua mendimi i fëmiut për mendimin dhe vlerësimin e tij. Në fakt, me këtë vendim të MASH duke u thirrur në të drejtën e religjionit i nxehu marrëdhëniet jotolerante ndërmjet religjioneve fetare. Fëmijët me vënien e mësimbesimit në vend që të ofrohen dhe të njoftohen, ata filluan që të ndahen në bazë etnike.

#### **Rekomandimi 14:**

Fëmijët duhet që sipas dëshirës dhe vullnetit të lirë të tyre ta mësojnë religjionin nëpër shkollat fetare, e jo si pjesë e shkollimit të obligueshëm fillor.

#### ***6.4 Liria e shoqërimit dhe tubimit paqësor (neni 15)***

<sup>111</sup> Sipas ligjit për shoqëritë e qytetarëve dhe fondacioneve për fëmijë munden që të ofrohen ose të ndërpresin të bëhen anëtarë të shoqërive qytetare. Me ligjin e ri me të cilin parashihet rregull se fëmijët me mbushjen e moshës 15 vjeçare të mund të formojnë shoqatë qytetarësh. Kjo do të kontribuojë që të ndëgjohet mendimi i

fëmijëve dhe njëherit do të mundësojë pjesëmarrjen e tyre në krijimin e politikave të cilat tangojnë çështjet në interes të tyre.

<sup>112</sup> Me këtë është bërë e mundur pjesëmarrja e fëmijëve në shoqërinë civile dhe pjesëmarrjen e tyre aktive, duke bërë të mundur fëmijëve me nevoja të veçanta që të marrin pjesë në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe të veprojnë në mënyrë aktive në sektorin civil, por në legjislacion mungon rregullimi i së drejtës së fëmijëve për grevë si dhe të drejtën e fëmijëve për tubim paqësor.

<sup>113</sup> Për fat të keq, Avokati i Popullit pothuajse nuk merr pjesë në informimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe nuk ka interes të ulët në personelit arsimor për informimin e fëmijëve për të drejtat e tyre.

#### **Rekomandimi 15:**

Rregullimi ligjor is ë drejtës së fëmijëve në grevë, si edhe e drejta e fëmijëve për tubim paqësor.

### ***6.5 E drejta e privatësisë (neni 16)***

<sup>114</sup> Kushtetuta e Republikës e garanton sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit dhe të mbrojtjes së të dhënave e kryen Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Megjithatë ka raste të shkeljes së identitetit personal, e me këtë edhe cenimin e privatësisë së fëmijëve.<sup>21</sup>

<sup>115</sup> **Mbrojtjen e privatësisë** e shqyrtojmë në suaza të familjes, shkollës, institucioneve shtetërore dhe medimeve.

- Në **kuadër të familjes** ka një përparim të caktuar, por prap egzistojnë familje ku ka dukuri të mosrespektimit të privatësisë së fëmijëve. Këtë e vërteton edhe hulumtimi i

---

<sup>21</sup> Shih mbrojtjen e privatësisë

bërë<sup>22</sup> në të cilin në pyetjen se cilat të drejta nuk rrespektohen në familjen tënde 59,8% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk rrespektohet e drejta e privatësisë.

- Në **Shkollë** gjendja në këtë plan është e përmirësuar, por ka nevojë të punimit të mëtejshëm. Mësimdhënësit duhet të jenë më diskret në pjesën e sjelljes së tyre ndaj fëmijëve, përkatësisht emërimin në disa situata të pakënaqshme (për shembull deklaratat para gjithë klasës se ky fëmijë nuk mund që të pritët të sillet më mirë përshkak se edhe babai i tij është i tillë).
- Në **Institucionet shtetërore** procedurat janë sekrete, mirëpo ne vlerësojmë se duhet një mbrojtje më e madhe e të dhënave personale, në drejtim të asaj se këta të dhëna të jenë të kapshme vetëm personave zyrtarë të cilat në mënyrë direkte janë të involvuar në procedurat e tilla.
- **Mediumet** duhet që të përkushtojnë vëmendje më të madhe gjatë raportimit për cenimin e të drejtave të fëmijëve. Është duke u përgaditur një Kodeks për gazetarë gjatë raportimit për cenime të të drejtave të fëmijëve me accent të rasteve të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofilinë.<sup>23</sup>

<sup>116</sup> Gazetarët duhet që ta rrespektojnë të drejtën e privatësisë së fëmiut, veçanërisht fëmijët që janë viktimat të tregtisë me njerëz. Praktikë gazetareske janë edhe raportimet për viktimat e identifikuar të moshës së mitur e që janë viktimë të regtisë në teriminet e mbrëmjes, gjatë së cilës publikohen para auditoriumit inicialet dhe vendbanimi i tyre, si edhe vendi ku ata drejtohen më tej.

<sup>117</sup> Këtë vit kemi paraqitje të një rasti të të rinjve ku të rinjtë i shprehin shembujt e tyre të keqpërdorimit nëpërmjet të internetit:

---

22

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20privata%20na%20decat%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminacija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

<sup>23</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=8CEBECF73CB6884E8020DAC228948D40>

- në e-mejl adresën e tyre nëpërmjet të Hi5 profilit (vjedhjen e identitetit - thyerjen e odit dhe dhënien e informative të cilat nuk janë të shënuara nga autori i adresës).
- Nëpërmjet të Hi5 profilit (është e vendosur një foto e huaj dhe person ii panjohur prezantohet si ajo që është autor/e e adresës).
- shembuj gjatë edukimeve nëpër shkolla nëpër tërë Maqedoninë, ku fëmijët dhe të rinjtë tregonin eksperiencën të kodeve të thyera, ftesa për njoftim nëpërmjet „onlajn shokëve të njoftuar“, shfrytëzimin e fotografive në emër të tjetër kujt etj.

<sup>118</sup> Në vendin tonë nuk egzistojnë hetime konkrete dhe të dhëna statistikore të këtij lloji, por prapë egzistojnë evidencime të rritjes së numrit të paraqitjeve të rasteve të këtilla.

#### **Rekomandimi 16:**

Të formohet trupi rregullator për kontrollim të medimeve të shtypura.

Të rritet numri i KR-së.

### ***6.6 Mbrojtja nga tortura ose veprim tjetër i ashpër, jonjerëzor, veprimi degradues ose dënimit (neni 37 a)***

<sup>119</sup> Nga ana e komitetit Evropian për prevencion nga tortura dhe sjellje jonjerëzore ose dënim, në vitin 2008 u shpall se në entin edukativo-përmirësues disa të mitur deklaruan se kanë qenë të lënduar nga ana e rojeve të burgut me pendrekë, ndërsa shumica e të miturve e lutën delegacionin që të përkujdeset që pendrekët të largohen nga objekti. Sikurse ishte rasti gjatë vizitës edhe nga viti 2006, delegacioni e pa se pendrekët dhe lidhëzet ruhen nëpër zyrat e personelit (hapur në zyrën e pjesës për burgosje/izolim).

<sup>120</sup> Përveç shenjave të mundshme të torturës ndaj fëmijëve në institucionet e mbyllura, shpesh ndeshemi edhe me ankesat e shumta nga qytetarët që fëmijët e tyre janë të ngacmuar nga ana e

policisë. Si rezultat përfundimtar, gati të gjitha këta procedura është marrja e një përgjigjeje nga ana e Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale se parashtesat e qytetarëve të paraqitura deri tek ato janë të pabazuara dhe se përdorimi i forcës është i justifikuar.

<sup>121</sup> Policia dhe vendet ku fëmijët janë në vuajtje të dënimeve, institucionet e burgut duhet të kujdesen shumë për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmiut të bazuar në nenet 37, 39 dhe 40 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Në praktikë, mungesa e obligimeve të veçanta dhe në procedurat që kanë të bëjnë me fëmijë (në rregulloren lidhur me funksionimin e policisë) dhe mungesën e zbatimit të standardeve minimale të përfshira në ligje me të cilat rregullohen strehimi dhe trajtimi i fëmijëve në institucione të mbyllura, paraqesin shkak për shumë shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe të rrezikimit të jetës dhe zhvillimit të tyre.

### **SHEMBULLI 3:**

MPB direkt është përgjegjëse për rastin lidhur me fëmijët XX dhe YY. Sipas të dhënave me të cilat disponon Komiteti i Helsinkit<sup>24</sup>, policia në asnjë rast nga veprimi i tyre në lidhje me këtë rast, nuk e morri parasyshë faktin se bëhet fjalë për fëmijë dhe se të gjitha procedurat që merren në lidhje me hetimin e të vdekurit XX edhe në veprimin me fëmiun e mbijetuar (i cili paraqitet në rolin e dëshmitarit kryesorë, por edhe viktimë e ngjarrjes) duhet që të udhëhiqen nga Konventa për të drejtat e fëmiut.

Veprimet policia duhet që ti kontrollojë nëpërmjet të prizmës së Konventës:

- \* në procesin e legjitimitit dhe ndjekjen e fëmijëve
- \* mosofrimin e ndihmës adekuate
- \* veprimin me personin e kapur dhe trajtimin e tij në polici e më pas edhe gjatë hetimit (gjatë së cilës nuk i është ofruar ndihmë nga punëtori social, psikologu ose mjeku)
- \* mungesa e rezultateve pas personit të zhdukur (që mund të na asocojë në mosinteresimin apsolut të fatit të tij të bazuar mbi diskriminimin ose tentimin që të mbulohen gjurmët e veprës penale)

---

<sup>24</sup> <http://www.mhc.org.mk/default-mk.asp?ItemID=22B90CA87B228B408901B9BA555F3F16&arc=1>

\* angazhimi jo i mjaftueshëm i Sektorit për kontrollim të brendshëm dhe të institutit për medicinën gjyqësore të ndriçohen momentet kyçe në rastin e përmendur.

<sup>122</sup> Gjithashtu, në propozimin e Ligjit të ri mbi Policinë mungojnë dispozita të sakta që do të rregullonin veprimin e policisë në rastet në të cilat janë të përfshira fëmijët (qoftë nëse bëhet fjalë për të dyshuarit ose viktimat dhe dëshmitarët në veprat e kryera penale.).

<sup>123</sup> Mungesa e këtyre rregullave domethënë edhe mungesë e vetëdijes tëk policia për trajtimin e veçantë të cilin duhet ta fitojnë fëmijët, mungesën e procedurës precize të paraqitjes dhe thirrjes në përgjegjësi, probleme në dëshmimin dhe joligjshmërinë e veprimit joadekuat.

<sup>124</sup> Egziston problem i përzierjes së fëmijëve në paraburgim me të miturit, edhe pse në ligj është e paraparë vendosja e tyre ndaras nga më të moshuarit.

#### **Rekomandimi 17:**

- themelimi i një trupi të pavarur për kontrollimin e punës së policisë jashtë kornizave të MPB.
- Kryerjen e një hetimi efikas gjithmonë kur egzistojnë të dhëna për torturim ose veprim i vrazhdë, jonjerëzor ose nënçmues ose dënim.
- Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi policinë me rregulla të sakta dhe precise me të cilat do të rregullohej veprimi i policisë në rastet kur janë të involvuar fëmijët ( qoftë nëse bëhet fjalë kur ata janë të dyshuar ose viktima dhe dëshmitarë në veprat penale të kryera).
- Formimin e një objekti të veçantë në të cilin fëmijët do ta mbajnë paraburgimin, por assesi së bashku me të paraburgosurit e moshës madhore.

## **6.7 Fëmijë të privuar nga liria dhe ndëshkimi i të miturve (neni 37)**

### **a) Shtëpia edukativo-përmirësuese - Tetovë**

<sup>125</sup> Shtëpia edukativo-përmirësuese - Tetovë është ent i karakterit gjysmë të hapur dhe daton që nga viti 1962. Shtëpia edukativo-përmirësuese - Tetovë, e cila përkohësisht është e çvendosur gjatë kohës së konflikteve të armatosura në RM (viti 2001) është nën suazat e Burgut të Shkupit. Kushtet materiale janë të vështira dhe nuk i plotësojnë standardet minimale. Të miturit në shtëpi veç nëntë vite me rradhë nuk janë të ndara strict nga të moshuarit të cilët gjinden në Burgun e Shkupit dhe egziston mundësi reale për kontakt me të burgosurit e moshuar.<sup>25</sup>

<sup>126</sup> Të miturit që qëndrojnë në shtëpi patjetër duhet që në mënyrë urgjente të vendosen në ndonjë institucion tjetër. Potencojmë se ky problem është me kornizë ligjore prej 9 viteve dhe për të njejtin nuk shihet qëllimi për zgjidhjen e shpejtë të tij.

<sup>127</sup> **Përveç kontaktit me më të moshuarit si probleme të zbuluara në shtëpi janë edhe keto<sup>26</sup>:**

- Të miturit e vendosur në shtëpi nuk konsiderohen si të siguar shëndetësor që është në kundërshtim me normat egzistuese.
- Përdoret masa disiplinore “izolim i vetmuar”, e cila sipas standardeve ndërkombëtare paraqet dënim johuman dhe i njejtë është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.
- Vizitat e rralla të QPS dhe pothuajse mosbashkëpunimi i tërësishëm me shtëpinë, si edhe numri i vogël i gjykatësve të cilët i vizitojnë të miturit dhe kujdesen për sjelljen e të njejtëve.
- Pamundësia për realizim efikas të qëllimit të vuajtjes së masave edukuese nëpërmjet të programeve egzistuese në

---

<sup>25</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=39F936505D9E6F4D8BAE7B9B5E76BD48>

<sup>26</sup> Komiteti i Helsinkit

shtëpi me qëllimin përfundimtar resocializimin e të miturve dhe sigurimin e zhvillimit të vërtetë të personalitetit të tyre.

- Për të gjitha aktivitetet fëmijët kanë vetëm një dhomë e cila në të njëjtën kohë shërben: për qëndrim ditor, mësojtore për lëndët e ndryshme dhe si kuzhinë.
- Fëmijët nuk kanë vend jashta ose Brenda ku do ta kishin kaluar kohën e lirë (nuk egzistojnë kushte për aktivitete fizike, nuk ka bibliotekë, nuk ka kushte për aktivitete të jashtme).

<sup>128</sup> Të njëjtat vërejtje u fituan nga ana e komitetit Evropian për parandalim nga tortura, sjellje jonjerëzore dhe poshtuese ose dënim, i cili në raportin e tij për vitin 2008 vërejti se: “Në lidhje me shtëpinë edukativo-përmirësuese, KEP qysh në raportin për vizitën nga Nëntori i vitit 2002e kritikonte faktin se të miturit ishin të vendosur në ndërtesën e njëjtë me të dënuarit e moshuar dhe shoqëroheshin me ta, në burgun në Shkup. Në Korrik të vitit 2008, gjendja mbetet e njëjtë. Më tej, kushtet hapësinore, regjimi dhe aranzhmani i personelit ende asqë çojnë kah realizimi i qëllimit: rehabilitimi i të miturve. Kjo gjendje është absolutisht e papranuar...Tani është e nevojshme që të veprohet urgjentisht që të gjindet një objekt i përshtatshëm alternative, e jo premtime të mëtutjeshme. KEP ju bën thirrje autoriteteve nacionale që të veprojnë në mënyrë adekuate”.

### **Rekomandimi 18:**

- Shtëpia duhet menjëherë të dislokohet në një vend që do të jetë adekuat për vendosjen e të miturve.
- Deri tek dislokimi i shtëpisë në një afat më të shkurtë të mundshëm të miturit e gjinisë mashkullore në shtëpinë edukativo-përmirësuese të jenë të ndara nga të burgosurit e moshuar në burgun në shkup, ndërsa personat e mitur nga gjinia femërore të jenë të ndara nga departamenti i femrave nga enti ndëshkimoro-përmirësues (ENP) Idrizovë.
- Të organizohen programe kualitative për të miturit që janë të privuar nga liria.



- Trajnim i vazdueshëm dhe i detyrueshëm për të punësuarit në këtë ent.
- Menjëherë të bëhen përpjekje të miturit të vendosura në shtëpinë të jenë të përfshirë me Ligjin për mbrojtje shëndetësore dhe sigurim shëndetësor, me çrast do të mund ti shfrytëzojnë shërbimet nga mbrojtja sekondare dhe terciare, përderisa paraqitet nevoja e tillë.
- Trajnim i vazhdueshëm dhe profesional për veprimin dhe kontrollimin e detyrave të veta të tërë personelit duke i inkuadruar këtu edhe mbikqyrësit.
- Përzgjedhja e kujdesshme dhe punësimi i personelit sipas pjekurisë së tyre personale që të mund të përballohen me sfidat që i bart puna me të rinj, pasi që të njëjtat duhet që tu përkushtohen punës me të rinj dhe të mund të udhëheqin dhe ti motivojnë personat të cilat janë nën përgjegjësinë e tyre.
- Vizitë e rregullt nga ana e gjykatësve dhe QPS-së.
- Shfrytëzimi i izolimeve të vetmuara si dënim disiplinues e të miturve duhet menjëherë që të ndërpritet, pasi që praktika e tillë paraqet dënim johuman e cila është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.
- Vazhdimin me praktikën e mirë të filluar për edukim shëndetësorë nëpërmjet programeve të cilat do ti kishin përmbajtur informatat për sëmundjet ngjitëse, shërim dhe parandalim të sëmundjeve ngjitëse bartëse.
- Vendosjen e një mekanizmi adekuat juridik i cili do të kishte qenë jasht organit administrativ të shtëpisë dhe tërësisht i pavarur në shqyrtimin e ankesave të të miturve, me çka do të vijonte marrja e aksioneve dhe kontrollimeve përkatëse.
- Autoritetet Maqedonase duhet që tju lejojnë vizita OJQ-ve në të gjitha vendet përshkak të mbikqyrjes. Vizitat duhet të jenë të vazhdueshme, me paralajmërim dhe organizatat duhet të jenë në mundësi që të bëjnë biseda private me personat e vendosura në institucion, si dhe qasje tek dokumentacioni i nevojshëm.
- Duhet që të ndërtohen vende për qëllime religjioze, si dhe të nënshkruhen marrëveshje me organizatat fetare, me qëllim që të burgosurit të kenë mundësinë që ta praktikojnë

religionin, pasi që mostregimi i interesit nuk do të thotë mospasje të interesit.

## **6) Burgu për të mitur - Ohër**

<sup>129</sup> Enti për burgim “ Burgu për të mitur - Ohër” është ent i karakterit të mbyllur. Vetë burgu për të mitur gjindet në qendrën e qytetit me çka bjen pyetja e privatësisë së të miturve, pasi që nga shtëpitë përreth të cilat janë në afërsi të vetë burgut, mund që të shihet mënyra e jetesës së vetë të burgosurve, përkatësisht renditja e tyre, shkuarja e tyre në kuzhinë, përdorimi i kohës së lirë nga ana e tyre dhe të ngjajshme. Bukfalisht gjithçka shohin banorët e shtëpive përreth.

<sup>130</sup> Gjatë viti 2008 u zbulua se në këtë ent egzistojnë tre persona të cilët vuajnë dënimin të cilin nuk e kanë bërë si të mitur dhe nuk e mbajnë të njejtën si të mitur, por si kryes të veprës penale në moshën madhore. Pas daljes në public të kësaj informate nga ana e Komitetit të Helsinkit<sup>27</sup> i cili e bëri vizitën, personat e rritur u transferuan në Burgun në Strugë.

### <sup>131</sup> **Lista e problemeve të veçanta të zbuluara<sup>28</sup>:**

- Shërbimi edukues, që luan një rol të madh në resocializimin e të burgosurve, është e përbërë vetëm nga dy persona.
- Vendosija e të moshuarve në burgun për të mitur të cilët gjatë kohës së kryerjes së veprës penale kanë qenë të rritur është në kundërshtim me Ligjin dhe me të gjitha dokumentet ndërkombëtare.
- Kushte të këqija në paraburgim: në dyshemenë gjindeshin vrima të mëdha, i gjithë ambienti kishte erë të lagështisë, personat e paraburgosur nuk kanë dritë natyrale, ndërsa drita nëpër qelitë vinte vetëm nga dritat

---

<sup>27</sup> <http://www.mhc.org.mk/default-mk.asp?ItemID=0CB95FD3534FE8438716AB9B1D811CBD&arc=1>

<sup>28</sup> Komiteti i Helsinkit

që gjinden në koridorin e pjesës për paraburgim, nga të cilat një pjesë nuk ishin në përdorim.

- Gjendja tepër e keqe e qelive.
- Në kuzhinë ku servohet ushqimi nuk ka nxemje.
- Edhe përkundër prezencës së të burgosurve të sëmurë nga sëmundja Hepatit C, të burgosurit e tjerë dhe të punësuarit nuk janë të vaksinuar.
- Mungesa e kontrollimeve të rregullta e lëre më kontrollimeve të jashtëzakonshme. Kontrollimet stomatologjike të fundit u janë bërë para 2 viteve, ndërsa personat shkojnë të vizitojnë dentistin vetëm sipas nevojës.
- Vizita të rralla nga ana e gjykatësve dhe QPS.
- Cenimi i së drejtës së privatësisë, burgu gjindet në vetë qytetin, ndërsa nga shtëpitë përreth është i ndarë vetëm me një murë të lartë.

#### **Rekomandimi 19:**

- Zhvendosja e burgut.
- Punësimi i menjëhershëm i punëtorit social.
- Rekonstruim i menjëhershëm i qelive në entin e paraburgimit.
- Vizita të rregullta dhe të obligueshme nga ana e gjykatësve dhe QPS.
- Vaksinimi i të gjitha personave të cilat mbajnë dënime në burg dhe të punësuarit në te, kontrollime të rregullta sistematike dhe stomatologjike.
- Ngrohjen e kuzhinës ku servohet ushqimi.
- Marrja e masave reale dhe adekuate për resocializim më efikas të personave të cilët më parë kanë kaluar nëpërmjet të programeve educative në shtëpinë edukativo-përmirësuese - Tetovë.

## **7. AMBIENTI FAMILJAR DHE KUJDESI ALTERNATIV**

### ***7.1 Ambienti familjar***

<sup>132</sup> E drejta dhe obligimi i prindërve që të kujdesen për mirëmbajtjen dhe edukimin e fëmijëve është e parashikuar me Kushtetutën e RM-së (Neni 40). Shteti siguron mbrojtje të veçantë familjes, mëmësisë, fëmijëve, të miturve, fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindore, siguron mbrojtjen e martesës dhe familjes nga raportet e prishura dhe dhunën në martesë dhe në familje.

<sup>133</sup> Në nenin<sup>2</sup> të Ligjit mbi familjen, familja definohet si bashkësi jetësore të prindërve dhe fëmijëve dhe të afërmive të tjerë, nëse jetojnë në amvisëri të përbashkët. Në ligjin mbi familjen parashihet se raportet në familje bazohen nën parimin e barazisë, rrespektimit të veçantë, ndihmesën e njëritjetrit dhe mbajtjen dhe mbrojtjen e interesave të të miturve. Kjo do të thotë se në sistemin tonë juridik parashihet që fëmijët të mos jenë të nënshtruara prindërve të tyre dhe nuk duhet të jenë vetëm pasiv dhe përmbarues të ndëgjueshëm të urdhërave të prindërve të tyre, por duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe me rrespekt. Prapëseprapë në jurisprudencën tonë nuk është e përdorur në mënyrë adekuate rregulla nga neni 5 i Konventës e cila thotë se prindërit, kujdestarët ligjorë dhe personat e tjera që sipas ligjit janë përgjegjës për fëmion, janë të detyrueshëm që të sigurojnë, udhëzojnë dhe ta drejtojnë fëmion për sigurimin e të drejtave të tyre të pranuar nga Konventa. Askund në jurisprudencën tonë nuk ka rregull me të cilën u imponohet prindërve që ti informojnë fëmijët e tyre për të drejtat nga Konventa dhe ti udhëzojnë ndaj realizimit të atyre të drejtave.

<sup>134</sup> QPS si një autoritet kompetent për mbikqyrjen mbi të drejtat e prindërve në situata kur kjo kërkohet në interes të fëmijës, duke i paralajmëruar prindërit në mangësitë në edukimin e tyre dhe zhvillimin e fëmijës dhe i ndihmon fëmijët për ti zhvilluar dhe edukuar ashtu si duhet, por munden edhe ti drejtojnë ata që vetë ose së bashku me fëmijën të marrin pjesë në këshillitoret e duhura apo në institucione të tjera mjekësore, sociale ose edukuese, të cilat

mund të japin këshilla të nevojshme. Në praktikë, vërehen dobësitë në ushtrimin e këtij funksioni të QPS.

<sup>135</sup> Egzistojnë edhe dobësi gjatë sjelljes së vendimeve nga ana e QPS në procedurën e shkurorëzimit se kujt do ti jepet e drejta e kontraktuar për përkujdesje në lidhje me mënyrën në të cilën përcaktohet se cilit prind do ti jepet e drejta dhe në lidhje me mendimin dhe dëshirën e fëmijut se me cilin prind dëshiron që të mbetet.

<sup>136</sup> Gjatë kësaj, QPS duhet ti merr parasyshtë mendimin dhe nevojat e fëmijut edhe të moshës më të vogël gjatë sjelljes së vendimit se cili prind do të kujdeset në tërësi për fëmijun. Në rast kur fëmiju i humb që të dy prindërit në procesin e sjelljes së vendimit nga ana e QPS për përcatimin e kujdestarit (anëtarë i afërm i familjes) rekomandojmë, gjithashtu që në mënyrë të obligueshme të merret parasyshtë mendimi i fëmijut.

<sup>137</sup> Janë vërejtur mangësi nga ana e QPS gjatë sjelljes së vendimeve për të drejtën e takimit me prindin tjetër pa mbikqyrje, në kushte të egzistimit të dyshimt se egzistojnë indicje për sjellje joadekuate të atij prindi.

<sup>138</sup> E drejta e të pamurit të fëmijës shpesh është e paraparë që të bëhet pa mbikqyrje nga ana e QPS dhe pa pamje në gjendjen dhe sjelljen e prindit, me çka në periudhën e kaluar kishte disa raste kur gjatë shfrytëzimit të kësaj të drejte fëmijët të keqtrajtohen seksualisht.<sup>29</sup>

### **Rekomandimi 20:**

QPS në procedurën e shkurorëzimit tam err parasyshtë edhe të drejtën e mendimit të fëmijut se me cilin prind dëshiron që të jetojë, me cilin prind ka vendosur lidhje emocionale stabile dhe ky mendim të merret parasyshtë njësoj sikurse edhe kushtet materiale dhe ekonomike të cilat prindi i ka. Fëmijët nga moshën 6 vjeçare e më

---

<sup>29</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=B03FCFB256A1004D9F037C2B7E92D9A6>

lart, kanë pjekuri psikofizike dhe emocionale të vendosin se me cilin prind dëshirojnë që të jetojnë.

## ***7.2 Shërbime alternative për fëmijët e privuar nga përkuqdesja prindërorë (neni 20)***

<sup>139</sup> Në pajtim me të dhënat zyrtare të fituara nga ana e MPPS deri në Tetor të vitit 2006 në muaj ka pasur rreth 97 957 shfrytëzues të ndihmës sociale dhe të gjithë patjetër është dashtur të kontrollohen dhe të ndiqen nga më pak se 500 persona të cilat janë të punësuar në QPS. këta të punësuar, poashtu, angazhohen në një numër të madh të aktiviteteve, duke e përfshirë këtu edhe: mbrojtjen e fëmijëve lidhur me dhunën familjare, çështjet me familjet që adoptojnë, mbrojtjen sociale të refugjatëve dhe të ikurve politi (azilëve). Në këtë drejtim dhe duke i marr parasyshtë kriteriumet për fitimin e së dretës në ndihmë sociale dhe shtesa fëmijërore, nuk na çudit fakti që vendimet të cilat ballafaqohen me shtyrjen e tyre të vazhdueshme shpesh janë diskriminuese dhe të padrejta.

<sup>140</sup> QPS në të gjitha aktivitetet e saja PATJETËR duhet që të veprojë në interesin më të mirë të fëmijëve, e gjatë kësaj nuk mundet e të mos i merr parasyshtë egzistimin e familjeve disfunkcionale dhe familjeve të rrezikuara dhe të mundësoje të drejtën e shikimit të fëmijëve, e gjatë kësaj fëmijët të jenë viktima të dhunës familjare, keqpërdorimit seksual, dhe forma tjera të dhunës.

<sup>141</sup> Edhe pse QPS ka autorizime të gjera të dhëna direkt me Ligjin mbi familjen, në praktikë të njejtat shumë rrallë praktikohen dhe kjo sjell deri te cenimi it ë drejtave të fëmijëve, të cilat sjellin deri te pasojat e rënda, po bile edhe deri në vdekje për shkak të reagimit jo në kohë nga ana e qendrave.

<sup>142</sup> Sistemet për mbrojtje sociale në Maqedoni janë të komplikuar dhe në shumë raste nuk arrijnë që ti kënaqin nevojat themelore të shumë familjeve të varfura dhe fëmijët e tyre nga një sërë

shkaqesh nuk munden që ti plotësojnë ndonjëherë kushtet restrictive për fitimin e ndihmës sociale.<sup>30</sup>

<sup>143</sup> Ndarja e ndihmës sociale duhet që të përmirësohet dhe ka shumë pengesa në qasjen deri te ndihma sociale, e cila mund ti diskriminojë grupet e të varfërve dhe të minoriteteve etnike.

<sup>144</sup> QPS të cilat janë dhënësit kryesorë të shërbimeve në teren, në sasi të madhe janë jo mirë të pajisura me personel dhe mungojnë kuadrot professional. Gjithashtu ka një dukuri të keqpërdorimit të beneficioneve sociale nga ana e atyre që i ndajnë dhe / ose nga ana e vetë shfrytëzuesve. Bëhen reforma të rëndësishme, por lidhja serioze ndërmjet politikës dhe implementimit të saj vazhdon që ta gërryen qasjen e fëmijëve deri tek shërbimet për mbrojtje sociale, veçanërisht të nevojshme për fëmijët e varfër.<sup>31</sup>

<sup>145</sup> Shteti lavdohet për përpjekjet e saja që të sigurojë kujdes alternative për fëmijët pa prind pas daljes nga institucionet për përkujdesjen e tyre deri në mbushjen e moshës 26 vjeçare me sigurimin e banesës pa pagesë, me mjete të siguruara për rrymë dhe ujë.

<sup>146</sup> Paraqitet nevoja nga familjet e mëdha të cilat marrin nën përkujdesje fëmijë, të cilat paraprakisht do të trajnohen që të pranojnë fëmijë viktime të tregtisë me njerëz të cilitdo lloj të dhunës ose veprës penale, pasi që ata fëmijë nuk është mirë që të jenë të vendosura në ndonjë institucion.

<sup>147</sup> EGziston një monitorim i dobët nga ana e QPS si edhe nevoja për mbikqyrje më të mëdha në teren, hulumtime në të cilat do të kishin qenë të kuçura edhe OJQ-të, vullnetarë etj.

<sup>148</sup> nga ana e QPS dhe MPPS nuk kryhet mbikqyrje kualitative mbi punën e institucioneve të cilat i përkujdesin fëmijët.

---

<sup>30</sup> UNICEF

<sup>31</sup> UNICEF

<sup>149</sup> Sipas një raporti të UNICEF-it, përkujdesja në një familje tjetër në vitin 2008, nuk egzistojnë standarde që do të përmirësojë cilësinë e kujdesit. Në momentin e tanishëm monitorimi është i kufizuar në monitorim të përkohshëm në lidhje me atë se sa QPS janë të kyçura në përkujdesjen e tyre, ndërsa atë e kryen Enti për punë sociale. Për shkak të resurseve të kufizuara ky monitorim nuk ndodh shpesh (diku një herë në vit). Mosegzistimi i mbikqyrjes së mirë dhe mungesës së standardeve për përkujdesje, si për familjet që bëjnë përkujdesjen ashtu edhe për të punësuarit në QPS të cilat punojnë në dhënien e kujdesisë, ka ndikim direkt në kualitetin e përkujdesjes. Me mosegzistimin e standardeve për shërbimet e personave të specializuar par cilësinë e përkujdesjes nëpër familjet që bëjnë përkujdesjen e tyre, si dhe mosegzistimi i treguesve për arritjet, monitorimit të asaj se si bëhet përkujdesja është shumë e vështirësuar.

<sup>150</sup> Kategori e veçantë e fëmijëve në familjet e përkujdesura paraqet sfidë për QPS. Në praktikë fëmijët pa prind / përkujdesje prindore dhe fëmijët të cilët janë keqpërdorur / keqtrajtuar nuk janë qartë të ndara. Në këtë moment klasifikimin të cilin e përdorin QPS nuk mundëson identifikimin e fëmijëve me probleme në sjelljen e tyre nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në familjet për përkujdesje. Edhe përkrah asaj se kishte dëshmi për fëmijë me shenja të hershme me probleme në sjelljen e tyre tek ata të cilat janë të përkujdesur nëpër familjet për përkujdesje, është mëse e besueshme se ata janë të evidentuar si fëmijë pa prind ose pa përkujdesje prindore, në vend që të jenë të identifikuar me karakteristikën e dytë. Egziston nevoja nga përmirësimi i rrjedhsëm të bazës së të dhënave të shërbimeve për përkujdesje që të mundësohet identifikimi i karakteristikave të shumta dhe të kategorive të fëmijëve të cilat përputhen që tu mundësohet përkujdesja e tyre adekuate. Mosegzistimi i bazës kualitative të të dhënave e pengon ndjekjen adekuate të fëmijëve të cilat dalin dhe hyjnë nga sistemi për përkujdesje. Kjo dinamikë është karakteristike në sistemet e përkujdesjes dhe është mjaft e rëndësishme për monitorimin e mirë.



#### **SHEMBULLI 4:**

Rasti i cili ishte shpallur në publik në Dhjetorë të viti 2008 ku me vendimin e IP Qendra ndërkomunale për punë sociale, dy fëmijë (vëlla dhe motër) janë marrur na prindërit dhe janë vendosur në Shtëpinë për fëmijë pa prind “11 Tetori” në Shkup.

Me 22.12.2008 vëllau, i cili ka vetëm 11 vjet, ka ikur nga Shtëpia për fëmijë pa prind “11 Tetori” dhe ka shkuar te prindërit e tij. Ai është lajmëruar në SOS telefoni për fëmijë dhe të rinj në APFBM<sup>32</sup> dhe ka paraqitur se është ushtruar dhunë mbi të dhe motrën e tij (9) nga ana e edukatorëve në Shtëpi. Sipas tij, njëra nga edukatorët e ka rrehur me shuplaka çdoherë kur ka kërkuar që tu paraqitet në telefon prindërve të tij. gjatë lajmërimit fëmiju ka thënë se pas marrjes së dy tre shuplakave nga ana e edukatores është ndalur që të kërkojë që të ketë kontakt me prindërit e saj. Ai poashtu, është ankuar edhe për kujdesin joadekuat. Ka deklaruar se fëmijët kanë pasur ndërrim jo të rregullt të teshave të tyre të poshtme, asnjëri nuk është kujdesur për higjienën e tyre dhe kanë qenë të friguar nga ambienti i ri dhe kanë qenë të lëna të vetëm pa kujdesin e duhur nga ana e ndonjë nga të punësuarit në shtëpi. Pas kthimit të tij në shtëpi, nga ana e prindërve ka qenë i dërguar në mjek ku është përcaktuar se fëmiju dukshëm është i shqetësuar dhe vuan nga sëmundja e zgjebes, për çka i u është dhënë terapia e shërimit të tij duke e qetësuar dhe duke e shëruar nga sëmundja e zgjebes.

Me të 20.01.2009 nga shtëpia ka ikur edhe motra e tij e cila pas orëve shkollore nuk është kthyer në Shtëpi, por me taksì është larguar jashtë Shkupit, në qytetin ku edhe jetojnë prindërit e saj. teshat që i ka mbajtur ajo kanë qenë të ndyta, gjithashtu edhe teshat e poshtme të saj. Edhe nga ana e vajzës është vërtetuar se disa nga edukueset e kanë rrahur me shuplaka asaj dhe vëllit të saj edhe atë kur kanë kërkuar që ti ndëgjojnë prindërit e tyre nëpërmjet të telefonit, ndërsa nga ana e njëres nga edukatorët ka qenë e rrehur në fytyrë dhe e tërhjekur për flokë kur ajo ka refuzuar që të pastrojë dhe të fshijë në shtëpi.<sup>33</sup>

Edhe në këtë rast askush nuk u përgjigj për cenimet e të drejtave të këtyre dy fëmijëve dhe përsëri sektori joqeveritar kërkonte përgjegjësi nga organet kompetente të cilat arsyetoheshin njëri tjetrin dhe nuk vërenin cenim në veprimin e tyre.

<sup>32</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=B489C27E378CB443B4A4606335401564>

<sup>33</sup> ambasada e Parë në botë - Megjashi dhe komiteti i Helsinkit

### **Rekomandimi 21:**

- Ngritjen e kapacitetit të QS dhe shërbimeve kompetente në MPPS përmes implementimit të reformave thelbësore, personale dhe organizative dhe edukim serioz, të vazhdueshëm të kuadrove.
- Reformat patjetër duhet të ndiqet me zhvillimin e mekanizmave precize kontrolluese të cilat do të sigurojnë identifikimin dhe sanksionimin e thyerjeve të të drejtave të fëmijëve.
- Formimi i grupeve profesionale nëpër shkollat dhe bashkëpunim të vetë shkollave dhe kuadrove mësimdhënëse me grupet e këtilla profesionale.
- Të punësuarit në QPS duhet që çdo ditë të jenë në teren, herët ti identifikojnë gjendjet e familjeve të cilat janë në rrezik dhe ti mbrojnë nga dhuna e mundshme dhe keqpërdorimi i fëmijëve në familjet dispunksionale.
- Ngritja e vetëdijes për rritjen e numrit të familjeve për përkujdesje.
- Trajnim i specializuar për familjet për përkujdesje.

### ***7.3 Adoptimi i vendit dhe adoptimi i huaj (neni 21)***

<sup>151</sup> Në Maqedoni rrallë adoptohen fëmijë me pengesa në zhvillimin dhe Romë dhe nuk bëhet azgjë në drejtim të popullarizimit të problematikës së adoptimit të këtyre grupeve të fëmijëve.

<sup>152</sup> Problem tjetër i cili është present në praktikë është segregacioni ose ndarja e fëmijëve nëpër shtëpitë. Në shtëpinë në Manastir mbeten fëmijë Romë dhe fëmijë me pengesa në zhvillim.

<sup>153</sup> Në lidhje me adoptimet e huaja, rekomandohet që shteti të lidh marrëveshje bilaterale për adoptim ndërshtetërorë dhe në pajtim me tat ë kryejë edhe monitorim për një kohë të caktuar, deri në moshën madhore të fëmijëve. Insistohet gjatë lidhjes së këtyre marrëveshjeve të merret parasysh që njëri nga adoptuesit të jetë me prejardhje nga vendi amë ose rajoni nga i cili adoptohet fëmiju, me qëllim që fëmiju në të ardhmen të jetë i njoftuar me prejardhjen e tij, gjuhën dhe identitetin.

<sup>154</sup> MPPS dhe QPS kanë siguruar kritere adekuate me të cilat arrihet selektimi më kualitativ i adoptuesve, por procesi rrjedh shumë ngadal. Shtëpitë për fëmijë pa prindër ballafaqohen me vështirësi përshkak të problemeve administrative...

**Rekomandimi 22:**

- Të përcaktohen stimulime për adoptimin e grupeve të marginalizuara të fëmijëve.
- Përsheptimi i procedurës për adoptim.
- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe OJQ-ve në lidhje me këtë çështje.

***7.4 Keqpërdorimi i fëmijëve, lënja pas dore dhe dhuna (neni 19)***

<sup>155</sup> Gjendja me dhunën mbi fëmijët në vendin tonë është më shumë se alarmante. Dhuna mbi fëmijët bëhen përditshmëri dhe fëmijët rrahen, keqpërdoren dhe keqtrajtohen.

<sup>156</sup> Fëmiu viktimë rralë bën praqitjen e dhunës. Friga është njëra nga shkaqet kryesore përshkak së cilës fëmijët ende nuk flasin hapur për këta dukuri dhe nuk besojnë se dikush do u ndihmojë. kështu dhuna për një kohë të gjatë mbetet e pavërejtur edhe nga mjedisi edhe nga institucionet, e ndonjëherë ndodh që të zbulohet kur është tepër vonë dhe kur jeta e fëmiut është e vënë në rrezik.

**a) Dhunë në arsim**

<sup>157</sup> me ligjin mbi arsimin fillor dhe Ligjin mbi arsimin e mesëm ndalohet malltretimi fizik dhe psikik i fëmijëve, por edhe në këto ligje nuk është e definuar se çka paraqet malltretimi fizik, e çka paraqet malltretimi psikik, dhe përveç dënimeve në të holla për kundërvajtje, nuk parashihen masa tjera.

<sup>158</sup> Gjatë muajve të kaluar në public u ndriçuan disa raste të ndryshme të malltretimit fizik të një nxënësi nga ana e profesorit të tij. Komiteti i Helsinkit në lidhje me këta ngjarje të pakëndshme u drejtua deri tek institucionet përkatëse edhe atë deri te drejtorët e

shkollave ku ndodhën këta ngjarrje të palakmueshme, deri te Avokati i popullit, deri te MPB dhe deri te inspektorati shtetëror për arsim.

**SHEMBULLI 5:**

Në rastin e parë bëhet fjalë për një shkollë të mesme në tetovë, ku nxënësi ka qenë i sulmuar nga profesori i matematikës i cili ia ka rënë në kokë dhe nëpër trup. Fëmiju ka qenë i rrahur nga ana e profesorit në fillim me boksa, e më pas profesori ka marrë edhe një nga karriket në klasë dhe e ka thyer në kurrizin e nxënësit. Kur nxënësi ka nisur që të ikë, profesori ka filluar të vrapojë pas tij, edhe me shkelma e ka larguar nga klasa. Pas ngjarrjes, nxënësi është kontrolluar nga spitali i tetovës, ku është konstatuar se fëmiju ka shtypje në pjesën e kokës dhe të kurrizit nga ana e majtë dhe për të njëjtën i është dhënë edhe vërtetim mjeksor.

Në lidhje me kërkimin e informatave të cilat i dërgoi komiteti i Helsinkit në lidhje me këtë rast nga ana e drejtorit të shkollës së mesme fituam informimin se është sjellur vendim me të cilën profesorit do ti hjeket nga 5% të rrogës në periudhë prej 6 muajsh dhe na u dha një kopje e aktvendimit dhe propozim Proçesverbalit të pregaditur nga ana e Inspektoratit shtetërorë për arsim.

Në lidhje me këtë ngjarrje fituam përgjigje nga ana e MPB - SPB tetovë, në të cilin na lajmërojnë se kundër profesorit është paraqitur Kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Në propozim proçesverbalin e pregaditur nga ana e inspektoratit Shtetëror për arsim është theksuar se në bazë të pamjes së situatës në teren në evidencën e dokumenteve të shkollës dhe bisedave të bëra gjatë qëndrimit në shkollë, është konstatuar se egzistojnë dëshmi për dënim fizik të nxënësit nga ana e mësuesit të matematikës. edhe më tepër që vetë mësuesi ka pranuar se e ka rrahur nxënësin, ndërsa edhe në vendimin e sjellur nga ana e drejtorit është e thënë kjo: “profesori në ndërrimin e parë ka hyrë në orë të matematikës, kur pas tij ka hyrë nxënësi dhe ka filluar që ta ofendojë profesorin. në atë profesori me nervozizëm ka reaguar dhe me karrike shkollore e ka shtyrë nxënësin”.

<sup>159</sup>Organet kompetente e harrojnë nenin 142 nga Ligji për procedurën penale i cili parasheh se organet shtetërore, institucionet që kanë autorizime publike dhe personat e tjerë juridik janë të obliguar që të bëjnë lajmërimin e veprave penale për të cilat bëhet

ndjekja në mënyrë zyrtare (ex -officio), për të cilat janë të lajmëruar ose për të cilat do të kuotojnë në ndonjë mënyrë tjetër.

<sup>160</sup> Komiteti i Helsinkit dërgoi kallzim penal në njërin nga rastet, por konsiderojmë se ajo është obligim i organeve shtetërore dhe të njejtat nuk guxojnë ta anashkalojnë.

<sup>161</sup> Të dhënat nga SOS telefoni për të rinj dhe fëmijë 0800 1 2222 të APFBM tregojnë rritje të shpejtë të dhunës mbi fëmijët. Si krahasim do të tregojmë se numri i thirrjeve për keqpërdorim dhe dhunë ndaj fëmijëve është në rritje. Derisa në vitin 2007 ai ka arritur 13.4%, në vitin 2008 ka arritur deri në 32,5%.

#### **SHEMBULLI 6:**

Interesi më i mirë i fëmiut lidhur me dhunën në arsim nuk është i mbrojtur as në rastin e fëmijëve të vendosur në internatin “Goce Dellçev” - Lubancë. Asnjëri nga të punësuarit në internat dhe të punësuarit në shkollën fillore në Lubancë nuk ka reaguar në të dhënat për malltretimin e fëmijëve.

Pas lajmërimeve në vitin 2006 për atë se egzistojnë indicje për malltretim fizik dhe psikik të fëmijëve të cilën në kontinuitet e ka bërë njëri nga edukuesit e internatit, të fituara nga ana e OJQ-së “Rubikon” dhe të përmbajtura nga ana e komitetit të Helsinkit OJQ-së “APFBM”, MPPS, MASH, Avokatit të popullit dhe QPS ndërmorrën një sërë të hapave kontradiktore:

\* Qendra ndërkomunale për punë sociale së shpejti e mbylli lëndën me shpjegimin se nuk kanë hasur në asnjëfarë malltretimes.

\* Inspektorati shtetërorë për arsim përcaktoi se “egziston dyshimi i bazuar se edukuesi ka bërë malltretim fizik dhe psikik ndaj fëmijëve nga kjo shtëpi nxënësish” dhe propozoi që i njejtë të largohet nga vendi i punës dhe kundër tij të nrihet proceduar kundërvajtëse.

Sipas të dhënave të fundit edukuesi i përmendur më lartë nuk është larguar nga puna, por vetëm ka qenë i dënuar me masë disiplinore me zvogëlimin e rrogës prej 5% në kohëzgjatje prej 3 muajve. Pas disa muajsh edukuesi ishte emëruar për drrjtor të atij enti.

## **6) Dhuna në familje**

<sup>162</sup> Edhe pse Komiteti i rekomandoi shtetit që të inkuadrojë ushtrime për policinë dhe të punësuarit në QPS në vërejtjen e malltretimit të fëmijëve dhe dhunës familjare dhe të aksionit adekuat, prap në qendrat për punë sociale nuk bëhet ndonjë evidentim i veçantë për fëmijët viktime të dhunës familjare. Në bazë të vizitave që i kanë realizuar OJQ-të në disa qendra dhe në bazë të punës së lëndëve për të cilat kërkojmë informatë të shkruar, mund që të vihet deri te oërfundimi se ata shumë rrallë kërkojnë dhënien e masave të përkohshme, ndërsa gjykatat reagojnë shumë ngadal dhe ashtu edhe veprojnë.

<sup>163</sup> Ligji mbi familjen i obligon QPS që të ballafaqohen me rastet e dhunës familjare dhe të bëjnë zgjidhjen e këtij problemi, dhe kërkon nga pot ë njejtat individë të cilët kanë ndërmarrë çfarëdo lloj aktivitetesh në lidhje me incidente të dhunës familjare, në afat prej 48 orëve ta paraqesin tërë dokumentacionin e nevojshëm, të dhënat, dëshmitë dhe dëshmitë medicinale deri te QPS.

<sup>164</sup> Kur bëhet paraqitja e incidenteve të dhunës familjare, QPS është e obliguar që të intervenojë përmes: sigurimit të masave mbrojtëse duke e inkuadruar këtu edhe vendosjen, sigurimin e trajtimit psikologjik adekuat, sigurimin e vazhdimit të ndjekjes së mësimit nga ana e fëmijëve, paraqitjen e rastit para paditësit, sigurimin e mbrojtjes juridike dhe përfaqësim, inicimin e rastit para gjykatës dhe nëse është e nevojshme kërkesë nga gjykata që të mirren masa mbrojtëse në kohë.

<sup>165</sup> Mirëpo Ligji mbi familjen synon ndaj zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohen gratë e moshuara viktime të dhunës familjare dhe nuk ka të bëjë me çështjet e fëmijëve, si viktimitë direkte ose indirekte.

<sup>166</sup> Praktika që rastet të mbyllen sipas procedurës së shkurtuar, që të “heshten” ose thjeshtë që të mos bëhet një analizë maksimalisht e thelluar për secilin indikacion të të fituar, është sa më shumë e pranishme në punën e qendrave. Në veçanti brengos fakti i

mungesës së kontrollimit mjekësor në rastet ku vërehet dhuna, si edhe një procedurë adekuatë e lajmërimit të qendrës nga ana e mjekëve të cilat në cilëndo situatë do të dyshojnë se egzistojnë shenja të dhunës ndaj fëmijut. Obligimin për paraqitje të dhunës së vërejtur mbi fëmijët nuk e plotësojnë as mësimmhënësit e as profesorët dhe kuadroja tjetër edukativo-pedagogjike nëpër shkollat dhe entet tjera edukative.

<sup>167</sup> Fshihet edhe informimi i QPS për efektet nga masat e parapara, përkatësisht ndjekjen në implementimin e masve të dhëna gjyqësore. Procedurat gjyqësore janë të gjata, e me atë shpesh rritet edhe rreziku nga përsëritja e dhunës.

<sup>168</sup> Sipas Ligjit mbi familjen, njëra nga masat me të cilat duhet të mbrohen fëmijët viktime të dhunës familjare është largimi nga shtëpia dhe dërgimi i personit që kryen dhunë që të vizitohet ndonjë këshillimore, por më së shpeshti fëmijët janë ata të cilat largohen nga shtëpia, ndërsa përdhunuesi ngelet në shtëpi, me çka fëmijët prapë viktimizohen. Ende nuk egziston një këshillimore e veçantë për kryesit e dhunës familjare.

<sup>169</sup> Mbrojtja e fëmijëve nga keqpërdorimi dhe dhuna është e rregulluar edhe me Ligjin mbi mrojtjen e fëmijëve (neni 9) me të cilin ndalohet malltretimi fizik apo psikik, dënimi ose sjellja jonjerëzore ose keqpërdorim i fëmijëve. Mirëpo kjo rregull ligjore nuk është e përpunuar, përkatësisht nuk është e definuar se çka është malltretimi fizik dhe çka paraqet malltretimi psikik, dhe përveç dënimeve në të holla, nuk janë të parashikuara dënime tjera të personave që kryejnë kësi lloj të dhunës mbi fëmijët.

<sup>170</sup> Rrahja e tëmiut është vepër penale. Koalicioni nuk e ka të qartë se sa njerëz deri tani janë të dënuar përshkak të rrahjes së fëmijut. A thua vallë se ajo që nuk flitet për këtë se mungon reagimi formal nga ana e policisë në lidhje me këtë problem, pasi që i njëjti trajtohet si punë private e nënës dhe babait?

<sup>171</sup> Problemi për të cilin, gjithashtu duam që të tregojmë në mosegzistimin e sistemit referees të rekomandimeve për viktimat

nga dhuna familjare në rastet kur ajo drejtohet për ndihmë dhe në atë rast bredhja nga njëri institucion në tjetrin në kërkim të ndohmës dhe mbrojtjes mund që edhe më shumë që ta traumastizojë viktimën.

<sup>172</sup> Në ligjin për të drejtat e të miturit jepet mundësia që marrja në pyetje e fëmiut viktimë të bëhet në një vend të posaçëm, të ashtuquajturat “skrin dhoma”, por ajo ende nuk është pjesë e praksës. Gjithashtu, nuk egzistojnë dhoma të veçanta për pyetje të fëmiut në stacionet policore dhe në qendrat për punë sociale.

<sup>173</sup> Në bazë të punës së disa OJQ-ve, vihet deri te informacioni se lihen pas dore grupet e marginalizuara në arsim (nuk ka përsëritje prej klasës së 1 - në klasën e 5-të), as që mbahen orë plotësuese që ti ndihmohet nxënësit që ta mbivetësoj materjen. kështu ndosh që fëmiu kur të vije në klasën e 5-të të mos mundet që të kyçet në arsim dhe atëherë të paraqitet problem ii lënies pas dore të katër viteve të para.

### **Rekomandimi 23:**

- Rritja e ndërgjegjes së organeve shtetërore për paraqitjen e detyrueshme të veprës penale kur e njejta vepër ndiqet sipas detyrës zyrtare ose ex - officio
- Pajisjen e dhomave të veçanta për pyetjen e fëmiut në stacionet policore dhe në qendrat për punë sociale.
- Rritja e mjeteve financiare për implementimin e programeve për reintegrim të fëmijëve-viktima të çfarëdo lloji të dhunës.

## **8. SHËNDETËSIA DHE NDIHMA SOCIALE**

### ***8.1 Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore (neni 24)***

<sup>174</sup> Njëra nga qëllimet strategjike të PNA për mbrojtjen e fëmijëve është edhe largimi i sëmundjeve lidhur me ushqimin. Lidhur me këtë është edhe ushqimi që ndahet nëpër shkolla. Kualiteti i ushqimit është në nivel mjaft të ulët, egzistojnë hamburgeri për ushqim të shpejtë në afërsi të secilës shkollë. Në drejtim të



përmirësimit të kualitetit të ushqimit konsiderojmë se është e nevojshme që të sigurohet bile së paku një ushqim i ngrohtë

<sup>175</sup> Sipas programit për vaksinim, shkalla gjenerale për imunizim në RM është 95% por shkalla e mbulesës më imunizim tek fëmijët e nacionalitetit romë është me përfshirje të ulët. Sipas analizave nga organizatat qytetare të cilat punojnë në këtë problematikë, jashtë imunizimit të tërësishëm janë fëmijët të cilët nuk janë të regjistruar në evidencën amë, fëmijë të cilët janë jashtë sistemit edukativ, shteti nuk ka ndonjë strategji të veçantë me të cilën do ti përfshijë edhe këta fëmijë për imunizim pa pagesë sipas kalendarit për imunizim në Republikën e Maqedonisë.

<sup>176</sup> Edhe pse kemi shërbim i cili duhet të sigurojë shërbime në teren të gjitha qytetarëve në RM, prapë kushtet për punë të motrave medicinale në teren është në nivel jo të mirë, nuk kanë automjete për në teren dhe materiale medicinale themelore të cilat do të mund të sigurojnë shërbime kualitative edhe në viset më rëndë për të depërtuar në këto vende rurale. Bile edhe gjatë realizimit të vizitave në teren nga ana e motrave medicinale, të njejtat janë vetëm formale.

<sup>177</sup> Edhe pse ligji për mbrojtje sociale garanton lindjen pa pagesë të secilës grua në kushte të spitaleve, prapëseprapë, praktika tregon diçka krejtësisht tjetër. Në spitalet gjinekologjike-akusherike jashtë shkupit nuk i pranojnë gratë që të lindin pa pagesë, por ju kërkojnë që të paguajnë dhe ua ndalin dokumentet për identifikim personal nëse nuk kanë të holla që të paguajnë.

#### **Rekomandimi 24:**

- Të përmirësohet imunizimi i fëmijëve në rrugë.
- Lehtësimi i procesit të regjistrimit të fëmijëve të cilët janë vonuar me nxjerrjen e qartifikatës së të lindurve.
- Sigurimin e mbrojtjes shëndetësore për të **GJITHA FËMIJËT**.

## 8.2 Shëndeti i Adolescentëve

### **a) Hulumtimi global për shëndetin e adoleshentëve**

<sup>178</sup> Konkluzionet kryesore nga hulumtimi Global për shëndetin e adoleshentëve nëpër shkollat në Maqedoni në vitin 2007/2008 janë:

<sup>179</sup> Shumë nxënës janë deklaruar se kanë qenë të pirë së paku një herë ose më shumë herë dhe kanë qenë të involvuar në probleme përshkak të dehjes. Preventimi nga përdorimi i drogave, si psh marihuana arrin 3%. Egziston qasje relative të drogave nëpër shkolla edhe pse ka një nivel realtivisht të lartë të edukimit për dëmin nga përdorimi i drogave. Shumë nxënës e kanë përjetuar eksperiencën e parë seksuale të tyre në moshë të re. Edhe pse përqindja e nxënësve në moshë prej 13 deri në 15 viteve të cilët kanë pasur marrëdhënie seksuale është relativisht i ulët (diçka më i lartë është tek meshkujt sesa te femrat), duhet që të jepet kujdes kësaj të dhëne. Nxënësit meshkuj më shpesh se ata femra kanë pasur marrëdhënie seksuale me dy ose më tepër partnerë. Një numër relativisht i lartë kanë përdorur kondome gjatë marrëdhënieve seksuale. Pjesa më e madhe e nxënësve kanë parë reklama në TV, radio, bilborde, postere ose në gazetata e përditshme ose në kino, kundër pirjes së duhanit, pirjes së alkoolit, përdorimit të drogave dhe dhunës në 30 ditët e kaluara. Shumica e nxënësve nga të dy gjinitë kanë qenë fizikisht joaktiv dhe kanë pasur aktivitete jo të rregullta fizike. Ata kanë mënyrë të jetës duke ndejtur ulur dhe mirren me aktivitete nga pozita e ulur si psh: luajtje në kompjuter pasi që sot kompjutorët janë present edhe nëpër shkollat edhe në shtëpi.

<sup>180</sup> Mosegzistimi i shërbimeve specifike për shëndet seksual dhe reprodutiv të përmbajtura ose të menaxhuara nga shteti.<sup>34</sup>

---

<sup>34</sup> Asociacioni për edukim shëndetësorë dhe hulumtime HERA mban dhe udhëheq dy shërbime miqësore për të rinj: „Dua ta dij“ katër vite, në dy vitet e para ishte në partneritet me Shtëpinë shëndetësore - Shkup, ku partneriteti bazohej në sigurimin e zyrave për mbajtjen e punëtorive shëndetësore nga ana e Shtëpisë shëndetësore - Shkup, ndërsa në dy vitet e fundit nuk egziston asnjëfarë kontribumi nga ana e institucioneve shëndetësore ndaj mirëmbajtjes së këtyre qendrave.

<sup>181</sup> Mosegzistimi i sistemit për shërbime sociale dhe edukim shëndetësor dhe shërbime për të rinjtë të cilët janë të marginalizuar dhe grupet vulnerable të HIV/SIDËS dhe infeksioneve seksualisht të bartshme (ISB)

**Rekomandime nga hulumtimi global për shëndetin e adoleshentëve nëpër shkolla në Maqedoni në vitin 2007/2008:**

Duhet që të zhvillohen dhe promovohen qëllime për përmirësimin e shëndetit të adoleshentëve me aktivitete të përbashkëta nga entet shëndetësore, familjet, shkollat dhe institucionet nga bashkësia. Më e rëndësishme është koordinimi dhe roli i aktiviteteve të cilat duhet që të realizohen nga ana e Ministrisë për shëndetësi dhe Entit Republikan për mbrojtje shëndetësore në Republikën e Maqedonisë - Planifikim strategjik, implementim të trajnim programeve, monitorim dhe evaluim të shëndeti të adoleshentëve dhe të rinjve.

Një hap më parë do të jetë krijimi i një partneriteti strategjik dhe shkëmbimi i eksperiencës dhe praktikave në këtë lëmi me ministrinë relevante për shëndetësi dhe për institucione publike shëndetësore nga vendet e UE-së të cilët kanë programe më përparimtare për shëndetin e adoleshentëve. Hapat e ardhshme në krijimin e kapaciteteve inkuadrojnë:

- Përmirësimin e sistemit të përgjithshëm për mbikqyrje shëndetësore të shtetit që të sigurohen të dhëna për shëndetin e adoleshentëve dhe mënyrat e jetesës dhe të shërbejë si instrument për mbikqyrjen dhe matjen e ndikimit dhe efikasitetit në implementimin e strategjisë Nacionale për shëndetin e adoleshentëve;
- Ndërtimin e kapaciteteve për entin Republikan për mbrojtje shëndetësore dhe entet Rajonale për mbrojtje shëndetësore për mbikqyrje të sjelljeve të rrezikshme prioritare në lidhje me shëndetin tek adoleshentët në shtet me implementimin e hulumtimeve të rregullta në çdo tre vite;
- Identifikimi më preciz i rajoneve gjeografike dhe nëngrupeve të adoleshentëve ku paraqiten probleme serioze dhe të ndikohet në zhvillimin e intervenimeve adekuate, aty ku është e nevojshme;
- Shpërndarja e informative në kohë për problemet egzistuese në sverën e shëndetësisë publike që kanë të bëjnë me adoleshentët ndërmjet profesionistëve nga sfera publike shëndetësore;
- Përmirësimi i finansimit public të programeve për shprehitë shëndetësore të adoleshentëve;

- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore për dizejnim dhe implementim të trajnim programeve;
- të vendosen shërbime - miq të të rinjve nën mbrojtjen e strategjisë Nationale për shëndetin e adoleshentëve.

## **6) Aktivitete për mbrojtje nga HIV/SIDA**

<sup>182</sup> Edhe pse në grantin e mëparshëm të Fondit për HIV/ SIDË 2007 – 2012, të rinjtë ishin të përfshirë si target grup dhe kishte aktivitete të veçanta të parapara për ta, në grantin e fundit ishin të shkyçur me shpjegimin se nuk janë grup e cila është e rrezikuar për HIV/SIDË. Hulumtimet e tregojnë mu të kundërtën, se të rinjtë nuk kanë mjaft informata për HIV/SIDËN dhe se janë të nevojshme parandalimet gjithëpërfshirëse me anë të programeve të drejtuara mu ndaj të rinjve.

<sup>183</sup> Në qershor të vitit 2008 u bë një hulumtim kuantitativ të njohurive të rinjve nga shkollat e mesme në qytetin e Shkupit për HIV/SIDË dhe qëndrimet e tyre për qasjet ndaj edukimit për shëndet seksual dhe reprodutiv. Hulumtimi ishte realizuar nga ana e grupit për edukim të të rinjve të HERA-s. Gjithsej ishin të përfshirë 1024 të rinj me një pyetësor të standardizuar në të cilin ishin të kyçur indikatorët e UNGAS me të cilin vlerësohen njohuritë për HIV/SIDË-n tek popullata e të rinjve. Hulumtimi kishte për qëllim që ta përcaktojë edhe nevojën nga informimi më i gjerë i të rinjve në suaza të programit arsimor në tema të lidhura me shëndetin seksual dhe reprodutiv dhe qasjet ndaj edukimit në këtë drejtim. Në pajtim me treguesit e UNGAS hulumtimi tregoi informim të pamjaftueshëm të të rinjve për HIV/SIDË-n në të cilin vetëm 16,3% nga të rinjtë kanë njohuri të plota për HIV/SIDË-n ndërmjet të rinjve që padyshim tregojnë në nevojën nga prevenimi i vazhdueshëm dhe edukimi për HIV/SIDË-n në popullatën e re, por duke përdorur qasje të ndryshme dhe strategji. Prapë egziston një informim i mirë për mënyrat në të cilat bartet HIV dhe mundësitë për mbrojtje, por të rinjtë nuk janë të informuar mjaftueshëm për mënyrat në të cilat nuk bartet HIV infektimi që mund të interpretohet si rezultat i egzistimit të paragjyqimeve dhe qëndrime ndaj situatave të ndryshme dhe dukurive, sesa për mosinformim.

<sup>184</sup> Në lidhje me qasjet e të rinjve të cilët kanë marrë pjesë në edukimet e moshës së tyre pothuajse në mënyrë të barabartë duan që të jenë të edukuar nga edukatorët dhe doktorët e moshës së tyre, ndërsa të rinjtë që nuk kanë qenë në edukim të moshës së tyre më tepër preferojnë edukim nga ana e mjekëve. Tek të rinjtë egziston një interes më i vogël në lidhje me temat e abortusit, kontracpcionit, barazisë gjinore dhe dhunës seksuale e cila është bazë për analizë tjetër të thelluar me qëllim që të identifikohen shkaqet për mosinteresimin e këtillë. Pothuajse 80% nga të anketuarit janë për vendosjen e një lënde për edukim seksual si lëndë në arsimin e mesëm.

<sup>185</sup> Qendrat për shëndet public kanë buxhete që të mbajnë edukime për të rinj, por ata asnjëherë nuk i implementojnë këta edukime në teren. Edhe pse është e munduruar në programet që këta edukime të realizohen nga ana e OJQ-ve, prapë qasja deri te ato fonde është shumë e rëndë.

#### **Rekomandimi 25:**

- Të hartohet dhe zhvillohet një program i veçantë preventiv në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) për shëndetin e adoleshentëve.
- Qendrat për shëndetshmëri publike të hapin tenderë për organizatat joqeveritare për implementimin e edukimeve të parapara për HIV/SIDË në mes të rinjve.

### ***8.3 Fëmijë më nevoja të posaçme (neni 23)***

<sup>186</sup> Me ligjin e ri për mbrojtje sociale nga 24 Qershori i vitit 2009 edhe pse u bënë ndryshime drastike në lidhje me të gjitha ligjet paraprake, më saktësisht rritja e lartësisë së shtesës së veçantë/ndihmës së përhershme në të holla, ndihma për përkujdesje nga ndonjë person tjetër dhe ndihmën për shkurtimin e orarit të punës për nënat të cilat kujdesen për fëmijun me pengesa trupore ose intelektuale, prap edhe më tej mbetet vërejtja se këta mjete janë të vogla, veçanërisht në krahasim me nevojat e fëmijëve me nevoja të posaçme (speciale).

<sup>187</sup> Mosegzistimi is ë drejtës për realizimin e buxhetit personal në bazë të nevojave të veçanta ende paraqet shkakun kryesorë që shumë fëmijë me nevoja të posaçme mbeten të mbyllura në shtëpitë e tyre pa mundësi për edukim dhe qasje deri tek edukimi, punësim dhe integrim në shoqëri. Edhe më tej lartësia e kompensimit në të holla është e kushtëzuar varësisht nga lartësia e nevojës për ndihmë dhe nga karakteri socio-ekonomik i familjes.

<sup>188</sup> Edhe më tej është alarmante gjendja me qasjen dhe ofrimin në institucionet shëndetësore sipas të cilës fëmijët me nevoja të posaçme janë të pamundësuar që të fitojnë mbrojtje shëndetësore efikase. **Në pajtim me Ligjin e ri për mbrojtje sociale nga viti 2008** garantohet e drejta e marrjes së mjeteve ortopedike dhe ndihmesave tjera, të tjerat paguhen varësisht në lartësi prej 50% nga vlera e të gjitha protezave, veglave ortopedike dhe ndihmesave tjera dhe 20% për vegla të ndëgjimit, protetike të dhëmbëve dhe mjete tjera.

<sup>189</sup> Në rregulloren për mjete ortopedike TITANIUS trocikëll për fëmijë të sëmurë nga paraliza cerebrale nuk hyn në mjetet ndihmëse ortopedike. Fëmijët deri në moshën 14 vjeçare janë të liruara nga pjesëmarrja e tyre në çmimet dhe ilaçet, ndërsa prej 14-18 vjet participojnë me 5%.

<sup>190</sup> Në sektorin e shëndetësisë ka nevojë urgjente për çështjet e ofrimit, kualitetit dhe efikasitetit. Problemet në menaxhimin institucional dhe kapaciteti i dobët teknik dhe udhëheqës, veçanërisht në kuadër të Fondit për sigurim shëndetësorë, e kompromitojnë shpërndarjen e duhur të shërbimeve. Mekanizmat për përgjegjësi janë joadekuate edhe pse për të njejtë janë të zhvilluar disa ligje rregullatore, ata nuk implementohen sistematikisht.<sup>35</sup>

<sup>191</sup> Problem edhe më tej mbetet të jetë participimi gjatë realizimit të mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve që u nevoitet trajtim i caktuar medicinal jashta shtetit në kushte kur një trajtim i tillë nuk është i mundur në Republikën e Maqedonisë. Sipas ligjit është e përcaktuar

---

<sup>35</sup> UNICEF

që shteti të finansojë 20%. Këta 20% shpesh janë problem i madh për familjen e një fëmiu i cili duhet që të shërohet dhe përshkak të mosgrumbullimit të të njejtave shpesh vjen deri te rrezikimi is ë drejtës në mbrojtje shëndetësore të fëmijëve.

<sup>192</sup> Në pjesën për mbrojtje shëndetësore në spital sigurohet vendosja dhe ushqimi i shoqëruesit gjatë shoqërimit të patjetërsueshëm të fëmiut deri në moshën 3 vjeçare derisa është në shërim spitalor, por më së shumti deri në 30 ditë.

### **Rekomandimi 26:**

- Lirimi nga participimi gjatë realizimit të së drejtës në mbrojtje shëndetësore për të GJITHË fëmijët dhe sigurimin e mbrojtjes pa pagesë për të GJITHË FËMIJËT.
- Gjatë rehabilitimit të fëmiut me nevoja të posaçme varësisht nga shkalla e nevojave të posaçme dhe kapacitetit të fëmiut me nevoja të veçanta me rekomandim nga mjeku të realizohet e drejta e shoqëruesit pa kufizimin në moshë.
- Sjellja e një akti të veçantë me të cilin do të përcaktohet se cilat shërbime shëndetësore do të konsiderohen si shërbime themelore shëndetësore, të cilat nuk janë të përfshira me sigurimin e obligueshëm shëndetësorë, e të cilët janë të rëndësishme për përmirësimin dhe sanimin e gjendjes së fëmijëve me nevoja të posaçme.
- Hartimin e një programi nacional për rehabilitimin e fëmijëve me nevoja të posaçme.
- Vendosjen e standardeve dhe procedurave për qendra të mira rehabilituese.

### ***8.4 Sigurim social dhe shërbime e ente për mbrojtjen sociale të fëmiut (neni 18.3 dhe 26)***

<sup>193</sup> Edhe pse sipas nenit 5 të Ligjit mbi mbrojtjen sociale potencohet se kujdesi i Republikës për pengimin e paraqitjes së rrezikut social

realizohet edhe nëpërmjet të ndërmarrjes së masave në politikën tatimore, punësimin, politikën e stipendimit, politikën e banesave dhe familjeve, shëndetësinë, edukimin, arsimimin dhe lëmive tjera, rapë në praktikë shumë pak nga këto masa realizohen.

<sup>194</sup> Edhe pse para pak kohe është vërejtur zvogëlimi prej 1,3%, shkalla e papunësisë në Republikën e Maqedonisë dhe problemet strukturore janë shkak serioz për tu brengosur. Papunësia ka ndikim direkt ndaj niveleve të varfërisë, ndërsa fëmijët e prindërve të papunësuar, veçanërisht prindërit të cilët për një kohë të gjatë janë të papunësuar, e ndjejnë varfërinë, privimin dhe shkyçjen sociale, si pasojë e problemeve financiare të cilat i mbijeton familja e tyre.<sup>36</sup>

<sup>195</sup> Një Përqindje e madhe nga popullata e aftë për punë në RM, gjatë tentimit për punësim është e diskriminuarnë bazë të përkatësisë partiake dhe në bazë të moshës. Në atë mënyrë kjo pjesë e popullatës është e pamundësuar që të sigurojë të ardhura për një jetë normale familjare.

<sup>196</sup> Romët edhe më tej janë grupi më i diskriminuar etnik. Papunësia ndërmjet Romëve ende është në shkallën më të lartë (pothuajse 73% në krahasim me rreth 30% të popullsisë së përgjithshme). Romët edhe më tej kanë të hyra më të vogla (rreth 63% jetojnë nën linjën e varfërisë) dhe kanë shkallë më të madhe të vdekjes. Vlerësohet se dy të tretat e familjeve rome jetojnë nën linjën e varfërisë.<sup>37</sup>

<sup>197</sup> Romët që nga vitet e '90-ta e këndej asnjëherë nuk kanë pasur një shkallë më të vogël të punësimit në lidhje me bashkësitë e tjera, gjithmonë kjo shkallë e papunësimit në bashkësinë rome ka qenë mbi 70%, ashtu sikurse është edhe analiza e tanishme<sup>38</sup> e cila tregon një gjendje alarmante të papunësisë - pothuajse 73% të papunësisë tek Romët në Maqedoni.

<sup>198</sup> Prej këtu dalin edhe ndjenjat e pabarazisë në punësim, implementimi joadekuat i Marrëveshjes kornizë të Ohrit, i cili parasheh përfaqësim të barabartë të pakicave në institucionet

---

<sup>36</sup> UNICEF

<sup>37</sup> Teksti është i marrur nga raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë në vitin 2009.

<sup>38</sup> OIQ „Meseçina“ - Gostivar



shtetërore, sepse ai është i sjellur për disa, e jo edhe për të tjerët (jo edhe për Romë) ky është burimi i pothuajse 63% të Romëve të cilët jetojnë nën linjën e varfërisë, e cila sjell shkallën më të lartë të vdekjes në Maqedoni përshkak të mënyrës së jetesës, ushqimit dhe shëndetësisë.

<sup>199</sup> Prindërit e paponësuar (të aftë për punë) për ndihmë drejtohen në QPS të cilat ofrojnë ndihmë mjaft të vogël sociale, e cila prej viti në vit është duke u zvogluar.

<sup>200</sup> Lartësia e ndihmës sociale në të holla përcaktohet varësisht nga periudha e shfrytëzimit të së drejtës edhe atë:

- në dy vitet e para e drejta realizohet tërësisht për tërë shumën e paraparë;
- gjatë vitit të tretë, katërt dhe pestë paguhet 70% e vlerës së përcaktuar;
- pas kalimit të vitit të pestë paguhet vetëm 50% nga shkalla e përcaktuar.

	<b>Lartësia e ndihmës sociale në të holla për vitin 2009</b>		
	<b>100%</b>	<b>70%</b>	<b>50%</b>
<b>Persona</b>	<b>2 173, 00 den.</b>	<b>1 521, 00 den.</b>	<b>1 086, 50 den.</b>
<b>Familje ose amvisëri me dy anëtarë</b>	<b>2 810, 50 den.</b>	<b>1 967, 00 den.</b>	<b>1 405, 00 den.</b>
<b>Familje dhe amvisëri me tre anëtare</b>	<b>3 578, 00 den.</b>	<b>2 505, 50 den.</b>	<b>1 789, 00 den.</b>
<b>Familje dhe amvisëri me katër anëtarë</b>	<b>4 600, 00 den.</b>	<b>3 220, 00 den.</b>	<b>2 300, 50 den.</b>
<b>Familje ose amvisëri me pesë e më tepër persona</b>	<b>5 366, 50 den.</b>	<b>3 756, 50 den.</b>	<b>2 683, 00 den.</b>

**Tabela 5: Lartësia e ndihmës sociale në të holla për vitin 2009**

<sup>201</sup> Vlera e ulët mujore për ndihmë sociale të cilin e ofron shteti si ndihmë, realisht shumë pak u ndihmon familjeve të cilat janë në

rrezik sipas bazave të ndryshme. Funkcionimi afatgjatë i sistemit familjar me minimum mjete financiare paraqet moskënaqje të nevojave dhe prishjen e barazpeshës familjare.

<sup>202</sup> Gjithashtu, në Ligjin për mbrojtje sociale me rregullat me të cilat rregullohet realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale për fëmijët, është konstatuar se egzistojnë një numër i madh i procedurave administrative të cilat e kufizojnë të dretën e fëmijut që të fitojë mbrojtje efikase.

<sup>203</sup> Sipas Rregullores për menyrën dhe kushtet e realizimit të së drejtës në kompensim në të holla për ndihmë dhe përkujdesje nga ana e ndonjë individi tjetër (Gazeta Zyrtare 102/06) është e nevojshme që të dorëzohen 26 dokumente të cilat nxirren nga organe të ndryshme kompetente.

<sup>204</sup> Situata nuk është shumë më e ndryshme edhe në realizimin e të drejtave tjera sikurse është e drejta në mbrojtje sociale, e drejta e shtesave fëmijërore, e drejta në shtesë fëmijërore të veçantë etj.

### **Rekomandimi 27:**

Zvoglimi i numrit të dokumenteve për realizimin e të drejtave në mbrojtje sociale, vënien në funksionim të sistemit njëkasterik, si edhe formimin e departamentit të veçantë administrative i cili do të kishte marr me rregullimin e dokumentacionit për fëmijë me nevoja të veçanta dhe fëmijë me pengesa në zhvillimin intelektual.

### ***8.5 Standardet jetësore (neni 27)***

<sup>205</sup> Edhe pse rritja reale e BPB është më e madhe, ka edhe zmadhim alarmant dhe koncentrim të varfërisë tek amvisëritë me fëmijë. Rreth 7% nga të gjitha fëmijët në moshë prej 0 - 9 vite nuk janë të mbuluara me shemën për sigurim shëndetësor publik.

<sup>206</sup> Në kvintilet më të varfëra 24,5 % e fëmijëve në moshë prej 8 - 9 muaj kanë lëshuar së paku një nga tetë vaksinimet e rekomanduara. Këta fëmijë kryesisht vijnë nga vendet rurale dhe nga bashkësitë etnike të romëve dhe shqipëtarëve. Në vendet rurale shkalla e vdekjes nën pesë vjet pothuajse është 6 herë më e lartë nga shkalla

në vendet urbane. Vetëm një nga 10 fëmijë në moshë prej 36 - 59 muajsh viziton mësimin parashkollor.

<sup>207</sup> Këta të dhëna<sup>39</sup> japin pamjen e investimeve të pamjaftueshme publike në shëndetësi, në arsim dhe në mbrojtjen sociale. Egziston dallim i dukshëm ndërmjet lëmive urbane dhe rurale në kuptim të qasjes deri tek shërbimet esenciale. Egziston mungesa e politikave në dobi të rritjes së fëmijëve, veçanërisht në qëllimet për krijimin e familjeve me fëmijë. Kompenzimet për mbrojtje sociale, duke i përfshirë këtu edhe kompenzimet lidhur me fëmijët në mënyrë të pamjaftueshme i përfshijnë fëmijët dhe familjet të cilat janë të ekspozuara në rrezikun më të madh nga varfërinë.

<sup>208</sup> QPS nuk bën mbikqyrje mbi kryerjen e obligimit për mbajtjen e fëmijëve nga ana e prindit të shkukurëzuar.

<sup>209</sup> Shtesat fëmijërore sigurohen për mbulimin e një pjese të harxhimeve në ngritjen dhe zhvillimin e fëmijut.

<sup>210</sup> Të drejtën e shtesës fëmijërore mund që ta realizojnë prindërit sipas kategorive të ndryshme të punësimit, si edhe persona të papunësuar të cilat fitojnë njëfarë mjetesh në të holla (mendohet në të punësuar nëpër kompanitë e falimentuara, personat që janë shpallur si tepricë teknologjike, përkatësisht këta janë individë të cilët sipas ndonjë baze ende konsiderohen si të punësuar dhe mu për atë fitojnë nga ana e Agjencionit për punësim mjete në të holla). Në këtë mënyrë shtesat fëmijërore paraqiten si të hyra shtesë në familje.

<sup>211</sup> Ajo që është karakteristike është se kjo e drejtë nuk mund që të realizohet nga ana e **prindërve të papunësuar të cilat nuk realizojnë asnjëfarë të hyrash**. Nga kjo del se familjet e rrezikuara të cilat në bazë të papunësisë janë nën rrezik social, nuk mundën që ta fitojnë ndihmën elementare nga shteti e as për fëmijët e tyre. Kjo e padrejtë nxiti dhe e rriti mllëfin tek ky lloj i familjeve.

<sup>212</sup> Ka disa paqartësi në Ligjin në lidhje me të drejtën e shtesës fëmijërore. Nëse në një pjesë të ndryshimeve theksohet se bartës is ë

---

<sup>39</sup> UNICEF

drejtës së fëmiut, menjëherë në pjesën tjetër del se bartës përcaktohet nëna e që më pas të kalojë në prindin tjetër?! Komiteti i Helsinkit në analizën e tij në lidhje me inkuadrimin e shtesës fëmijërore të prindit për fëmiun<sup>40</sup> tregoi në faktin se zgjidhja më e mirë për fëmiun është që fëmiu të jetë bartës i së drejtës në shtesë fëmijërore me qëllim që i njejtë të mos jetë i privuar nga shkaqet që nuk ka asnjë prind ose ato nuk i plotësojnë kushtet.

### **Rekomandimi 28:**

- Bartës is ë drejtës në shtesa fëmijërore dhe shtesa prindore për fëmiun e tretë të jetë subject it ë drejtave.
- E drejta në shtesa fëmijërore të mund që të realizojnë edhe familjet në të cilat prindërit janë të papunësuar, përkatësisht të njejtin paraqiten në Agjencionin për punësim, si të ardhura të garantuara për fëmijët në familjet e tilla.
- Shtesa fëmijërore tu mundësohet edhe familjeve me fëmijë të cilat janë shfrytëzues të ndihmës sociale.

## **9. ARSIMI, KOHA E LIRË DHE AKTIVITETET KULTURORE ( neni 28, 29 dhe 31)**

### ***9.1 Arsimi fillor***

<sup>213</sup> Në ligjin mbi arsimin fillor (neni 25) edhe pse qëllimi është që të sigurohet veprimtaria edukativo-arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta, prapë ajo është në kundërshtim me principet e arsimit inkluziv dhe realizohet nëpër shkolla të veçanta ose në paralele të veçanta nëpër shkollat fillore.

<sup>214</sup> sipas entit Shtetërorë për statistikë, raporti numër 2.1.9.10, kur do të ndahet numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor me numrin e klasave, fitohet numri mesatar i nxënësve në një klasë i cili arrin 21 nxënës. Në shkollimin e mesëm ky numër arrin 29 nxënës në një klasë. Ky numër në disa shkolla të mesme, varësisht

---

<sup>40</sup> <http://www.mhc.org.mk/default-mk.asp?ItemID=3AB6E2C9BA1E7C469D8DD07E62A9595C>

nga numri i nxënësve arrin deri në 35 fëmijë, ndërsa në disa shkolla arrin deri më 40 fëmijë. Me qëllim të sigurimit të edukatës kualitative dhe arsimimit, përveç trajnimit plotësues dhe edukimit të mësuesve është e nevojshme që të zvogëlohet numri i nxënësve të jetë maksimalisht deri në 25 në një klasë.

<sup>215</sup> Ligji për arsim parasheh që shkollat të cilat numrojnë mbi 900 nxënës të kenë dy anëtarë nga shërbimi psikologjiko-pedagogjik, ndërsa ata nën atë numër të kenë vetëm një anëtarë. Në secilën shkollë, pa marr parasyshë numrin e fëmijëve duhet të egzistojë një ekip multidisiplinari i përbërë nga psikologu, punëtori social, pedagogu dhe defektologu aty ku ka nevojë (fëmijë në inkluzion). Për shembull në Batincë nuk ka ekip profesional. Në asnjë shkollë nuk ka ekip komplet profesional.

<sup>216</sup> Praktika tregon se në numrin më të madh të shërbimeve psikologjiko-pedagogjike dhe drejtorët si menaxherë të shkollave, nuk e ndjekin punën edukativo-arsimore të kuadrove arsimore, nuk kanë qasje të mjaftueshme në procesin edukativo-arsimor, nuk kujdesen që ti kyçin fëmijët të cilët nuk janë të kyçur në arsim.

<sup>217</sup> Mungon edhe shfytëzimi kreativ i kohës së lirë përmes organizimit të puntorive (seksioneve) nëpërmjet të edukimit joformal të cilat do të jenë të realizuara nga ana e mësimeve ose OJQ-ve dhe nëse shkollat janë të hapura për bashkëpunim dhe japin në shfytëzim hapësira për kësi lloj të punëtorive.

<sup>218</sup> Vetëm 9% nga popullata parashkollore me nevoja të posaçme janë të inkuadruara në entet parashkollore.<sup>41</sup> Për tu inkuadruar fëmijët e vendeve të marginalizuara, të krijohen shprehi të shëndosha dhe të zgjidhet problemi me moskryqjen e fëmijëve nga arsimi fillor, është e nevojshme që fëmijët që nga mosha e tyre më e hershme të kyçen në arsimin parashkollor.

<sup>219</sup> Numri i fëmijëve Romë të cilët shkojnë në shkollë ende është i vogël dhe shkalla e lëshimit të shkollave është e madhe. Ende praktikohet shpërndarja e nxënësve Romë. Vazhdon praktika e

---

<sup>41</sup> Polio Plus

dërgimit të fëmijëve Romë me zor gjatë mësimimit nëpër institucione speciale për fëmijë me nevoja të veçanta.<sup>42</sup>

<sup>220</sup> Me Kushtetutën e RM-së shkollimi fillor është i obligueshëm dhe pa pagesë. Në vitin shkollor 2009/2010 Qeveria e shpalli informatën për sigurimin e librave pa pagesë për të gjitha nxënësit, por procesi i sigurimit nuk korenspondonte me fillimin e vitit shkollor - në fakt numri më i madh librave u vonuan më shumë se dy muaj.

<sup>221</sup> Egzistojnë dënime edhe për ata prind të cilat nuk i dërgojnë fëmijët në arsimin fillor, por edhe ajo masë nuk funksionon me vite pas, e lëre më dënimet prej 1000 eurove për **mosregjistrimin e fëmijëve në arsimin e mesëm**. Ideal është që e gjithë popullata të ketë të kryer arsimin e mesëm, por është shumë e vështirë deri atëherë sa ka 18 500 fëmijë<sup>43</sup> të cilat nuk janë të kyçur as në arsimin fillor. Ky realitet dhe gjendja e mjerueshme të cilën nga ana jonë disa herë jemi duke e përsëritur dhe tentojmë që të gjitha personat përgjegjës në institucionet e sistemit të japin forca maksimale që të përmirësohet gjendja me inkuadrimin e të gjitha fëmijëve në arsimin fillor.

<sup>222</sup> Në veçanti e përshëndesim sjelljen e Ligjit për edukimin e të rriturve dhe implementimin e tij me të cilin MASH premtoi se do të përfshihen të gjitha individët të cilat nuk kanë mbaruar arsimin fillor, pavarësisht nga mosha, por për fat të keq ky Ligj ende praktikisht nuk është duke u përdorur, pasi që një numër i madh fëmijëve nga të cilët nuk shkojnë në shkollë janë në moshën prej 7 deri në 14 vjet, ndërsa ato janë jashta shkollave, përshkak se egziston zbrastira ligjore për këtë grup.<sup>44</sup>

<sup>223</sup> Për fëmijët të cilët nuk janë të kyçur në arsim, e sipas MASH janë 5% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët ndjekin arsimin fillorë, nuk egziston ligj sipas të cilit fëmijët deri në moshën 14

---

<sup>42</sup> teksti është i marrur nga raporti i Komisionit Evropian për përpërimin e Maqedonisë në vitin 2009.

<sup>43</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=0A5AF229B517F5478C0200628B3A6A2E>

<sup>44</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=C3ED1792E0265E4B9D408DF075D99827>

vjeçare mund që të kyçen në procesin edukativo-arsimor. Sipas Ligjit për arsim për të rriturit, këta fëmijë mund që të kyçen në arsim vetëm me mbushjen e moshës 14 vjeçare. Fëmijët të cilët me mbushjen e moshës 14 vjeçare e plotësojnë këtë kusht, më së shpeshti e humbin interesin për mësim dhe bëhen viktimat të formave më të këqija të keqpërdorimit të punës fëmijërore (prostitucion, lypje etj.).

<sup>224</sup> Ata të cilët do të arrijnë që të shkruhen nëpër shkolla disi, ballafaqohen me problemin e mungesës së mjeteve për libra, mjete shkollore dhe bileta për autobus, përkatësisht për ta nuk vlejnë rregullat ligjore me të cilat janë të përfshira fëmijët në sistemin e rregullt të edukimit, e të cilët kanë të bëjnë me transportin falas ose librat etj. Në këtë mënyrë këta fëmijë mbeten edhe më tej jashta rrethit dhe për ta nuk vlejnë ligjet, përkatësisht të drejtat të cilat i gëzojnë fëmijët tjerë.

<sup>225</sup> Fëmijët të cilët gjinden nëpër spitalet për një kohë më të gjatë ose qëndrojnë në shtëpi nga shkaqe shëndetësore ose shkaqe tjera, nuk e realizojnë të drejtën e tyre në arsimim.

<sup>2256</sup> Në bazë të përvojave të prindërve dhe mësimitdhënësve me të cilat është biseduar, planet mësimore në arsimin fillor përmbajnë të dhëna të shumta, joadekuate për moshën e fëmijëve dhe përmbajnë shumë të dhëna. Një leksion zakonisht përmban së paku 10 deri 20 fjali të reja, të panjohura. 12 lëndë obligative në një klasë, të cilët gjatë javës më së shpeshti janë prezente me së paku dy herë në javë, kërkojnë nga fëmijët e moshës 10 vjeçare mbajtjen mend të shumë të dhënave. Kontrollimi i njohurive bëhet nëpërmjet përgjigjes me gojë me përsëritjen e të dhënave të memoruara. Në fakt, arsimimi - mësimi silltet në memorimin e të dhënave, të cilat gjatë procesit të mësimit paraqet sistemin më të ulët ose të parë të mësimit dhe fitimit të njohurive. Shkallët më të larta të mësimit, si mendimi, ndërlidhshmëria e të dhënave dhe krijimin e projekteve në grupe ose individualisht, shumë rrallë janë pjesë e fitimit të njohurive të reja.

<sup>227</sup> **Orët plotësuese dhe seksionet (këndet)** në shkollat fillore, të cilat në sistemin e mëparshëm ishin pjesë përbërëse e sistemit

edukativ, në dhjetë vitet e kaluara shumë rralë u mirëmbajtën. Shkollat private për mësimin e gjuhëve të huaja, aftësive në sferën e muzikës ose orët private të matematikës dhe lëndëve tjera, ku prindërit patjetër duhet që të paguajnë për secilin shërbim, i zavendësuan këndet dhe orët plotësuese, të cilat me anë të ligjit parashihen si pjesë e obligueshme e shkollimit fillor pa pagesë.

<sup>228</sup> I largohet obligimit që të organizohen dhe implementohen orë plotësuese nëpër lëndët ku nxënësit janë më të dobët dhe të njejtë kanë nevojë nga puna shtesë me arsimtarët bartës të atyre lëndëve, edhe pse kjo është edhe obligim i arsimtarëve sipas ligjit. Është prezente dukuria për kërkimin e motivimit financiar shtesë që të mbahen këta orë. Për fat të keq, MASH dhe inspektorati Shtetëror i arsimit janë mbikqyrësit memec të situatës.

<sup>229</sup> Programi për **fëmijë të talentuar** në Maqedoni, e cila në sistemin e kaluar ishte pjesë e sistemit edukativ, në dhjetë vitet e kaluara shumë rralë realizohet. Organizata teknika Popullore nuk punon me kapacitet të plotë si në sistemin e mëparshëm. Garat sipas lëndëve të caktuara dhe për një klasë të caktuar në dhjetë vitet e fundit janë të lëna pas dore dhe janë shumë të rralla. Fëmijët nuk kanë forma për plotësimin dhe verifikimin e njohurive plotësuese.

## **9.2 Arsimi i mesëm**

<sup>230</sup> Nuk ka ndonjë përparim të rëndësishëm në arsim, përveç Ligjit për shkollimin e mesëm të obligueshëm i cili është për tu përshëndetur, por bile deri tani nuk ka programe konkrete për stimulimin dhe stipendimin e fëmijëve në arsimin e mesëm.

<sup>231</sup> Ende nuk ka programe konkrete për stipendimin e Romëve në arsimin e mesëm dhe të lartë, nuk ka ndryshime në programet arsimore me të cilat gjuha rome do të bëhet e obligueshme në edukimin e fëmijëve Romë. Deri më tani ky proces mësohet si zgjedhorë.

<sup>232</sup> Rekomandimi që gjuha Rome të bëhet lëndë obligative në arsimin e fëmijëve Romë, është e dërguar deri te MASH qysh me të 19.02.2009, në formë të shkruar, si konkluzion dhe rekomandim nga



komisioni egzistues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit i cili doli nga diskutimet në seancën e të njejtit komision të Përhershëm anketues nga 17.02.2009 e për të cilin diskutohej sipas Raportit të Komisionit Evropian për përparimin e RM-së në vitin 2008 me të cilin fjaluesit kishin për qëllim dhe ende janë me qëllim që të mbyllim njërën nga, gjithashtu gjërat e rëndësishme, obligimet kryesore që dalin nga marrëveshja kornizë e Ohrit në lidhje me përdorimin e gjuhës në arsim.

<sup>233</sup> Në drejtim të kësaj deri tani nuk ka informatë rreth mundësisë për formimin e katedrës për gjuhën rome në fakultetin Filologjik në univerzitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, me të cilin përmes hapjes së modulit të dytë në mësimin sipas lëndëve në gjuhën dhe letërsinë rome do të sigurohej kuadër adekuat për edukimin e fëmijëve Romë (përveç të dhënës i cili nuk është i vërtetë në Enciklopedinë e Maqedonisë që e promovoi AMSHA).

<sup>234</sup> Shpesh ndodhin edhe konflikte ndëretnike nëpër shkolla, të cilat jo gjithmonë janë në bazë të urrejtjes ndëretnike dhe fetare ndërmjet nxënësve, por janë rezultat i instrumentalizimit dhe manipulimit nga ana e partive të caktuara politike përshkak të realizimit të qëllimeve të tyre tek elektorati i tyre.

<sup>235</sup> Të dhënat nga hulumtimi<sup>45</sup> flasin se 20% nga fëmijët ndjehen të diskriminuar përshkak të përkatësisë së tyre etnike. nga to meshkujt (27%) ndjehen më të diskriminuara sesa vajzat (16%). Hulumtimi tregon se ky lloj i diskriminimit është më i pranishëm ndërmjet vetë fëmijëve. Raporti i pabarabartë në këtë bazë, fëmijët e ndjejnë nga shokët/shoqet (46%), nxënësit me të cilat mësojnë (30,8%).

<sup>236</sup> Diskriminimi në bazë etnike është më e pranishme nëpër qytetet Tetovë (31%) dhe Krçovë (32%), sipas diskriminimit në gjuhë që tregon në nevojën nga marrja e masave me të cilat do të mund të cepohet në drejtim të zvoglimit të dukurisë, veçanërisht, përmes

---

45

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20pravata%20na%20decat a%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminac ija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

programeve përkatëse shkollore. Më tepër në këtë tematikë në raportin për OPAC.

<sup>237</sup> Është e nevojshme që urgjentisht të ndërpritet me segregacionin e fëmijëve romë në shkollat fillore dhe të mesme, për shembull shkollat qendrore „Mustafa Qemal Atatürk“, në Banjicë, Gostivar, skolla qendrore „Bashkimi – Единство – Birlik në Cigllanën, në Gostivar, „Avram Pisevski“ në fsh. Bardovcë, Komuna e Karposhit në Shkup. Ka segregacion edhe në shkollat fillore në Manastir, veçanërisht në SH.F. “ Gjorgji Sugarev”<sup>46</sup>, Prilep, në shkollën e mesme Ekonomike në Gostivar etj.

<sup>238</sup> Në shkollën internat “Maca Ovçarova” dhe të ngjajshme bëhet kategorizimi joadekuat i fëmijëve se janë me pengesa të vogla mentale me qëllim që të përdoren beneficionet e ndryshme (vendosje falas, ushqime, arsim dhe mbrojtje shëndetësore) dhe shërbimet e këtij internati, në pajtim dhe me njoftimin e prindërve.

<sup>239</sup> Edhe pse RM ka sjellur strategjinë Nacionale për zhvillimin e arsimit, prapë edhe më tej egziston një system i përçarjes së arsimit për fëmijët me nevoja të posaçme në shkollat e veçanta fillore dhe paraleleve në shkollat e rregullta. Problemi në praktikë qëndron në shkallën e ulët të përdorimit të të folurit nëpërmjet të gjestikulacioneve, letrës së Braevit për të verbërit dhe studentët me pamje të dobët, si edhe interpretuesve të gjuhës së gestikulimeve për studentët që kanë të dëmtuara shqisat e ndëgjimit. Përveç defektologut dhe inkuadrimin e një asistenti personal, nevoitet edhe interpretues në gjuhën e shenjave dhe profile tjera profesionale në ndihmimin e fëmijut me nevoja të posaçme që të ketë një edukim më efikas.

<sup>240</sup> Barrierat arhitektonike edhe më tej pamundësojnë inkuadrimin në sistemin edukativ të fëmijëve me pengesa fizike në zhvillim.

<sup>241</sup> Programet për arsimin e mesëm dhe aftësimin e individëve me nevoja të posaçme janë të vjetëruara, ndërsa vendet e punës për të

---

<sup>46</sup> Raport i komitetit për segregacion të Romëve në Manastir

cilat aftësohen më së shpeshti nuk korespondojnë me mundësitë e tregut të punës.

### ***9.3 Rekreim, sport dhe aktivitete kulturore***

<sup>242</sup> Hulumtimi<sup>47</sup> tregoi se fëmijët në moshë prej 10 deri 17 vitesh në pyetjen se a fitojnë informata të mjaftueshme nga lëmia e kulturës dhe sportit, japin përqindje të lartë prej 70 % për përgjigje të konfirmuar.

<sup>243</sup> Mirëpo është e patjetërsueshme që të përmendet se aktivitetet sportive dhe kulturore janë jashta aktiviteteve shkollore si pjesë e klubeve private sportive ose shkollave të cdramës ose muzikës, ku secila orë paguhet. Kjo do të thotë se vetëm një numër i përcaktuar i fëmijëve munden që të lejojnë kohë të lirë dhe creative, sport dhe rekreacion. Përmbajtja e aktiviteteve shkollore shpesh inkuadron edhe vizitë të ngjarrjeve sportive dhe kulturore, si edhe shëtitje dhe ekskurzione, por secila vizitë paguhet. Shpesh herë ata fëmijë të cilat nuk munden që të paguajnë, nuk paraqiten për vizitën, pasi që ata prapëseprap nuk janë obiluese.

<sup>244</sup> Egzistojnë shumë festivale për fëmijë, por shpesh ata festivale shërbejnë për qëllime komerciale dhe që të mirret pjesë në një festival të tillë, një fëmijë duhet që të paguaje prej 500 deri 1000 euro për një këngë (tekst dhe aranzhman).<sup>48</sup>

#### **Rekomandimi 29:**

- Implementimin e Strategjisë për arsim inkluziv përmes zhvillimit dhe implementimit të programeve për kyçjen e fëmijëve me nevoja të posaçme në arsimin inkluziv.
- Planifikim strategjik dhe pregaditje teknike gjatë hartimit të programeve educative për arsimin inkluziv me kyçjen e

---

47

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20prvata%20na%20decat%20vo%20skolite%202009.pdf>

<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata.%20diskriminacija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

<sup>48</sup> “Mal Bitolski Monmartr”

edukatorëve të veçantë (defektologëve) në procesin edukativ të fëmijëve me nevoja të veçanta edukative.

- Vënien e teknologjive bashkëkohore dhe mjeteve ndihmëse në procesin edukativo-arsimor.
- Inkuadrimin e teknologjive bashkëkohore si përmbajtje në procesin edukativ të fëmijëve me pengesa intelektuale.
- Promovimi i arsimit joformal i cili do të mundësojë kualifikim dhe rikualifikim për vendet e punës të cilat janë aktuale në tregun e punës.
- Hartimin e programeve për fitimin e arsimit joformal tek fëmijët me nevoja të podaçme.
- Është e nevojshme që të trajnohen, ritrajnohen dhe të zhvillohen profesionalisht mësimitdhënësit të cilët punojnë me fëmijë me nevoja të posaçme në arsimin e rregullt dhe afirmimin e punës nëpër grupe të mësimitdhënësve dhe shërbimeve profesionale në institucionet edukativo-arsimore, veçanërisht në punën profesionale defektologjike.
- Mbikqyrje e përforcuar e punës së shërbimit pedagogjiko-psikologjik në drejtim të rolit të tyre edukativo-arsimor dhe psikologjik në shkollë në llogari të angazhimit të tyre si ndihmës të shërbimit administrativ.
- Përparimi i kornizës ligjore egzistuese (arsim fillor, i mesëm dhe i lartë). Hartimin e programeve për institucionet egzistuese për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Përparim i vazhdueshëm i programeve egzistuese mësimore me qëllim të ngritjes së ndërgjegjes për çështjen e fëmijëve me nevoja të posaçme.
- Përmirësimin e kornizës ligjore për ndërtim, me të cilën do të mundësohet që objektet që janë të ndërtuara të kenë qasje edhe personat me nevoja speciale.
- Është e nevojshme që të krijohet një mundësi hapësinoro-arkitektonike e cila do tu mundësojë hyrje nëpër institucionet edukativo-arsimore personave me nevoja speciale si: adaptim dhe rikonstruim të hapësirës egzistuese, ndërtimin e objekteve të reja sipas standardeve të përcaktuara për qasje në ta.

## 10. MASA SPECIALE MBROJTËSE

### *10.1 Refugjatë dhe fëmijë të zhvendosur në brendi (neni 22)*

<sup>245</sup> Gjatë konfliktit të armatosur në RM në brendi ishin të zhvendosur mbi 72 000 veta (para së gjithash nga nacionaliteti maqedonas nga Tetova, Kumanova dhe fshatrat përreth këtyre dy qyteteve). Në të njëjtën periudhë, mbi 58 000 refugjatë (më së tepërmi të përkatësisë nacionale shqiptare) kalojnë në Kosovë, Sërbinë e Jugut dhe në Turqi. Pas nënshkrimit të marrëveshjes Korrnizë të Ohrit një pjesë e madhe e refugjatëve (mbi 35 000) dhe një pjesë e rëndësishme e personave të çvendosur në brendi (40 000) u kthyen në vendet ku jetonin. Qeveria zhvillon një strategji për kthimin e shpejt dhe të tërësishëm të të gjitha personave të çvendosur. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare bëhet presion kolektiv dhe individual këtyre njerëzve që të kthehen në vendet e tyre të jetesës, pavarësisht nga vullneti dhe dëshira e tyre, në vende ku nuk është e realizuar as siguria elementare për jetë, ku nuk funksionon sundimi i ligjit dhe ku nuk janë të përmbushura kushtet minimale për tu kthyer (shtëpi të rrënuara, mungesë të rrymës elektrike, ujit, ambulanta të prishura dhe jofunksionale, mungesë e shkollave të rregulluara). Ky qëndrim has në rezistencë të fuqishme tek të çvendosurit e brendshëm dhe krijon tensione shtesë tek ta. Pjesa më e madhe e personave të zhvendosur nuk janë të përkujdesur në mënyrë adekuate dhe i kanë të cenuara dhe të rrezikuara një varg it ë drejtave themelore të njeriut (arsimim, mbrojtje sociale, mbrojtje shëndetësore, bashkim të familjeve).

<sup>246</sup> Gjendja me konfliktin e vitit 2001 është se ka persona të zhvendosur të cilët ende jetojnë nëpër vendet për përkujdesjen e tyre (rreth 800). U është ofruar rikonstruimi i shtëpive të tyre, disa i kanë pranuar ndërsa të tjerët vetëm se i kanë përvetësuar këta shtëpi.

<sup>247</sup> MPSS në mënyrë direkte është përgjegjëse për cenimin e të drejtave të fëmijëve-personat e zhvendosur në brendi. Sipas të dhënave nga komiteti i Helsinkit pas pesë viteve nga konflikti i armatosur në teritorin e RM-së (viti 2001) në qendrat kolektive për përkujdesje në Mars të vitit 2006 gjindeshin 160 fëmijë: 50 prej tyre

në moshë deri në 6 vjet, 70 në moshë prej 6-14 dhe 40 mbi moshën 15 vjeçare.

### ***10.2 Eksploatimi ekonomik (neni 32)***

<sup>248</sup> Konkluzioni kryesorë është se ende, për fat të keq, te numri më i madh punëdhënësve mungon njohuria elementare, kuptimi dhe rrespektimi i ligjit për marrëdhënie të punës, i cili në mënyrë decide thotë se ndalohetpunësimi i fëmijëve nën moshën 15 vjeçare dhe Konventa 182 kundër formave më të këqija të punës së fëmijëve e ratifikuar nga ana e Kuvendit të RM-së në vitin 2001.

<sup>249</sup> çështja e punës ilegale, keqpërdorimit të punës së fëmijëve në ekonominë e zezë është diçka që aspak nuk është e hulumtuar dhe e analizuar, ndërsa e njejta egziston dhe negativisht ndikon ndaj të drejtave të fëmijëve.

#### **SHEMBULLI 8:**

Në vitin 2007 një fëmijë 13 vjeçar XX nga Gostivari vdiq gjatë punës në një servis për larjen e veturave.<sup>49</sup> Ky rast tragjik është edhe një vërtetim se keqpërdorimi i punës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë është realitet. Ky është shembull drastic për thyerjen e rregullave të KDF, Konventës kundër formave më të këqija të punës fëmijërore (182) dhe i Ligjeve Nacionale.

<sup>250</sup> Konventa 182 është e ratifikuar, por e njejta ende nuk implementohet mjaftueshëm në praktikë.

<sup>251</sup> Fenomeni i tregtisë më njerëz më së shpeshti paraqitet me qëllim të eksploatimit seksual, por praktika tregon se tregtia me njerëz mund mundet të manifestohet edhe në mënyrë tjetër si eksploatim i punës, robëri përshkak të borxhit, martesë e detyruar, detyrim për të lypur, detyrim që të kryejë vepra penale dhe tregti me organe. Në këtë kategori sa më shumë shfrytëzohen fëmijët, përshkak se para ligjit nuk përgjigjen për veprat e tyre që i kryejnë.

---

<sup>49</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=6BD4007F8821D94280E183242DCA42F9>

<sup>252</sup> Duke pasur parasysh problemin e shfrytëzimit të punës, Porta e Hapur (PH) bëri hulumtim<sup>50</sup> në mënyrë që të forcojnë mendimin publik në lidhje me eksploatimin e punës së fëmijëve dhe të përcjellë një mesazh të qartë për publikun e gjerë për shkaqet dhe pasojat e trafikimit të fëmijëve për shfrytëzimin e tyre, dhe lypjen e organizuar. Për këtë qëllim u dha një intervistë empirike në rrugë, u kontaktuan institucione qeveritare dhe joqeveritare dhe u kërkua mendim për qëndrimet e tyre dhe për implementimin e ligjit në RM.<sup>51</sup>

<sup>253</sup> Trendet moderne në shfrytëzimin e punës së fëmijëve të cilët janë të detyruar të punojnë nëpër rrugë, në kafene, në mbeturina, të ekspozuar ndaj kushteve ekstreme klimatike, dhunës në rrugë, humbjes së kohës, në rrezik nga gazrat lëshuese të automjeteve në rrugë, duke jetuar pa kushte elementare higjienike, pa ushqim të rregullt, shënjestër e lehtë për tu shtyrë në krim, fëmijët e kalojnë kohën e tyre jashtë procesit arsimor për të fituar para. Shumë shpesh fëmijët e rrugës janë jetimë, kanë prindërit e tyre mirëpo prindërit shpesh-herë janë nxitësit në detyrimin e fëmijëve në lypje dhe shitje. Këta fëmijë janë dyfish të lëna pas dore edhe nga ana e shtetit edhe nga ana e prindërve.

<sup>254</sup> Shkaqet përshka të cilëve fëmijët sa më shpesh janë të eksploatuara janë standard ii ulët ekonomik i një pjese të madhe të banorëve, varfëria nëpër familje, shfrytëzimi i fëmijëve nga prindërit e tyre dhe persona tjerë, shkalla e ulët e edukimit të prindërve dhe të fëmijëve, kushtet e vështira për jetesë në shtëpi etj. Hulumtimet nga ana e PH treguan se egzistojnë disa forma të eksploatimit të fëmijëve, lypja në formë të organizuar në grupe për të hollë, ushqim etj.

### **Rekomandimi 30:**

Është e nevojshme të hulumtohet dhe të grumbullohen të dhëna për pjesëmarrjen e fëmijëve në ekonominë e zezë.

---

<sup>50</sup> Hulumtim i bërë nga ana e OJQ-së Porta e Hapur në vitin 2008 mbi 120 fëmijë dhe 16 institucione, ende nuk është i publikuar.

<sup>51</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=6BD4007F8821D94280E183242DCA42F9>

## **a) Fëmijët e rrugës**

<sup>255</sup> Gjatë Shtatorit të vitit 2008 nga ana e MPB në bashkëpunim me MPPS dhe qendrat përkatëse për punë sociale u ndërmorr aksioni i quajtur “Lypje”. Duke e pas parasyshtë se bëhet fjalë për një grup social të lëndueshëm e cila lypjen e përdor si një nga mënyrat e fitimit të mjeteve për jetesë, Komiteti i Helsinkit kërkoi që të lajmërohet nëse janë të parapara ndonjë lloj i beneficioneve për këta njerëz, para së gjithash në drejtim të fitimit të ndihmës financiare për mbulimin e shpenzimeve të përditëshme për jetesë, e më tej edhe në drejtim të ndihmës financiare që të mundën të njejtit ti dërgojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla.

<sup>256</sup> Fakti se shumica e tyre janë shfrytëzues të ndihmës sociale në të holla nuk është i mjaftueshëm, pasi që është e dukshme se e njejtat nuk mjafton as për shpenzimet e përditshme, e lëre më për mbulimin e shpenzimeve të cilët u janë të nevojshme që ti dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla.

<sup>257</sup> Nga ana e organeve kompetente në lidhje me problemin kryesorë - gjendja e keqe financiare e këtyre familjeve, shumë pak është dhënë përgjigje. Përsëri i haket faktit se sigurimi i librave falas dhe pranimit i ndihmës sociale nuk janë zgjidhje për këtë problem. Përveç librave janë të nevojshme edhe harxhime të tjera plotësuese që të mundën prindërit ta dërgojnë fëmijën e tyre në shkollë dhe janë të pabaza të gjitha kanosjet të dërguara deri tek ata që edhe pse nuk kanë mjete materiale ata duhet që ta bëjnë atë.

<sup>258</sup> Abuzimi i fëmijëve për të kryer vepra penale apo veprimtari të paligjshme, që kanë për qëllim kryesisht përfitimin e të ardhurave të paligjshme me anë të krimit të organizuar. Sipas shkallës së rrezikut social të këtyre aktiviteteve të paligjshme mund të dallohet abuzimi i fëmijëve për kryerjen e veprimeve që mund të kategorizohen si shkelje dhe abuzim të fëmijëve për të kryer vepra penale. Në rastin e parë bëhet fjalë për lypje, individualisht ose në kuadrin e një rrjeti të organizuar nëpër lokacione me frekuencë të madhe të njerëzve.



<sup>259</sup> Egzistojnë qendra të kujdesit ditor nën juridiksionin e Ministrisë për PPS (2) dhe të formuara nga OJQ-të (2), ku fëmijët vijnë çdo ditë e të cilët nuk kanë marrë pjesë në procesin e rregullt arsimor për arsye të ndryshme. Shumica e këtyre fëmijëve janë të popullsisë rome. Familjet e tyre nuk kanë vendbanim të përhershëm, dhe pothuajse asnjëfarë kushtesh për mbajtjen e higjienës (nyje sanitare). Shumica e tyre nuk janë të regjistruar në librin amë të lindjes dhe të cilët pjesën më të madhe të ditës e kalojnë rrugë duke lypur.

<sup>260</sup> Në qendrat ditore fëmijët furnizohen me nevojat themelore higjienike (lahen) u jepet veshje, një ushqim dhe përmbajtje themelore edukativo-arsimore. Qendrat ditore nuk janë zgjidhje e përhershme për sigurimin e të drejtave të tyre themelore si shtëpi dhe edukim.<sup>52</sup>

<sup>261</sup> Numri i fëmijëve Romë të lëna nëpër rrugë sa më shumë është duke u zmadhuar.<sup>53</sup> Nuk ka programe konkrete për fëmijët e rrugës me të cilën në tërësi do të mund të zgjidhej statusi i tyre social, arsimor dhe shëndetësorë. Këta fëmijë më së shpeshti dërgohen nëpër qendra për pranim të karakterit të shkurtë, për to ka ushqim të ngrohtë, veshje, dhe joformalisht edukohen, që don të thotë se të njejtit nuk fitojnë dëftesë për mbarimin e vitit shkollor.

<sup>262</sup> Shpeshherë këta fëmijë për disa javë apo muaj përsëri mbarojnë në rrugë, shkakun nuk është dëshira e tyre apo moskënaqja e tyre në lojërat me fëmijët, në qendrat e pranimit, arsyet e tyre janë se ata në shtëpitë e tyre (nëse mund të themi kështu) i presin vëllezër dhe motra më të vogla apo të mëdha, prindër të papunë dhe të paarsimuar, për të cilët shteti nuk ka ndonjë programë përkatëse për adaptimin e tyre dhe kanalizimin e punëve të tyre joformale dhe të përditshme (grumbullimi i mbeturinave për reciklim, hekur, plastikë).

---

<sup>52</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=C5D1DB5D3E75E249A11D60C511483BAC>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=B2EDFD37544F3A42A3F9914769C6E888>

<sup>53</sup> Teksti wshtw i marrw nga komisioni Evropian pwr pwrparimin e Maqedonisw nw vitin 2009.

### **Rekomandimi 31:**

- Formimi i qendrave për pranim në të cilat do të përkujdesen familje të tëra, e me atë do tu mundësohet minimum egzistencë e cila do të rezultojë me lirim të fëmijëve nga rrugët dhe përshtatjen e tyre në sistemin edukativ.
- Zhvillimi i strategjisë për përmbajtjen e familjeve.
- Ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve sociale shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve të rrugës.
- Intervenim direkt dhe ndihmë për fëmijët e rrugës dhe familjet e tyre.

### ***10.3 Eksploatimi seksual dhe tregtia me fëmijë (neni 34 dhe 35)***

<sup>263</sup> Komiteti ishte i shqetësuar se incidentet e abuzimit seksual dhe dhuna familjare nuk janë identifikuar në mënyrë adekuate. Siç është shpjeguar tashmë në pjesën me mbledhjen e të dhënave, te ky lloj i të dhënave mungojnë dhe nuk mund në tërësi të formohet imazhi i gjendjes reale në vend.

<sup>264</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka bërë një program të veçantë për ri-socializimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktimë të trafikimit, i cili ofron riintegrimin e fëmijëve viktimë të trafikimit me njerëz, mbështetjen e zhvillimit të tyre, duke e rrespektuar parimin e mundësive të barabarta, dhe duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, si edhe senzibilizimin e prindërve dhe anëtarëve të familjes.

<sup>265</sup> Programi i ofron rast të veçantë kur fëmija-viktimë nuk është i shoqëruar nga prindi / kujdestari, urgjentisht të caktohet një kujdestar dhe sa më shpejt që është e mundur të kontaktohet familjen nëse ajo është në interesin e tij më të mirë; në qoftë se nuk është e sigurtë kthimi i tij në familje, duhet të ndërmerren masa të veçanta për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijës në përputhje me legjislacionin; të respektohet mendimi i fëmijës (në qoftë se është në gjendje që ta shpreh) për masat e marra për të mbrojtur dhe për të ndihmuar; të marrë masa për mbrojtjen private

dhe identitetin e fëmijës-viktimë, të miratohen programe të veçanta individuale për të mbrojtur dhe mbështetur fëmijët-viktima të trafikimit, në aspektin e tyre fizik, psikologjik, edukativ, kujdesit shëndetësor, dhe strehimit, si dhe obligimin e QPS që të caktojnë një person për shoqërimin e fëmiut i cili do të angazhohet në bashkapunim me organizatat joqeveritare. Lidhja dhe krijimi i rrjetit të punëtorëve profesional (mbrojtja sociale, shëndetësia, arsimi, policia, gjykatat dhe sektori joqeveritar) dhe aplikimin e modelit unik të intervenimit institucional me bashkapunim të siguar, koordinim dhe vazhdimsi. Resocializimi dhe riintegrimi i fëmiut duhet që të realizohet nëpërmjet të trajtimit individual.

<sup>266</sup> Tregtia me njerëz, e me të edhe tregtia me fëmijë shënon ramje në vitet e fundit si rezultat i hyrjes së Republikës së Romanisë dhe Republikës së Bugarisë në UE, e me atë edhe tranzitimi ilegal u largua përmes këtyre dy vendeve.

<sup>267</sup> Mirëpo e njëjta ende egziston dhe në lidhje me të njëjtën vërehet rritja e numrit të viktimave (të vendit), ndërsa zvogëlimi i viktimave të huaja të tregtisë me njerëz. Tregtia e brendshme me njerëz paraqet vënien e të miturve nën prostitucion dhe forma tjera të eksploatimit, si dhe martesat të detyruara. Më gjerë në këtë temë është e sqaruar në Raportin për protokolin fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionit me fëmijë dhe pornografinë fëmijërore.

#### ***10.4 Shfrytëzimi i fëmijëve në prodhimin ilegal dhe tregtinë me droga dhe substanca narkotike (neni 33)***

<sup>268</sup> Në gjashtë muajt e fundit në qendrën e HOPS-it në Shuto Orizari janë evidentuar 10 shfrytëzues të mitur të cilët injektojnë droga, të cilët kanë ardhur së bashku me shfrytëzuesit e rritur, ndërsa një pjesë e tyre edhe nën shoqërimin e prindërve të tyre. Nga të gjithë shfrytëzuesit 9 janë meshkuj, ndërsa njëra është femër. Ata tani janë në moshë prej 9 - 16 vitesh, ndërsa disa nga to kanë filluar që të injektojnë heroin që në moshën 7 vjeçare. Sipas të dhënave që ne i posedojmë, disa nga të miturit rrjedhin nga familjet e shfrytëzuesve të drogës, edhe atë në një rast shfrytëzues të drogës janë vëllezërit

dhe motrat, në dy fëmijë që përdorin drogë, edhe babai i tyre është marrës i drogës.

**SHEMBULLI 7:**

Pas një intervenimi të gjatë social me prindin e fëmiut i cili injekton drogë, e cila nënkupton biseda dhe motivim për shërimin e fëmiut, u erdh deri në pajtim nga prindërit dhe i njejtë të dërgohet në shërim (fëmiu ka filluar që të injektojë drogë që në moshën e tij 9 vjeçare dhe veç dy vite në mënyrë aktive e merr atë).

Me 01.10.2009 u nxorr vërtetimi se prindi dhe i mituri nuk kanë sigurim shëndetësorë sipas asnjë baze. Ditën e ardhshme me të 02.10.2009 në pajtim me babain e fëmiut, nën shoqërimin e ekipit të HOPS-it dhe motrës së tij të rritur i njejtë u dërgua në Klinikën për psihijatri, ku u refuzua pranimi i tij me sqarimin se nuk janë kompetent për pranimin e këtyre rasteve dhe i njejtë u dërgua deri në Klinikën për sëmundje fëmijërore. edhe në këtë klinikë refuzuan që ta hospitalizojnë fëmiun, pasi që ata nuk trajtojnë shfrytëzues të drogave, përkatësisht dhanë sqarim se deri më tani nuk kanë paur asnjë rast të tillë dhe i njejtë më tej u rekomandua që të dërgohet në Klinikën për toksikologji. Edhe në Klinikën për toksikologji fëmiu ishte i refuzuar me sqarimin se ata nuk pranojnë fëmijë nën moshën 14 vjeçare dhe prej aty fëmiu u drejtua që të shkojë në klinikën për sëmundje fëmijërore.

Në insistimin e tepërt nga ana e ekipit të HOPS-it dhe pas bindjes së gjatë se nuk egziston institucion tjetër në të cilën do ta kishin vendosur, fëmiu është pranuar dhe hospitalizuar në departamentin për Pulmologji dhe toksikologji pra në klinikës për sëmundje fëmijërore. Nga klinika pranimin e fëmiut e kanë kushtëzuar që ai vetë të blejë vitamina C dhe B, pasi që ata nuk kanë pasur në klinikë, ndërsa për të kanë qenë të nevojshme. Këta ampula i ka siguruar HOPS-i, pasi që familja e fëmiut nuk ishte në mundësi që ta bëjë të njejtën. Fëmiu duhej që ta kalojë nëpër një detoksikim treditore dhe pas asaj të transferohet dhe të trajtohet në klinikën për psikijatri.

Pasi që është fëmijë me moshë mbi 3 vjeçare nuk është e obliguar që i njejtë të shoqërohet nga prindi gjatë kohës së hospitalizimit. Baba ii fëmiut nuk u pajtua që të vendoset së bashku me të ata tre ditë në klinikën për sëmundje fëmijërore. I mituri pas disa orësh nga hospitalizimi, pasi që është lënë pa mbikqyrje, i ka këputur infuzionet dhe ka filluar që të gjakderdhë, me çka nga personeli i Klinikës për sëmundje fëmijërore u

thirrën punëtorët social nga HOPS-i që tua “kthejnë fëmion”, pasiqë i njëjti qenka qenë problematic dhe u ka penguar personave të tjerë të hospitalizuar. ekipi i HOPS-it bisedoi edhe me babain dhe me kërkesë të tij e ktheu fëmion në shtëpinë e tij. Në këtë moment ky fëmijë edhe më tej injekton droga.

<sup>269</sup> Edhe përkundër tentimeve që të vihet në kontakt me prindërit ose kujdestarët e këtyre fëmijëve, ajo shkon shumë rëndë, përshkak të vendeve jo të përhershme të jetesës, friga nga disa prej prindërve që mos ua marrin fëmion e tyre, informatat e rrejshme nga ana të miturve përshkak të frigës nga reagimi i prindërve etj.

<sup>270</sup> Në RM nuk egziston program i veçantë për shërim dhe rehabilitim të të miturve që përdorin droga. Qendra ndërkomunale për punë sociale në Shuto Orizari më shumë herë me rradhë është informuar për egzistimin e problemit, megjithatë azgjë nuk u ndërmorr në lidhje me atë, ndërsa ne i kemi të lidhur duart, pasiqë na nevojitet pajtimi i plotë dhe bashkëpunimi nga familja, dhe edhe kur ta kishim arritur atë, nuk kemi një lokacion të saktë se ku do të duhej që të drejtohem, pasi që, sikurse edhe përmendëm, nuk egziston programë për ta.

<sup>271</sup> Problem i veçantë paraqet edhe pamundësia e të miturve shfryrëzues të drogës që ti shfrytëzojnë shërbimet për zvoglimin e dëmeve nga përdorimi i drogave pa pajtimin e prindit ose kujdestarit. Në këtë mënyrë ata janë të privuar nga mundësia që të fitojnë këshillim, edukim, motivim për tu trajtuar etj.

<sup>272</sup> Në ndërkohë numri it ë miturve shfrytëzues të drogave rritet, ndërsa pamundësia që të punohet me ta sjell deri te praktikimi i sjelljes së rrezikshme - përdorimi i mjeteve josterilizuese për injektim, injektim i pasigurtë, praktikimin e marrëdhënieve seksuale të pasigurta etj. Me këtë rriten edhe rreziqet nga dozimi i tepërt dhe bartja e HIV-it, sëmundjes së Hepatitis C dhe sëmundje tjera bartëse nëprmet gjakut ose nëpërmjet marrëdhënieve seksuale.

<sup>273</sup> Asnjë institucion nuk dëshiron që të përkujdeset për fëmijët e varur nga heroina dhe nga ngjitësi (lepaku). Prindërit dhe fëmijët janë të lëna vetë, pasiqë asnjë institucion nuk dëshiron që të

përkujdeset për të miturit në moshën prej 5 deri 14 vjeçare, të cilët veçmë disa vite janë të varur nga heroina dhe nga ngjitësi. Qendra për shëndet mental nuk kanë qenë në mundësi që tu ndihmojnë pasiqë punojnë vetëm me raste të fëmijëve që e kanë "provuar drogën", e jo edhe me fëmijë të cilët janë të varur nga drogat. Këtyre të miturve iu nevojitet ndihmë konstante medicinale dhe psikologjike, pasi që nuk egziston institucion i cili është i pregaditur që tu ndihmoje përshkak të moshës së tyre. Policia është e njoftuar me këta raste përshkak të aktiviteteve të shpeshta kriminale në të cilat hyjnë. Poashtu e kanë të njohur se fëmijët blejnë heroin edhe vetëm për 100 denarë, por nuk ka strategji se si të pengohet kjo.<sup>54</sup>

<sup>274</sup> Problemi me rritjen e individëve shfrytëzues të narkotikëve kërkon qasje sistematike nga ana e institucioneve relevante (shkollave, qendrave, ministrive, institucioneve shëndetësore).

<sup>275</sup> Në shtetin tonë nuk ka rehabilitim për fëmijë, fëmijët të cilat kanë problem të këtyllë i dërgojnë në qendrën për tu larguar nga drogat që janë të specializuara për shfrytëzuesit e rritur e jo për të miturit.

<sup>276</sup> Me nenin 6 të Ligjit për emërimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë, numër.83/09 nga data 03.07.2009) ndryshohet neni 9 nga ligji egzistues për mbrojtjen e fëmijëve dhe i njehti përmban këtë: ***Alinea*** 3) „Shteti dhe institucionet e sistemit i ndërmarrin të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve prej përdorimit ilegal të drogave dhe formave tjera të keqpërdorimit të fëmijëve në prodhimin ilegal dhe tregtinë me droga dhe me supstanca psikotropike dhe iprekurzorë .”

### **a) Adoleshentë të cilat injektojnë droga**

<sup>277</sup> Adoleshentët të cilët injektojnë droga (AID) nuk mundohen që të kontaktojnë me qendrat për punë sociale, asqë janë të njoftuar me funksionin e tyre dhe shërbimet të cilat ata i sigurojnë. Lidhshmërinë e vetme e bëjnë vetëm nëpërmjet të ndihmës në të

---

<sup>54</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=572195574BB1EA478C05C93C26C9DED6>

holla, në mënyrë popullore e quajtur si “ndihmë sociale”, të cilën e fitojnë prindërit e tyre përshkak të statusit të ulët social.

<sup>278</sup> Shumë pak nga AID të cilat kontaktojnë me qendrat për punë sociale, aty janë të sjellura përshkak të delikuencës së të miturve, dhunës familjare ose problemit të ngjajshëm social, e më pas nëoërmjet të bisedave përcaktohet se ata përdorin / injektojnë droga. Shërbimet të cilat qendrat për përkujdesje sociale i mundësojnë (në pajtim me ndryshimet e bëra në Ligjin për mbrojtje sociale nga viti 2004, për PID, duke i inkuadruar këtu edhe AID), janë: përkujdesja ditore e “personave të cilat përdorin droga dhe supstanca tjera psikotropike edhe të anëtarëve të familjeve të tyre, shërbime këshilldhënëse, informim, këshillim dhe edukim, angazhim me punë, aktivitete kulturoro-zbavitëse” (Trajanoski, 2005:48). Por fitohet përshtypja se shumë pak AID të kyçura në këtë programë janë të detyruar që të marrin pjesë nëpër këshillimet, përshkak të ndonjë mase ligjore ose ndëshkimore dhe çdoherë në prezencën e prindit.

<sup>279</sup> Sipas Kushtetutës së RM-së, secilit qytetarë i garantohet e drejta në mbrojtje shëndetësore dhe njëkohësisht përcaktohet obligimi i qytetarit që ta mbroj dhe përmirësojë shëndetin e tij personal dhe shëndetin e të tjerëve (neni 39 i Rregullores). AID të përfshirë me hulumtimin rralëherë kur tregojnë se kanë nevojë nga trajtimet shëndetësore të cilët nuk janë të lidhur me përdorimin e drogave dhe dëmet e shkaktuara përshkak të injektimit të tyre. Në rastet e rralla të paraqitjes së dukurisë së apcepsit, tromboflebitit dhe çrregullime të ngjajshme shëndetësore, të shkaktuara nga injektimi i gjatë dhe joadekuat i drogave, AID drejtohen nëpër programet për zvoglimin e dëmeve nga përdorimi i drogave. Këtu duhet që të përmendim se kesi soj të programeve egzistojnë vetëm nëpër qytetet e përfshira me hulumtimin e këtillë, por jo edhe në të gjitha qytetet nëoë të cilët kemi njohuri se se ka AID. Për prishjet e barazpeshës së zakonshme shëndetësore (ftohje ose grip) fitojnë ndihmë nga mjekët amë, por egzistojnë raste kur personat e punësuar aty të njoftuar me shprehinë e tyre mundihen që së paku ti këshillojnë, por në mënyrë jopopullore për AID. Asnjëri nga të anketuarit nuk ka qenë i refuzuar gjatë kërkimit të ndihmës nga mjeku, por përmenden

shembuj tjerë të AIDnga të cilëve nuk u është e dhënë ndihma e nevojshme financiare.

<sup>280</sup> arësia, ndërsa ata të cilat nuk kanë qenë në asnjë tretman për tu shëruar përshkak të insistimit të prindërve, pa aplikimin e terapisë supstanciale, ndryshe e quajtur edhe si “detoksikim i thatë” por pa rezultate afatgjate. Ka raste kur prindërit mundohen që ti bindin fëmijët e tyre që të shërohen me anë të terapisë së tyre personlale, duke e favorizuar vetëm dëshirën e fortë të tyre. Nuk ka shumë AID të cilët shërohen nëpërmjet të terapisë supstitucionale e njohur më gjerë si “terapi e metadonit” më së shumti për shkak të mungesës nevojës për tu shëruar nga varësia, por edhe për shkak të shkallës së lartë për pranimin e këtyre trajtimeve për AID (Gajdzis-Knezheviq etj.,48). Problemet steës gjatë shërimit me metadon janë mosegzistimi i programeve për trajtim supstitucional në Maqedoni ku ka shumë PID ose kapaciteteve të kufizuara të programeve egzistuese. Në qytetin e Kumanovës, kësi lloj programi u hap qysh në vitin 2005, në Gostivar aspak nuk egziston program për trajtimin e terapisë supstitucionale, ndërsa programi më i lashtë i këtillë në Maqedoni e cila gjindet në Shkup, veç më disa vite është e mbyllur për pranimin e personave të rinj që janë të varur nga drogat. Të gjitha përpjekjet e deritanishme që të happen edhe disa qendra të reja në Shkup ishin të pasuksesshme. Këta inicijativa hasin shpesh në kundërshtim nga të gjitha faktorët në jetën shoqërore, duke filluar nga punëtorët në sferën e shëndetësisë, vetqeverisja lokale dhe nga popullata. Në kushte të stigmatizimit disashkallorë PID, duke i numëruar këtu edhe AID, jo vetëm që dita ditës po vështirësohen kushtet për shërimin e tyre, por thyhen edhe të drejtat e tyre për mbrojtje shëndetësore, ndërsa zmadhohet edhe rreziku nga zgjerimi i HIV/SIDËS, sëmundjes së hepatitis B dhe C dhe sëmundjeve tjera sikurse janë sëmundjet e bartshme seksuale - SBS.

<sup>281</sup> Egziston nevoja që të zgjerohen programet educative shkollore për shëndetësi që të zgjerohet edhe njohuria e nxënësve për ushqimin, higjienën, dhunën dhe lëndimet e padashtura, shëndeti mental, përdorimi i duhanit, përdorimi i alkoolit dhe drogave, sjellja seksuale e cila në të shumtën kontribon për infektimin me



HIV dhe SBS të tjera si edhe shtatzani, aktivitetet fizike dhe faktorët mbrojtës për ndryshimin e sjelljes së rrezikshme.

### **Rekomandimi 32:**

- Hepje urgjente e një Qendre të posaçme për të miturit e varur nga droga ndaras nga të moshuarit/rriturit.
- Zhvillimin e programeve për mbrojtje nga përdorimi i drogave me kthim të posaçëm të fëmijëve për prevenim nga drogat me një kthim të veçantë kah fëmijët të cilat nuk gjinden në sistemin e rregullt arsimor.
- Trajnimi i ekipeve nga qendrat sociale të cilët do të jenë vazhdimisht në teren dhe do ti zbulojnë këta të mitur dhe do ti ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për shërimin e tyre.

### ***10.5 Jurisprudenca për të mitur (neni 37, 39 dhe 40)***

<sup>282</sup> E përshëndesim Qeverinë për sjelljen e Ligjit mbi të drejtën e të miturve i cili u pru që në vitin 2007, ndërsa filloi që të përdoret nga 1- Shtatori i vitit 2009. Në pajtim me Ligjin mbi të drejtat e të miturit, është e paraparë që fëmijët të japin dy, maksimalisht tre deklaratat, mirëpo në drejtim të interesit më të mirë të fëmijëve, dhe ne konsiderojmë se fëmijët është e nevojshme që të japin vetëm një deklaratë të tillë, në një dhomë të specializuar “skrin dhomë”, në prezencën e ekipit profesional (psikologut, pedagogut, punëtorit social).

<sup>283</sup> Patjetër duhet që të përmendim se që nga fillimi i implementimit të këtij ligji në vendet më të vogla u paraqitën probleme pasi që kishte mungesë të numrit të gjykatësve të nevojshëm për të mitur. Kështu në disa gjykata ka vetëm nga një gjyqtarë për të mitur, dhe shpesh ndodh që i njejt i gjyqtar të vendosë edhe në shkallën e parë (instancën e parë), e më pas edhe sipas ankesës së vendimit të tij kur vendos këshilli penal i asaj gjykate. Njëra nga opsionet të cilën e rekomandojnë ekspertët është që të kërkohet hjekje nga ana e gjyqtarit, por ajo do të ndikojë vetëm në zgjatjen e procedurës. Është e nevojshme që në të gjitha gjyqet me kompetenca të zgjeruara të ketë të punësuar minimum dy gjykatës për të mitur.

<sup>284</sup> Edhe përkundër shpalljes së parimit të promovimit të dinjitetit dhe vlerës së secilit fëmijë dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të tjerëve, sipas raportit të komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në RM nga i 28.08.2006, policia dhe vendet në të cilat fëmijët janë duke vuajtur dënim paraqesin institucione të cilat do të duhet që të mbajnë llogari të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të bazuar në nenet 37, 39 dhe 40 të Konventës për të drejtat e fëmiut. Sipas Raportit, në praktikë mungesa e obligimeve dhe procedurave saktësisht të definuara në veprimin me fëmijë (në rregulloren lidhur me punën e policisë) dhe mungesën e implementimit të standardeve të përmbajtura në ligjet me të cilat rregullohet vendosja dhe veprimi me fëmijët në institucionet e mbyllura, paraqesin shkas për një numër të madh të cenimeve të të drejtave të fëmijëve dhe rrezikimin e jetës dhe zhvillimit të tyre.<sup>55</sup>

<sup>285</sup> Në Ligjin mbi të drejtat e të miturve nuk është e dhënë një definicion konkret për fëmijën. Në vend që ligjvënësi të parashikojë ashtu sikurse është e paraparë në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve se fëmijë është secili person deri në mbushjen e moshës 18 vjeçare, e më pas të bëjë gradacion të termeve varësisht nga mosha e fëmiut, ai implementon një qasje të komplikuar me përdorimin e disa termeve të ndryshme.

<sup>286</sup> Shteti duhet që të sigurojë masa më të mëdha (risocializim dhe riintegrim) për integrimin e këtyre personave në sistemin e mbajtjes (vuajtjes) së sanksioneve të tyre.

<sup>287</sup> Ligji për mbrojtje juridike falas edhe përkundër periudhës së gjatë të pregaditjes së tij është në procedurën parlamentare, por i njëjti nuk i len jashta edhe lëndët të cilat do të udhëhiqen sipas Ligjit mbi të drejtat e të miturve.

### **Rekomandimi 33:**

- Harmonizim terminologjik të ligjit për të drejtat e të miturve me KPF dhe përdorimin e termit fëmijë deri në moshën 18 vjeçare.

---

<sup>55</sup> Raport i komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në republikën e Maqedonisë nga 28.08.2006.

- Është e nevojshme që në të gjitha gjykatat me zgjerim të kompetencave të ketë të punësuar së paku dy gjyqtarë për të mitur.

### ***10.6 Fëmijë që u përkasin minoriteteve***

<sup>288</sup> Shteti e ka ratifikuar Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. Në vazhdim është pregaditja e Ligjit për luftë kundër diskriminimit dhe presim që ai të paraqesë bazë të shkëlqyeshme për luftën kundër diskriminimit të grupeve minoritare. Megjithatë, edhe përkundër kësaj, fëmijët e romëve nuk i gëzojnë të gjitha të drejtat (bile as ata themelore -më detalisht është e sqaruar në nenet e veçanta të raportit).

## REKOMANDIME KRYESORE:

### REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

- Të formohet Avokati popular për fëmijë si një institucion i veçantë i cili do të jetë i përkushtuar tërësisht mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual.
- Ratifikimi i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me nevoja speciale në kuadër të OKB.
- Sjelljen e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi nëpërmjet të cilit dizajnohen masa të cilat nuk do të lënë zbrazëtira juridike për tolerimin e cilësdo formë të diskriminimit.
- Të inkorporohet parimi i interesit më të mirë të fëmijut në jurisprudencë si parim udhëheqës (konkretisht nuk është i përmbajtur në Ligjin mbi familjen).
- Përparimi i Ligjit për mbrojtje sociale në drejtim të zmadhimit të mjeteve financiare të cilat ndahen.
- Përparimi i kornizës ligjore për arsimin inkluziv si dhe zhvillimin e mekanizmave për implementimin esaj.
- Përparimi i rregullave ligjore me të cilat do të garantohet e drejta e qasjes, jo vetëm qasjes fizike, por edhe të qasjes esenciale ndaj shërbimeve. Ky problem kalon nëpër të gjitha çështjet dhe problemet e fëmijëve (personave) me nevoja speciale në realizimin e të drejtave të tyre.
- Ndryshimi i jurisprudencës në drejtim të rregullimit të obligimit të shtetit për lajmërimin e fëmijëve menjëherë pas lindjes së tyre.

### REKOMANDIME SPECIFIKE

- Lirimin nga participimi gjatë realizimit të së drejtës për mbrojtje sociale për TË GJITHË fëmijët.
- Inkuadrimin e të GJITHA fëmijëve në arsimin e obligueshëm fillor.
- Ngritjen e kapacitetit të qendrave për punë sociale dhe shërbimeve kompetente në Ministrinë për punë dhe politikë

*sociale përmes reformave organizacionale, personale dhe themelore dhe edukim të vazhdueshëm të kuadrove.*

- *Qasje 24-orëshe e të gjitha qendrave për punë sociale.*
- *Punësim të obligueshëm të punëtorëve social dhe defektologëve në të GJITHA shkollat fillore.*
- *Implementim direkt të Konventës.*
- *Të punësuarit nëpër Qendrat për punë sociale duhet që çdo ditë të jenë në teren, në kohë më të hershme ti zbulojnë familjet që janë në rrezik dhe të parandalojnë dhunën e mundshme dhe keqpërdorimin mbi fëmijët nëpër familjet disfunktionale.*
- *Për mbrojtje më të mirë nga dhuna familjare QPS ta praktikojnë mekanizmin e mbikqyrjes së forcuar të së drejtës prindërore ose hjekjes së të drejtës prindore.*
- *Përshejtimin e procesit të decentralizimit dhe promovimin e konceptit të deinstitutionalizimit dhe promovimin e konceptit për jetesë të pavarur.*
- *Zhvendosje urgjente të shtëpisë edukativo-përmirësuese - Tetovë në një vend më të përshtatshëm dhe më adekuat, dhe në një kohë më të shkurtër të mundshme të miturit e gjinisë mashkullore në entin edukativo-përmirësues të jenë të ndarë nga të rriturit e burgosur në burgun e Shkupit, ndërsa të miturit tjerë të gjinisë femërore nga departamenti i grave nga IPN Idrizovë.*
- *Qeveria të hartojë kritere për kushtet për financim të barabartë të OJQ-ve të cilat punojnë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat praktikojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe e rrespektojnë mendimin e fëmijëve si edhe rritjen e mjeteve për OQ të cilat punojnë me fëmijë.*
- *Trajnime të rregullta për institucionet shtetërore, komunat, shkollat, prindërit, mediumet, nëpunësit shtetërorë të cilat e aplikojnë KDF.*

***Koalicioni Nacional për të drejtat e fëmiut  
Republika e Maqedonisë***

*Koordinuar nga ambasada e parë në botë MEGJASHI*

*1000 Shkup, Kosta Novakoviq 22 a, Maqedoni*

*Tel. +389 2 2465 316; mejl/faks +389 2 2463 900*

[info@childresembassy.org.mk](mailto:info@childresembassy.org.mk)

[www.childresembassy.org.mk](http://www.childresembassy.org.mk)

**RAPORT ALTERNATIV**

**i organizatave joqeveritare ndaj raportit Inicues të republikës së Maqedonisë sipas protokolit Fakultativ të Konventës për të drejtat e fëmiut në lidhje me tregtinë me fëmijë, prostitucionin fëmijëror dhe pornografinë fëmijërore**

**(nga Shkurti i vitit 2008)**

**Shkup, 2009**

## TABELA E SHKURTESAVE

<b>AOSHS</b>	Adoleshentë të cilët ofrojnë shërbime seksuale
<b>IOM</b>	Organizata ndërkombëtare për megrim
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPPS</b>	Ministria për Punë dhe Politikë Sociale
<b>QNPS</b>	Qendra ndërkombetare për punë sociale
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>OPSC</b>	Protokoli fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionit me fëmijë dhe pornografinë fëmijërore
<b>PH</b>	Organizata Joqeveritare Porta e Hapur
<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë
<b>IBS</b>	Infektive të bartshme seksuale
<b>UNICEF</b>	Fond për fëmijët praën Kombeve të Bashkuara
<b>QPS</b>	Qendër për Punë Sociale

## **1. HYRJJE**

Raporti Alternativ i OJQ-ve ndaj raportit Inicues shtetëror të Republikës së Maqedonisë sipas protokolit Fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijut për tregti me fëmijë, prostitucioni me fëmijë dhe pornografi fëmijërore është i përpiluar nga *Koalicioni Nacional për të drejtat e fëmijëve - Republika e Maqedonisë (Koalicion joformal i formuar që në vitin 1997.) si aktivitet* projektues i ambasadës së Parë për fëmijë në botë MEGJASHI. Për nevojat që të pregaditet raporti në vitin 2009 u ripërtëri dhe u zgjerua ky KNDF me organizata të reja dhe dy koalicione (të gjitha janë të reja përveç Këshillit për preventim nga delikuenca e të miturve nga Kavadari dhe ambasada e Parë për fëmijë Megjashi).

Në hartimin e raportit Alternativ morrën pjesë shoqata qytetarësh (21) dhe koalicione të shoqatave të qytetarëve (2):

- 1. Asociacioni për Inicijativa Demokratike (ADI) - Gostivar**
- 2. Asociacioni për edukatë shëndetësore dhe kërkim - HERA- Shkup**
- 3. Inicijativa qytetare e grave Antiko - Kërçovë**
- 4. Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë - Shkup (koalicion i 17 OJQve)**
- 5. Lajfstart - Manastir**
- 6. Maqedonia pa diskriminim (bashkësi e 11 OJQve)**
- 7. Forumi rinor edukativ - Shkup**
- 8. Dera e Hapur - La Strasa - Shkup**
- 9. Hapeni dritaret - Skopje**
- 10. Post polio grupi për mbështetjen e Polio Plus - Shkup**
- 11. Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi - Shkup**
- 12. Phurt - Delçevë**
- 13. Këshilli për preventivë nga delikuenca për të mitur - Kavadar**



- 14. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë - Shkup.**
- 15. HOPS Opcione për jetë të shëndoshë - Shkup**
- 16. Shoqata Humanitare Nëna - Kumanovë**
- 17. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Dibër.**
- 18. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Gostivar.**
- 19. Qendra për bashkëpunim Ballkanik “ Loja” - Tetovë**
- 20. Qendra për iniciativë qytetare - Prilep**
- 21. Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve - Shkup**
- 22. Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë**
- 23. Shellter qendra - Shkup**

Në pregaditjen e raportit të shtetit në lidhje me protokolin Fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionit fëmijëror dhe pornografinë fëmijërore nuk ishin të kyçura organizatat joqeveritare. Raporti alternative është i përbërë në bazë të të dhënave dhe praktikës së përditshme e cila rrjedh nga përvoja e 23 organizatave joqeveritare të cilat mirrin pjesë në pregaditjen e raportit.

Edhe pse marrëveshja Fakultative ndaj Konventës për të drejtat e fëmijut për tregti me fëmijë, prostitucionit fëmijëror, dhe pornografisë fëmijërore u soll në Njujork me 25 Maj të vitit 2000, ndërsa i ratifikuar nga ana e Republikës së Maqedonisë me 17 Tetor të vitit 2003, ai ende nuk është gjerësisht i shpërndarë nëpër popullatën. Në fakt, institucionet publike si (shkollat, entet shëndetësore, gjykatat, komunat, qendrat për punë sociale, etj.) nuk janë të njoftuara me këtë protocol Fakultativ, dhe në pajtim me këtë nuk e praktikojnë të njejtin në aktivitetet e tyre të përditshme

Prindërit the fëmijët gjithashtu gjeneralisht nuk janë të njoftuar me këtë protocol, që paraqet një lëshim të madh nga ana e Qeverisë, pasi që ata direkt janë të përfshirë në nenet e shënuara të këtij protokoli.

## 2. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Koalicioni e përshëndet sjelljen e planit Nacional për aksion për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimi seksual dhe pedofilia<sup>56</sup> si dhe përpjekjet e Qeverisë së RM-së për implementimin e tij të shpejtë dhe efikas. Prapëseprapë duhet që të potencohet transparenca e pamjaftueshme dhe mosafirmimi i këtij plni Nacional, poashtu edhe mosafirmimi i protokolit Fakultativ për shitjen e fëmijëve, prostitucionit fëmijëror dhe pornografisë fëmijërore. Gjithashtu, duhet që të përmendet se në planin Nacional për aksion nuk është i inkorporuar implementimi e obligimeve që dalin me OPSC-në, as që është e marrë parasyshtë Deklarata dhe Agjenda për aksion dhe obligimi Global i sjellur në Kongresin e Parë dhe të Dytë Botërorë kundër eksploatimit seksual komercial të fëmijëve. (Stokholm 1996; Jokohama 2001)

Nuk mbahet llogari e veçantë për fëmijët viktime të keqpërdorimit seksual dhe pedofilisë dhe të trafikimit me njerëz. Shpesh fëmiju viktimë kthehet në familje aty ku më parë ka përjetuar dhunën. Kjo do të thotë kalim nëpërmjet presioneve shtesë nga më të afërmit për dhunën - përdhunimin, dhe mundësi i njejtë të detyrohet që të heshtë. Në Maqedoni nuk ka qendra speciale shtetërore për pranimin e fëmijëve viktime të keqpërdorimit seksual, për pranimin e viktimave të dhunës familjare dhe keqpërdorimit seksual.

### **SHEMBULLI 1:**

I tillë ishte rasti me personin XX i cili ishte viktimë i tregtisë me njerëz në fshatin e Tetovës Zhelinë. Pas gjetjes së saj dhe ngritjen e padive penale kundër kryesve, vajza është kthyer në shtëpinë e saj prej nga ku e njejtë disa herë me rradhë ka ikur, ndërsa siç fituam informata nga ana e Qendrës për punë sociale jooficialisht kanë disponuar me të dhëna se herën e parë mu prindërit e kanë kyçur vajzën e tyre në atë rrjet të tregtisë me njerëz. As me vajzën, as me prindërit nuk është punuar nga ana e shërbimeve kompetente me sqarimin se ata nuk kanë mundësi që të shkojnë në teren përshkak të mungesës së pajisjeve teknike, ndërsa në

---

<sup>56</sup> Në seancën e 30të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me 18.11.2008 u soll PLANI AKSIONAL PËR PARANDALIM DHE MENAXHIM ME KEQPËRDORIMIN SEKSUAL TË FËMIJËVE DHE PEDOFILINË 2009-2012.

thirrjet për bisedë të cilat i kanë dërguar deri tek familja askush nuk është përgjigjur.<sup>57</sup>

Është e nevojshme që institucionet e sistemit të jenë të kujdesshëm ndaj fëmijëve viktimë të keqpërdorimit seksual. Nëse procedura tek institucionet kompetente është e kryer në mënyrë joadekuate dhe joprofesionalisht e kryer ose për shembull fëmiju prap ballafaqohet me dhunuesin - paraqet përsëritje të dhunës, vetëmse në këtë rast përveç dhunës së përjetuar seksuale, fëmiju përjeton edhe dhunë psiqike shtesë edhe nga vetë institucioni, përkatësisht nga disa persona profesional të kyçur në procedurë. Propozojmë dëshmim edhe atë në dhoma të specijalizuara ose skrin dhoma në prezencë të gjykatësit, punëtorit social dhe inspektorit policor i veshur me rroba civile. Video argumentimi do ti mundësojë gjykatësit që të mos e ballafaqojë viktimën me dhunuesin bile edhe në insistim të mbrojtësit të tij. Gjithashtu dënimet e gjykatësve më së shpeshti e prekin minimumin ligjor dhe çdoherë nuk janë të arsyeshme në raport me rëndësinë e veprës penale.<sup>58</sup>

### **3. TË DHËNA, ANALIZA DHE STATISTIKA**

#### ***3.1 prostitucioni i fshehur dhe tregtia me njerëz***

Rezultatet nga hulumtim “Vlerësimi i qëndrimeve dhe njohurive të popullatës së adoleshentëve për fenomenin e prostitucionit të fshehur dhe tregtisë me njerëz”.<sup>59</sup> e vërtetuan egzistimin e prostitucionit të fshehur ndërmjet të rinjve: 33,2% e të anketuarve janë përgjigjur se njohin persona të cilat për ndonjë kundërshtëpërblim material japin shërbime seksuale, nga të cilët 58,7% janë përgjigjur se ata persona janë bashkëmoshatarë të tyre. 5,1% nga i gjithë numri kanë konfirmuar se atyre personalisht u është ofruar shpërblim material për shërbim seksual.

---

<sup>57</sup> Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë.

<sup>58</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=C227132F03478244B7879A9AC600CC00>

<sup>59</sup> HOPS – Opcione pwr jetw tw shwndoshw, Shkup

U vërtetuan edhe parashikimet se numri më i madh i të rinjve konsiderojnë se ardhmëri më të mirë do të kishin pasur jashta shtetit (65,1%), ndërsa 33,6% vetëmse janë duke u menduar për të punuar jashta shtetit. Gjatë kësaj, një pjesë e madhe e të rinjve aspak nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet me të cilat mund që të ballafaqohen nëse shkojnë jashta vendit dhe kryesisht bazohen në informatat të cilat sillen në rrethin e grupeve të moshatarëve të tyre, dhe njëherit duke mos pasur një pamje të qartë për dallimin ndërmjet rënien në prostitucion me vullnetin e tyre dhe tregtinë me njerëz, duke menduar se pjesa më e madhe e viktimave të tregtisë me njerëz vetë janë fajtorë për atë që u ka ndodhur (47,1%), kështuqë ata vetë nuk mendojnë se mund të bëhen viktimë e tregtisë me njerëz (75,8%).

Për fat të keq, deri më tani shumë pak para audiencës është parashtruar pyetja për egzistimin e këtyre dukurive, e as që është sinjalizuar se duhet të vepohet në këtë drejtim, me çka ka të bëjë edhe mungesa e aksioneve për parandalimin e të njejtave.

### **Rekomandimi 1**

Krijimin e aktiviteteve parandaluese të cilat do të mundën të drejtohen ndaj:

- Organizimit të kampanjave publike me qëllim të ngritjes së çështjes për prostitucionin e fshehur dhe tregtinë me njerëz në mes të rinjve në audiencën e përgjithshme dhe rritjen e ndërgjegjes për egzistimin e këtyre dukurive.
- Inicimin e koordinimit dhe qasjes multisektoriale ndaj problemit të prostitucionit të fshehur dhe tregtisë me njerëz në mes të popullatës së të rinjve në bazë të parimit të ndarjes së përgjegjësisë me kyçjen e të gjitha aktorëve relevant (prindërit, institucione arsimore, Ministrinë relevante, organizatat joqeveritare lokale dhe organizata ndërkombëtare të cilat punojnë në problemin etj.)
- Trajnim për kyçjen e medimeve si instrument më i fuqishëm për aktuelizimin e problemit.
- Zhvillimin e programeve specifike të drejtuara ndaj neutralizimit të faktorëve social dhe ekonomik të cilat sjellin

deri te paknaqësia, mospasja e perspektivës dhe nevojë që të shkohet jashta shtetit - varfëri, papunësi etj.

Problemi i tregtisë me njerëz përjetoi ndryshime në disa vitet të fundit. Maqedonia ishte shtet tranzitues dhe destinacion për viktimat e tregtisë me njerëz nga Evropa Jug-Lindore kryesisht për shkak të eksploatimit seksual. Sipas informative nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), në disa vitet e fundit u zvogëluua numri i shtetasve të huaj, viktimat të tregtisë me njerëz, në llogari të zmadhimit të numrit të shtetaseve Maqedonase të cilat trafikohen në Maqedoni. bëhet fjalë për të ashtuquajturën trafikim i brendshëm me njerëz, ku vajzat nga maqedonia, kryesisht të mitura shiten prej te njëriskaj e deri te skaji tjetër i Maqedonisë.

Gjatë vitit 2008 janë zbuluar dhjetë vepra penale dhe 25 kryes të tyre, nga të cilët nëntë janë vepra penale “tregti me person të mitur”, të kryera nga 21 veta dhe një vepër penale “tregti me njerëz”, e kryer nga katër persona. rastet e zbuluara në këtë lëmi, në krahasim me vitin e kaluar janë gati se tre fish të rritura.

Në vitin 2007 janë zbuluar disa vepra “tregti me njerëz”. Në të gjitha rastet, shumica e viktimave janë shtetase të Maqedonisë dhe të njejtat janë në moshë prej tetë deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare.

Numri më i madh i vajzave janë nga Shkupi - tetë, ndërsa të tjerat janë nga Gjevgjelia, Shtipi dhe Kavadari. Në të gjitha rastet, shumica nga viktimat, nga ana e pronarëve të objekteve afariste kanë qenë të eksploatuara me punë, përkatësisht kanë punuar si shërbyese, vallzuese ose shoqëruese të mysafirëve, katër nga to kanë qenë edhe seksualisht të eksploatuara dhe fizikisht të malltretuara, në një rast, dy nga viktimat kanë qenë seksualisht të eksploatuara me dijen e prindit, ndërsa në rastin e fundit të realizuar, vajza, prej kur është dërguar jashta shtetit, ka qenë e eksploatuar me punë dhe seksualisht, si edhe e malltretuar fizikisht nga “burri” i saj dhe të afërmit e familjes së tij.<sup>60</sup>

---

<sup>60</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Komisioni Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit illegal RAPORTI VJETOR 2008

Studimi në vitin 2006, i bërë nga ana e UNICEF-it, erdhi në përfundimin se, në bazë të të gjitha informatave ku ka qasje, se ndërmjet vitit 2002 dhe 2006 rreth 85 fëmijë me prejardhje nga Maqedonia kanë qenë objekt i tregtisë me njerëz ose në kufijtë e Maqedonisë ose ndaj destinacioneve tjera. Në studim thuhet se Maqedonia jovetëm që është vendtranzit por edhe destinacion, poashtu është edhe vend nga ku rrjedh tregtia e palejueshme, në studime parashikohet se gjithsej ka pasur rreth 155 viktima të tregtisë së palejueshme (85 fëmijë nga maqedoni dhe 70 të huaj). Sipas të dhënave statistikore nga organizata Ndërkombëtare për megrim (IOM), deri më tani në Maqedoni janë të regjistruara 771 rast të tregtisë me njerëz nga të cilët 100 (ose 12.9 përqind) janë të mitur.

Prapëseprapë, patjetër duhet që të thuhet se ka dallime në kriteret e përdorura për identifikimin e viktimave të tregtisë me njerëz nga ana e Qeverisë, organizatave joqeveritare dhe agjencioneve multilaterale, të cilat ndonjëherë sjellin deri te dallimet në statistikën e viktimave në vend.

Këtë fakt e vërteton edhe statistika e portës së Hapur për vitin 2008. Në fakt nga gjithsej 11 të femra të përkujdesura të vendosur dhe të ndihmuara, 10 kanë qenë të mitura, shtetase të Maqedonisë, të cilët janë nga kombësitë e ndryshme dhe të cilët vijnë nga familjet e varfura dhe disfunktionale.

### **Institucionet shtetërore nuk kanë të zhvilluar programe psiko-sociale për fëmijët viktima nga tregtia me njerëz.**

OJQ-të fëmijëve që janë viktima të tregtisë me njerëz të cilët janë të vendosur në qendrën për pranim të Portës së Hapur për viktimat nga tregtia me njerëz, u ofron ndihmë psiko-sociale dhe dhënien e mbështetjes nëpërmes të programeve më të ndryshme individuale. Për secilin fëmijë hartohet plan individual i cili i përfshin të gjitha segmentet (bazat për gjienë elementare, mënyrën e sjelljes ndaj bashkëmohatarëve dhe më të moshuarve, mënyrën e veshjes e cila i përshtatet moshës, tolerance ndërmjet veti dhe tolerana ndaj të tjerëve, kthimi në rrjedhat normale të jetesës (tek këta persona

bioritmi është i prishur), ushqimi i rregullt, kyçja në procesin edukativ dhe këshillimi ndaj nevojës së procesit edukativ, vënien e kontakteve me familjen dhe me të afërmit e tjerë, kthimi në mjedisin ku jetojnë dhe pranimin e të njejtit etj.)

### **Rekomandimi 2:**

Është e nevojshme që të bëhet aplikimi i programeve specifike parandaluese për ngritjen e vetëdijes publike, duhet që të ndërmerren aktivitete për veprim direkt tek shkaktuesit kryesorë të tregtisë me fëmijë, sikurse janë: varfëria, shkyçja sociale, qasje e pamjaftueshme deri te arsimimi dhe shërbime të tjera.

E nevojshme është që të formohen qendra speciale për përkujdesjen e fëmijëve viktimë të tregtisë me njerëz ku do të sigurohe programe adekuate për rehabilitim dhe reintegrim.

### ***3.2 Keqtrajtimi seksual dhe pedofilia***

Sipas informatave që i regjistruam në popullatë dhe në paraqitjet në SOS telefonin për fëmijë dhe të rinj 0800 1 2222 pranë ambasadës së Parë për fëmijë në botë Megjashi, me përqindje ka dy deri tre raste në javë të keqtrajtimit seksual ose pedofilisë ndaj fëmijëve në Maqedoni. Numri është alarmues dhe brengosës. Në veçanti brengos fakti që këtë vit u zbuluan edhe raste të inçestit kur fëmijët janë viktimë nga më të afërmit e tyre ose edhe nga prindërit e tyre.<sup>61</sup>

Në rastin e këtyllë, kaosi tek fëmiju viktimë është edhe më i madh nëse nuk paraburgoset me kohë kryesi i veprës së tillë, nëse kthehet në familjen ku anëtarët e familjes ushtrojnë presion mbi fëmijën që ta ndryshojë deklaratën, nëse fëmiju kalon nëpër një proces të rëndë dhe të gjatë të dhënies së disahershme të deklaratës për përdhunimin, nëse nuk përkujdeset në ndonjë mjedis tjetër ku do të jetë maksimalisht i mbrojtur.

---

<sup>61</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=C50753C4A2CD1C4DBC442B6F535C7FFD>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=48467D809E48644995CCF0723BEF6A6B>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=26C59A329E4A534F89F5FACBDABA37C9>

Është e nevojshme që fëmiu të jetë i vendosur në qendër për pranim të fëmijëve viktime nga keqpërdorimi seksual; dhe dhunë familjare ose në ndonjë familje që bën pranimin e tyre. Këtu Qendrat për punë sociale kanë rol kryesor. Parimisht në zbulimin e hershëm të gjendjeve nëpër familjet, ndërsa e dyta përkujdesjen në kohë të fëmiut viktimë e keqtrajtimit seksual, e më pas edhe rehabilitimit të tyre, resocializimit dhe reintegrimin në shoqëri.

Gjatë vitit 2008, nga numri i përgjithshëm i thirrjeve (360) në SOS telefonin për të rinj dhe fëmijë, 39,5% kanë të bëjnë me ndonjë lloj të dhunës mbi fëmijët.<sup>62</sup>

Në vitin 2009 kemi paraqitjen e rasteve nga të rinjtë të cilët përmendin shembujt e tyre personal të keqtrajtimit nëpërmjet të internetit:

- në i-mejl adresën e tyre përmes Hi5 profilit (vjedhjen e identitetit - thyerjen e kodit dhe dhënien e informatave të cilat nuk janë të shënuara nga ana e autorit të adresës)
- përmes Hi5 profilit (është e vendosur fotografia e personit të panjohur dhe prezentohet sikurse ajo që është autore e adresës)
- shembuj gjatë edukimeve nëpër shkolla nëpër Maqedoni, ku fëmijët dhe të rinjtë tregonin përvojat e tyre në thyerjen e kodeve, ftesë me miqtë e tyre nga "on-lajn bisedimet", shfrytëzimin e fotografive në emër të tjetërkujt etj..

Në vendin tonë nuk egzistojnë hulumtime dhe të dhëna konkrete statistikore të këtij lloji, por prapëseprapë egzistojnë të dhëna për numrin e madh të paraqitjes së rasteve të këtilla.

### **Rekomandimi 3:**

- Gjykatësit të japin dënime më të rrepta dhe më të larta për kryesit e sulmit gjinor mbi fëmiun - burgim të përjetshëm;
- të vendosen masa plotësuese për mbrojtjen e fëmijëve nga pedofilët - recidivistë nga burgjet, duke i përdorur përvojat botërore;

---

<sup>62</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=C71D2EBD3C2B044BB1F4D1AD12FAC96B>



- Të krijohet një regjistër qendror për evidentimin e të gjitha rasteve të paraqitura dhe kryerësve të sulmit gjinor mbi fëmijun;
- Qendrat për punë sociale të jenë mobile dhe efektive në zbulimin e familjeve nën rrezik dhe ndjekjen e tyre të vazhdueshme si dhe marrjen e masave përkatëse me çka do të kishin vepruar në mënyrë preventive. Ata mund të japin kontributin më të madh në parandalimin nga keqpërdorimi i fëmijëve;
- Të zhvillohet system i zbulimit të hershëm të keqtrajtimeve dhe të përforcohen shërbimet për ofrimin e ndihmës direkte të fëmijëve që janë viktimë nga dhuna.
- Të hapen qendra speciale për pranimin e fëmijëve të keqtrajtimin seksual dhe pedofilisë, përkujdesje të veçantë, rehabilitim në 72 orët e para.
- Punimi i QPS me fëmijët viktimë dhe pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë 24 orëve.
- Formimin e familjeve përkujdesëse për fëmijët viktimë të keqtrajtimin seksual, pedofilisë dhe inçestit në të gjithë qytetet në republikën e Maqedonisë.

#### **4. MASA TË PËRGJITHSHME TË IMPLEMENTIMIT**

Në Republikën e Maqedonisë edhe përkundër zbulimit të shpeshtë dhe arrestimit të pedofilëve nga ana e policisë dhe ndryshimeve më të reja në Kodin Penal të cilat parashohin dënime shumë më të rrepta, gjykatësit ende u japin kryerësve të këtyre veprave penale dënime minimale. Mediumet vazhdimisht lajmërojnë për këta lloje të rasteve por kjo nuk është e mjaftueshme.

Lufta kundër pedofilisë kërkon qasje grupore dhe multidisciplinare, nëpërmjet të bashkëpunimit të organizatave qytetare dhe institucioneve shtetërore, veçanërisht Qendrave për punë sociale, gjykatave, Avokatit popullor, Policisë dhe shkollave. kjo nënkupton veprim preventiv të përbashkët dhe të sinchronizuar të të gjitha

faktorëve që kanë ndikim në edukimin dhe kujdesjen për fëmijët sikurse janë, familja, institucionet e shtetit, organizatat qytetare etj.

Qendrat ditore nuk janë zgjidhje për problemin me fëmijët e rrugës në drejtim të ç'rrënjësimit të keqpërdorimit të punës së fëmijëve. Ata ndihmojnë vetëm që fëmijët të përkujdesen për një kohë të caktuar, të lahen, të ushqehen, të vishen, të fitohen disa shprehi për higjienë, por pas lëshimit të Qendrave ditore ata prap gjenden në rrugë, puna e tyre prapë keqpërdoret edhe atë nga prindërit e tyre. Shumica prej tyre nuk kanë as qartifikatë nga Libri Amë it ë lindurve. Derisa nuk sigurohet punësim is ë paku njërit nga prindërit dhe nuk inkuadrohen fëmijët në arsim, nuk do të zgjidhet problemi me fëmijët në rrugë.<sup>63</sup>

## 5. PARANDALIMI

Në lidhje me fushën e parandalimit patjetër duhet të potencohet se është bërë shumë pak nga ana e organeve shtetërore. Nuk egziston edukim në këtë lëmi të sistemit edukues, por edhe rolin preventive të cilin sipas ligjit e ka Qendra për punë sociale në praktikë nuk punohet. Është e nevojshme që Qendrat për punë sociale të ekipohen me njerëz për zbulimin e shpejt dhe detektimin e hershëm të familjeve në rrezik ku do të mbrohet fëmiju i cili është viktimë potenciale e keqpërdorimit. Në këtë ekip duhet që të kyçet defektologu (për personat me hendikep) i cili do të kishte punuar në zbulimin, intervenimin, pranimin dhe dhënien e trajtimit rehabilitues fëmijëve me nevoja speciale. Qendrat për punë sociale nuk janë në disponim pas kohës së rregullt të punës, e as gjatë kohës së fundjavës ose ditëve kur nuk punohet (festive) dhe atëherë ndihma këtyre viktimave u është e pamundësuar.

Për momentin nuk praktikohen programet parandaluese të punës me pedofilët, e as me fëmijët. Nuk ka trajtim të sigurtë për punën me pedofilët derisa e vuajnë dënimin e tyre me burg, nuk ka mbikqyrje të sigurtë të tyre dhe ndjekjen e të njejtive pas lëshimit të burgut, nuk paraqiten në QPS dhe pedofilët pa terapi shëruese me

---

<sup>63</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=B2EDFD37544F3A42A3F9914769C6E888>

medikamente të kontrollimit të epshit dhe libidos, pa kontroll nga ana e QPS dhe Policisë mundën që ta përsërisin veprën.

**SHEMBULLI 2:**

i tillë ishte rasti me personin XX i cili e përsëriti këtë vepër për herën e tretë. Kidnapoi dy mbrojtës nga Shtëpia për fëmijë “11 Tetori” dhe njërin nga to e mbante peng për 23 ditë me rradhë. Në mënyrat më mizore shfryheshte mbi fëmion ndërsa personat përgjegjës të këtij institucioni nuk dinin se ku i kanë fëmijët e tyre. Askush nga ky institucion nuk e morri përgjegjësinë ndërsa personi XX për herë të parë në Maqedoni fitoi dënim prej 15 vitesh.<sup>64</sup>

Ligji për mbrojtje sociale, e as ligji për mbrojtjen e fëmijëve nuk i trajton fëmijët të cilët largohen nga prostitucioni, ata që janë viktima të trafikimit ose pedofilisë. Vetëm në ligjin mbi të drejtën për të mitur neni 12 trajtohen fëmijët të cilët largohen nga prostitucioni, të klasifikuar si “fëmijë nën rrezik”, për të cilat kompetent është qendra për punë sociale e cila nuk ka programe konkrete dhe gjithpërfshirëse për mbrojtjen e këtyre fëmijëve.

Në Mapimin dhe studimin e bazuar në hulumtimin mbi një bashkësi adoleshentësh, nën rrezikun më të madh të HIV/SIDA/SIS të bërë nga ana e UNICEFI-t, vërehen shërbimet shëndetësore dhe sociale të cilët duhen që të kujdesen për grupet e marginalizuara të adolescentëve për HIV dhe SIS.

Gjatë kësaj u formua informata se, më së shpeshti, QPS paraqitet për egzistimin e Adoleshentëve të cilët Japin Shërbime Seksuale (AJSHS) i merr nga ana e policisë, prokororit public, prindit ose shkollës. Më së tepërmi këta adoleshentë kanë qenë të kontaktuar sipas ndonjë arsyeje tjetër, ndërsa gjatë procedurës fitohet informatë se të njejtit edhe këmbëjnë shërbime seksuale. Në fakt, adoleshentët kontaktohen nga ana e policisë përshkak të ndonjë vepre penale ose sjelljeje asociale, me ç'rast sipas ligjit janë të obliguar që të kërkojnë QPS për bisedë primare me të miturin. Mirëpo, në praktikë kjo ndodh rrallë, përkatësisht, policia fillimisht e pyetën

<sup>64</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=F78A9B78F01B57449F3F4FE2DD41EDB2>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=9B89F42A3ADCF34F889C1E19FF9B8B31>  
<http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=B1E566BF0161DC469A0428A497A8624A>

adoleshentit, pa praninë e QPS, e tek më vonë i thërret ata vetëmse të rrespektohet procedura e paraparë ligjore. Para procedurës i dërgojnë AJSHS në kontrollim në Klinikën për sëmundje infektive dhe gjendje fibrile, ndërsa masat të cilat ndërmirren gjatë kësaj procedure janë: procedura kundër prindërve për lënien pas dore të fëmijëve të tyre, motivimi i tyre dhe terapia familjare. Masa e cila më së tepërmi u jepet nga ana e QPS dhe gjyqit, në kësi soj situatash është mbikqyrja e përforcuar nga prindërit ose nga organi për kujdestari. Nëse prindërit përsëri nuk kujdesen për fëmijët dhe nëse gjatë kontrollit përcaktohet se te adoleshenti nuk ka ndonjë përparim, i njejt vendoset në institucion. QPS nuk ka asnjëfarë ingerence ndaj gjyqit, përveç dhënien e mendimit gjatë sjelljes së vendimeve.

Është e fituar informatë se ne QPS në Strumicë nuk mbajnë regjistër të veçantë për AJSHS, por se gjatë punës së tyre takohen me raste të tilla. Më së shpeshti ndodh që fëmiu i mitur të ike nga shtëpia, me çka prindërit fillojnë kërkimin e tij dhe në atë mënyrë fillon bashkëpunimi me policinë dhe QPS. Pas gjetjes, personat kompetent nga policia së bashku me personin zyrtar nga QPS, e kthejnë të miturin në shtëpi. Më pas, kontaktin e parë e bën punëtori social, e më pas kyçen edhe personat tjerë nga grupi. Bëhet intervistë, punohet në vlerësimin e personalitetit të personit të mitur dhe familjes së tij, kërkohen mundësitë që në familje të përmirësohet gjendja etj. Përdoren teste për vlerësimin e personit, bëhet genogram për familjen, përcaktohen marrëdhëniet dhe relacionet në familje, stilet e tyre edukuese, autoritetet, dhe bëhet plan dhe programë për ndjekjen e rastit.

Edhe këtu vërtetohet konstatimi se, më së shpeshti, evidentimi nga ana e AJSHS është në procedurën e ngritur sipas bazës totalisht të ndryshme, e jo përshkak të këmbimit seksual.

## 6. NDALESA

Nëse në shpërndarjen e pornografisë fëmijërore, prezentohet ose shfaqet para fëmijëve ose të rriturve ajo dënohet sipas nenit 193 të Kodit Penal. Në Maqedoni dënohet shitja e materialit pornografik, tregimi dhe përpunimi i pornografisë për fëmijë, por ende nuk dënohet posedimi i së njejtës. Edhepse, Kodi Penal është i plotësuar me këtë rregull në nenin 193-a, me ndryshimet dhe plotësimet nga i 14.09.2009, përdorimi i tyre në praktikë do të filloje prej Marsit 2010.

Gjithashtu, Policija duhet që në veçanti të tërhejë vëmendjen në distribuimin, prezentimin dhe qasjen e lirë në pornografinë për fëmijë nëpër internet kafenetë.

Problem serioz në Maqedoni është qasja e lirë e përmbajtjeve erotike, të dhunshme dhe pornografike për sytë e fëmijëve. Fëmijët në Maqedoni çdo ditë ballafaqohen me këta përmbajtje, sepse ata i kanë afër duarsh. Gazetat e përditshme përmbajnë fotografi të shumta për “lhot-line” linjat, agjencione të cilat në mënyrë të hapur ofrojnë kontakte, seks-shitore, pornoteka etj. Revistat pornografike dhe erotike nëpër kiosqet janë publikisht të vendosura, dhe ato jovetëm që janë lehtë të dukshme nga fëmijët, por edhe nuk sanksionohet shitja e këtyre revistave të miturve.

Filmat që emitohen nëpër televizionet nuk janë gjithmonë të mbrojtura me shenjën për kufizimin e shikimit të tyre nga ana e fëmijëve, e as që ua tërheqet vërejtja prindërve se për atë periudhë të ditës do të emitohen ky lloj i filmave. Shumë shpesh edhe radio dhe TV reklamimet- e përdorin trupin femërorë për promovimin e prodhimeve. Kjo është gjendja faktike në tërë Maqedoninë.

E gjithë kjo negativisht reflektohet ndaj zhvillimit të shëndoshë të fëmiut. Pjesa më e madhe nga ajo që e mësojnë fëmijët, veçanërisht në periudhën më të hershme të zhvillimit të tyre, ndodh nëpërmjet të observimit dhe imitimit të sjelljes nga mjedisi i afërm i tyre.

#### **Rekomandimi 4:**

Të eliminohen përmbajtjet erotike, të dhunshme dhe pornografike nga rrethi më i gjerë i fëmijëve.

## **7. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE**

Brengos fakti se pothuajse çdo javë regjistrojmë 1-2 paraqitje për pedofili, keqpërdorim seksual dhe abuzim i fëmijëve nga prindërit e tyre. Në disa raste gjykata lejon ballafaqimin e fëmiut viktimë me individin, e ndonjëherë edhe me prindin i cili e ka keqpërdorur.<sup>65</sup>

Është vërejtur paraqitja e përdhunuesve nga ana e fëmijëve dhe më të afërmit. Fëmijët dhe më të afërmit e tij janë të inkurajuar që ta paraqesin përdhunuesin. Por, kur e dijmë se procedura gjyqësore zgjat në disa raste më tepër, se fëmiu është i stigmatizuar në procedurën e dëshmimit të fajta të dhunuesit, kur në seancën kryesore, me kërkim të mbrojtjes lejohet që të ballafaqohet fëmiu-viktimë me të akuzuarin, tek fëmijët shkakton trauma psikike të përhershme, mosbesim në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit për mbrojtje të fëmiut-viktimë dhe ky mosbesim rritet disa herë më shumë.

Kur fëmijët kanë vendosur që të flasin për gjithçka që u ka ndodhur dhe nën të gjitha rrethanat dhe shtypjet, patjetër duhet që ti largojmë nga mjedisi ku ka ndodhur kjo ngjarrje. Patjetër duhet që të mobilizohen institucionet educative, Ministria e punëve të brendshme, veçanërisht Qendrat për punë sociale, gjykatat, dhe të kuptojnë jo çdo herë kemi prindër të përgjegjshëm të cilët do ti kishin mbrojtur fëmijët e tyre nga keqtrajtuesit seksual dhe pedofilët.

Nuk ka vend të paraparë për përkujdesjen e fëmijëve viktimë të keqtrajtimit seksual dhe incestit. Nëse një fëmijë nën ndikimin e presionit e ndryshon deklaratën e parë të tij se ka qenë i keqtrajtuar seksualisht dhe gjatë kësaj gjykatësi lejon ballafaqimin e fëmijës-

---

<sup>65</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/default-mk.asp?ItemID=38420DAA9A3B03459CEFD207DA817E19>

viktimë me kryesin e veprës, çfarë epilogu mund që të pritete. Gjatë kësaj, fëmiu viktimë jep deklaratë në tre vende të ndryshme, në polici, në Qendrën për punë sociale dhe në gjyq, kur është prezent edhe kryesi i veprës, me çka përjeton trauma të përhershme psikike e cila e ndjek gjatë gjithë jetës së tij.

Organet kompetente patjetër duhet që të përkushtojnë vëmendje të posaçme kur bëhet intervista me fëmiun dëshmitarë ose viktimë, që ajo të bëhet në një atmosferë të relaksuar, në skrin dhoma të posaçme, të cilët nëse duhen do të zgjasin edhe më shumë orë duke u regjistruar audio-vizuelisht, të cilin gjykatësi me prezencën e psikologut, pedagogut dhepunëtorit social do ti merr parasyshë dhe nuk do të lejojë ballafaqimin e fëmiut me viktimën.

Në Qendrat për punë sociale ka dhima të pajisura për ndëgjimin e fëmijëve-viktima, por të njejtat nuk përdoren. Janë të vendosura nëpër vende joadekuate, që paraqet problem për vetë fëmijët. Për punën me fëmijë-viktima nga tregtia me njerëz, ka të trajnuar një numër shumë të vogël të punëtorëve social në qendrat për punë sociale, që paraqet problem për vetë fëmijët. Për punën me fëmijë viktima të tregtisë ka të trajnuar shumë pak punëtorë social nëpër qendrat për punë sociale, por jo edhe ekipe profesionale të cilat vazhdimisht dhe në mënyrë konstante do të punonin me fëmijët, e jo të formohen ekipe dhe të thirren sipas nevojës. Nuk ka numër të mjaftueshëm të ekipeve (ekipet vazhdimisht ndryshohen) për dëgjimin e fëmijëve viktima e të cilët do të kishin qenë në shërbim 24 orësh.

Shteti ende nuk ka siguruar vendosje adekuate të fëmijëve viktima të trafikimit me njerëz, fëmijët viktima (mbi 12 vjet) drejtohen në qendrën për pranim të OJQ-së Porta e Hapur e cila ka një dhomë të paisur për pranimin e fëmijëve, por fizikisht fëmijët nuk janë të ndara nga të moshuarit. Gjithashtu, qendra për pranim nuk është e përmbajtur financiarisht nga ana e shtetit.

Fëmijët viktima (nën moshën 12 vjeçare) dërgohen nëpër entet për fëmijë pa prind si një zgjidhje afatgjate, që nuk është në interesin

më të mirë të fëmiut, pasi që atje nuk egzistojnë shërbime të specializuara për tejkalimin e traumave të përjetuara.

Në bazë të lëndëve të cilët janë të ëvidentuara dhe në të cilat punojnë organizatat joqeveritare të cilët e hartojnë këtë raport, fitohet përshtypja se fëmijët viktime nga incesti nuk janë të mbrojtura përshkak se:

- fëmijët viktime të incestit, pas zbardhjes së rastit të tyre mbeten të lënë të vetëm, në një situatë familjare edhe më të komplikuar.
- zakonisht fëmiju mbetet me njërin prind i cili ndonjëherë nuk dëshiron që të ballafaqohet me fatin dhe ta pranon dhunën e bërë. Pas sjelljes së këtyllë shpesh fshihen edhe kushtet materiale pasi që prindi - dhunues e humb vendin e punës dhe familja mbetet pa (ndonjëherë) të ardhura elementare.
- prindi i cili ngel me fëmijun viktimë, i ballafaqohet me probleme më të ndryshme, manifeston sjellje agresive, psikikisht dhe emocionalisht e malltregon fëmijun duke dashtur që ta dënoje për atë që ka ndodhur, duke e llogaritur si shkak i situatës së re të krijuar në familje.
- te fëmiju viktimë shumfishohet problemi fillestar duke u përballur me probleme të shumta serioze (mes të cilëve edhe ndëgjimi dhe ballafaqimi në disa seanca, ballë për ballë me përdhunuesin) të cilat e bëjnë traumën edhe më të thellë, ndërsa mosbesimi në sistemin i cili duhet që ti mbroje është plotësisht i humbur.
- fëmiju është i refuzuar nga familja dhe i stigmatizuar nga mjedisi ku jeton dhe në vend që të inkurajohet për atë që nuk ka heshtur, mbetet i gjykuar për sinjeritetin e tij.
- në fund, duke mos mundur që të dalë në krye me gjithë situatën, fëmiju traumën e vendos thellë në vehte, është i brengosur për të ardhmen e tërë familjes, bile edhe për prindin dhunues: a do të shkon ai në burg ose jo?
- Fëmiju e tërë deklaratën!\*



### **SHEMBULLI 3**

Në ambasadën për fëmijë Megjashi është paraqitur se një vajzë (9 vjeçare) ka qenë e përdhunuar nga një person i panjohur dhe e rrahur nga nëna e saj. Vajza kur ka ardhur në shkollë e tëra ka qenë me shenja nga lëndimet e marra dhe mezi ka lëvizur. Personat kompetent të shkollës i kanë lajmëruar QPS nga Struga por këta të fundit janë përgjigjur se nuk kanë automjet që të shkojnë atje. Ata kanë shkuar në vend të ngjarrjes pas dy javësh nga paraqitja e këtij rasti. Nëna jeton me 5 fëmijë të mitur dhe sillet ashpër ndaj të gjitha atyre, pa asnjë përkujdesje për ta. Vajza ka rreth 15 kilogram dhe e njejta është e uritur dhe e traumatizuar. Egziston dyshimi se nëna merret me prostitucion dhe se është e mundshme që edhe fëmijët ti detyroje në të njejtën. Ambasada e Parë për fëmijë në botë e regjistroi këtë rast me **30.01.2009** në numrin falas për fëmijë dhe të rinj 0800 1 2222. E mitura S. jeton me nënën e saj, 4 vëllezërit dhe po aq motra. Kur na paraqitën rastin menjëherë reaguam deri te njësia policore në fshatin Llabunishtë si edhe në stacionin Policor në Strugë. Poashtu u drejtuan edhe deri te spitali në Strugë, por prej atje na u përgjigjën se nuk mund të japin asnjë informacion, dhe se më së miri është që për këtë rast të informohemi nëpërmjet të Qendrës për punë sociale nga Struga, por edhe prej atjenë thirrjet tona telefonike askush nuk lajmërohej, dhe mu për atë reaguam me shkrim deri te Qendra Ndërkomunale për punë sociale në Strugë që të na informojnë se a janë të njoftuar me gjendjen e këtillë, si është vajza, përdhunuesi a është arrestuar nga policia dhe kuptohet se çfarë masash janë marrë. Deri sot në ambasadën e Parë për fëmijë Megjashi nuk na është përgjigjur nga ana e Qendrës për punë sociale - Strugë se çka në të vërtetë ka ndodhur me vajzën! Përgjigjja është se vajza është lënduar me shkop, rastësisht duke u mbështetur mbi të në orën 23 para mesnatës - për ne është i papranueshëm!

Shpresojmë se duke e aktuelizuar rastin nëpërmjet të medimeve do të kontribuojmë për hetimin e këtij rasti dhe ngritjen e çështjeve të rëndësishme rreth (mos)kujdesit të institucioneve përkatëse të sistemit, por për fat të keq në vend të përmbajtjes ambasada për Fëmijë Megjashi fitoi lajmërim për mbikqyrje të jashtëzakonshme inspektuese nga ana e Dreksionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Edhe pse nëpër medimet nuk u shpallën të dhëna personale, sipas Direksionit për mbrojtjen e të dhënave personale ambasada për Fëmijë Megjashi e ka thyer Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale! Ambasada e fëmijëve reagoi deri te Direksioni me shkresë se me veprimet e këtilla të institucioneve shtetërore jovetëm që pengohet mbrojtja e fëmijëve por thyhet edhe njëri nga principet themelore - interesi më i mirë i fëmijut. Ky rast edhe më tej mbetet i mbuluar me misterjen sipas të cilës edhe

përkundër cenimeve të dukshme të të drejtave të fëmijut me pasoja të rënda psikofizike për fëmijun, askush nuk është sanksionuar!

#### **SHEMBULLI 4:**

rast kur fëmiju e tërhjek deklaratën e tij: mësuesja në një shkollë fillore në Kërçovë (e cila u drejtua deri te ambasada për Fëmijë Megjashi në vitin 2009) prej kur e ka thirrur vajzën në bisedë, e njejta ka pranuar se babi i saj e detyron atë në seks oral. bëhet fjalë për babin i cili ka kryer aktivitete të sulmit gjinor mbi vajzën e tij (e ka vdeshur, e ka prekur nëpër gjinjtë dhe nëpër organet gjenitale dhe nga ajo ka kërkuar që ta përkëdhel organin e tij gjenital dhe pastaj kanë pasur seks oral). Babain e burgosin në polici, por QPS duke mos pasur ndonjë familje e cila do të kujdesej për të e kthejnë në familjen e saj. Nëna dhe xhaxhai i vajzës kryejnë presion mbi vajzën që ta ndryshojë deklaratën e saj. Ajo e ndryshon. Por mësuesja mbetet në deklaratën e saj dhe e njejta paraqitet në rolin e saj para gjyqit. gjykata e pranon rolin e mësueses që të dëshmojë. Por gjykatësi lejon në seancën kryesore që fëmiju të ballafaqohet me babain e saj. Gjyqi e merr parasysht deklaratën e mësueses dhe sjell vendim duke e dënuar kryesin e veprës penale me 2 vite dhe gjashtë muaj burg. Përshkak të presionit nga të afërmit dhe familja, fëmiju e ndryshon deklaratën e saj, duke thënë se deklarata e mëparshme ka qenë e rrejshme dhe të njejtën e ka dhënë duke u friguar nga babi i saj, pasi që ka qenë nxënëse e dobët dhe në atë mënyrë ka dashtur që ta lëndojë pa mos qenë e vetëdijshme se i njejtë do të shkojë në burg. Përshkak të dy deklaratave kundërtëse, në QPS kanë biseduar dhe kanë qenë të mendimit se duhet që të bëhet testim neuropsikijatrik duke përcaktuar se cila nga të dy deklaratat e të dëmtuarës është e saktë.<sup>66</sup>

Edhe pse është e zhvilluar një program i MPPS për riintegrim të fëmijëve viktimë të tregtisë me njerëz që përfshin aktivitete të ndryshme, ajo që brengos është fakti se ende nuk është e finansuar sa duhet nga ana e Ministrisë. Kjo do të thotë se nuk mundet që në praktikë të implementohet. Duke i pas parasysht pasojat e veçanta fizike, psikike dhe sociale të cilat i përjetojnë fëmijët-viktimë të tregtisë me njerëz si rezultat i keqpërdorimit të tyre dhe eksploatimit nevoitet marrja e hapave përkatëse dhe veprimeve për mbrojtjen e

---

<sup>66</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/?ItemID=4F625AB31AA05742B30E70CB70741119>  
<http://www.osgostivar.mk/Odluki.aspx?odluka=6>

fëmijëve në pajtim me moshën e tyre dhe me interesin më të mirë të tyre.

Gazetarët duhet që ta rrespektojnë të drejtën e privatësisë së fëmiut, në vecanti të drejtën e fëmijëve viktimë nga trafikimi me njerëz. Praktikë gazetareske janë edhe raportimet për viktimë të mitura nga trafikimi me njerëz në terminet kyçe të mbrëmjes, dhe gjatë kësaj publikisht janë shfaqur inicialet dhe vendi i jetesës, si dhe vendi i drejtimit të tij/saj.

### **Rekomandimi 5:**

- Në rastin kur fëmiu viktimë nuk shoqërohet nga prindi/kujdestari, në mënyrë urgjente duhet që të përcaktohet kujdestar dhe në një afat më të shkurtër të mundshëm të lidhet me familjen e tij, nëse ajo është në interesin më të mirë të tij;
- Në rast kur nuk është e përshtatshme dhe e sigurtë për kthimin e tij në familje, të ndërmerren masa speciale të mbrojtjes së interesit dhe të drejtave të fëmiut në pajtim me rregullat ligjore;
- Të rrespektohet mendimi i fëmiut (nëse është në gjendje që ta shprehë atë) për masat e ndërmarra të mbrojtjes dhe ndihmës;
- marrjen e masave për mbrojtjen e privatësisë dhe identitetit të fëmiut-viktimë;
- sjelljen e programeve speciale individuale për mbrojtjen dhe përkrahjen e fëmijëve viktimë nga tregtia me njerëz, në lidhje me ndihmën e tyre fizike, psikologjike, edukativ, shëndetësore dhe ndihmë për tu vendosur diku;
- Qendrat për punë sociale duhet që të përcaktojnë person për shoqërimin e fëmiut i cili do të jetë i angazhuar në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.
- të rrespektohet identiteti dhe integriteti i fëmijëve viktimë ose dëshmitarëve të çfarëdo lloji të dhunës dhe të mbrohen nga viktimizimi plotësues nëpërmjet të shpalljes së të dhënave të karakterit personal nëpërmjet medimeve: emri, emri i prindërve, adresa, vendbanimi, informata personale në lidhje me rastin, një ose disa karakteristika specifike për pamjen e tyre fizike, mentale, ekonomike, kulturore ose sociale, përkatësinë etnike etj.

## REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME:

- *Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual*
- *Gjykatësit dhe personat përgjegjës të cilët hyjnë në kontakt me fëmijën viktimë nga dhuna të jenë maksimalisht të kujdesshëm ndaj fëmijut. deklarata të cilën e jep fëmijë të jetë e paraparë me ligj dhe të jepet vetëm një herë dhe në një atmosferë të relaksuar në prezencë të gjykatësit, psikologut, pedagogut dhe përfaqësuesit nga qendra për punë sociale*
- *Shteti duhet të ndërmerr kampanja të vazhdueshme për ngritjen e vetëdijes, programe për trajnim dhe edukim për rregullat e OPSC-së, të dedikuara për fëmijët viktimë të tregtisë me njerëz, kuadrot pedagogjik, personat medicinal, gazetarët, juristët, punëtorët social, gjykatësit, avokatët.*
- *Të formohen qendra për pranimin dhe përkujdesjen e fëmijëve-viktima të dhunës familjare dhe keqtrajtimit seksual, me mbështetje financiare nga ana e shtetit*
- *Mbështetje të qendrave egzistuese të OJQVE për viktimat nga tregtia me fëmijë.*
- *Qendrat për punë sociale të ekipohen me një kuadër për zbulimin e shpejtë të dhe të hershëm të familjeve në rrezik ku do të mbrohet fëmijë i cili është viktimë momentale e keqtrajtimit. Në këtë ekip duhet që të kyçet edhe defektologu (për personat me hendikep) i cili do të kishte punuar në zbulimin, intervenimin, pranimin dhe rehabilitimin e këtyre fëmijëve*
- *Qendrat për punë sociale të jenë të hapura 24 orë dhe në kontakte të drejtpërdrejta me qendrat për pranimin e fëmijëve viktimë të të gjitha llojeve të dhunës*
- *Puna me fëmijë viktimë dhe rehabilitimi i tyre, resocializimi dhe riintegrimi në shoqëri*
- *Bazë e të dhënave dhe statistikë për fëmijët viktimë të çfarëdo lloji të keqtrajtimit seksual*

- *Aplikimin e programeve parandaluese për punë me pedofilët dhe rehabilitimin e tyre, shërimin dhe resocializimin e cila njëkohësisht do të inkuadrojë edhe marrjen e masave përkatëse të cilat do të parandalojnë përsëritjen e veprave*
- *Mbikqyrje të rreptë nga ana e policisë dhe QPS ndaj pedofilëve*
- *Dënime më rigorozë për pedofilët*
- *Aplikimin e programeve parandaluese nëpër shkollat, familjet dhe nëpërmjet të mediumeve të cilët do të ndikojnë në mbrojtjen e fëmijëve nga shitja, prostitucioni dhe pornografia;*
- *Të shtohen masa plotësuese për mbrojtjen e fëmijëve nga pedofilët - recidivist nag burgjet, duke i shfrytëzuar përvojat botërore (mbikqyrje nga ana e policisë dhe Qendrave për punë sociale të pedofilëve dhe recidivistëve)*
- *Të rrespektohet identiteti dhe integriteti i fëmijëve viktime ose dëshmitarë të çfarëdo lloji të dhunës dhe të mbrohen nga viktimizimi plotësues përmes shpalljes së të dhënave të karakterit personal nëpër mediume: emir, emir i prindërve, adresa, vendbanimi, informata personale në lidhje me rastin, një ose disa karakteristika specifike për identitetin e tij fizik, mental, ekonomik, kulturorë ose social, përkatësinë nacionale etj.*
- *formimin e qendrave shtetërore për pranim dhe përkujdesje të fëmijëve viktime të keqtrajtimit seksual, së paku nëpër qytetet më të mëdha, nën ingerencat e Ministrisë për punë dhe politikë sociale të Maqedonisë, për pranimin e viktimeve të dhunës familjare dhe keqtrajtimit seksual.*
- *trajnim të personelit nëpër institucionet publike (shkollat, entet shëndetësore, qendrat për punë sociale etj.) për këtë protocol Fakultativ.*

***Koalicioni nacional për të drejtat e fëmijut  
Republika e Maqedonisë***

*i koordinuar nga Ambasada e Parë e fëmijëve në botë MEGJASHI*

*1000 Shkup, Kosta Novakoviç 22 a, Maqedoni*

*Tel. +389 2 2465 316; i-mejli/faks: +389 2 2463 900*

[info@childrensembassy.org.mk](mailto:info@childrensembassy.org.mk)

[www.childrensembassy.org.mk](http://www.childrensembassy.org.mk)

## **RAPORT ALTERNATIV**

**të organizatave joqeveritare ndaj raportit Inicues  
shtetëror të Republikës së Maqedonisë pas protokolit  
Fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijut për  
involvim të fëmijëve në konflikte të armatosura (nga  
Nëntori i vitit 2008)**

**Shkup, 2009**

## TABELA E SHKURTESAVE

<b>QSHDNJ</b>	Qendra Shqiptare për të drejtat e njeriut - Tiranë
<b>ARM</b>	Armata e Republikës së Maqedonisë
<b>PÇB</b>	Persona të çvendosur në brendi
<b>Konventa 182</b>	Konventa kundër formave më të këqija të punës fëmijërore
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>MPPS</b>	Ministria për punë dhe politikë sociale
<b>NATO</b>	Aleanca Veriatlantike
<b>OPAC</b>	Protokoli Fakultativ për inkuadrimin e fëmijëve në veprime të armatosura dhe konflikte
<b>APFBM</b>	Ambasada e Parë e fëmijëve në botë Megjashi
<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë
<b>UNHCR</b>	Zyra e komesariatit të lartë për refugjatë të kombeve të Bashkuara
<b>QIQ</b>	Organizata Joqeveritare Qendra për iniciativa qytetare
<b>QPS</b>	Qendra për punë sociale

## **1. HYRJJE**

Raporti Alternativ i OJQ-ve lidhur me raportin Inicues shtetëror të republikës së Maqedonisë sipas protokolit Fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijut për involvimin e fëmijëve në konflikte të armatosura (nga Nëntori i vitit 2008) është i pregaditur nga ana e *Koalicionit Nacional për të drejtat e fëmijut - Republika e Maqedonisë (Koalicion joformal i formuar në vitin 1997.)* si aktivitet nga të proektit të Ambasadës së Parë për fëmijë në botë MEGJASHI. Për nevojat që të pregaditet raporti në vitin 2009 u ripërtëri dhe u zgjerua ky KNDF me orgqanizata të reja anëtare dhe dy koalicione ( të gjitha janë anëtare të reja përveç Këshillit për preventivë nga delikuenca për të mitur nga Kavadari dhe ambasada e parë e fëmijëve në bitë Megjashi).

Në përpilimin e raportit Alternativ morrën pjesë (21) organizata qytetare dhe (2) koalicione të organizatave qytetare:

- 1. Asociacioni për Inicijativa Demokratike (ADI) - Gostivar**
- 2. Asociacioni për edukatë shëndetësore dhe kërkim - HERA- Shkup**
- 3. Inicijativa qytetare e grave Antiko - Kërçovë**
- 4. Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë - Shkup (koalicion i 17 OJQve)**
- 5. Lajfstart - Manastir**
- 6. Maqedonia pa diskriminim (bashkësi e 11 OJQve)**
- 7. Forumi rinor edukativ - Shkup**
- 8. Dera e Hapur - La Strasa - Shkup**
- 9. Hapeni dritaret - Skopje**
- 10. Post polio grupi për mbështetjen e Polio Plus - Shkup**
- 11. Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi - Shkup**
- 12. Phurt - Delçevë**
- 13. Këshilli për preventivë nga delikuenca për të mitur - Kavadar**



- 14. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë - Shkup.**
- 15. HOPS Opcione për jetë të shëndoshë - Shkup**
- 16. Shoqata Humanitare Nëna - Kumanovë**
- 17. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Dibër.**
- 18. Organizata humanitare dhe bamirëse e romëve në Maqedoni Mesechina - Gostivar.**
- 19. Qendra për bashkëpunim Ballkanik “ Loja” - Tetovë**
- 20. Qendra për iniciativë qytetare - Prilep**
- 21. Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve - Shkup**
- 22. Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë**
- 23. Shellter qendra - Shkup**

Në pregaditjen e raportit Inicues shtetëror të Republikës së Maqedonisë sipas protokolit fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijut për involvim të fëmijëve në konflikte të armatosura nuk janë konsultuar organizatat qytetare.

Duke vështruar raportin i cili u soll nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë patjetër duam të theksojmë se i njëjti është tepër i përgjithshëm, apstrakt dhe nuk e jep pamjen e tërësishme të gjendjeve në lidhje me vitet për të cilat raporton i njëjti. Gjithashtu nuk egzistojnë të dhëna oficiale statistikore për cilëndo qoftë temë për të cilën raportohet me këtë raport dhe aspak nuk ka të shënuara informata për masat konkrete për implementim. Brengosëse është ajo që në raport nuk janë të përmendur fëmijët rëfugjatë nga konflikti ushtarak (Kosovë), nuk janë të përmendur as fëmijët nga konflikti i armatosur në vitin 2001, nuk janë përmendur shërbimet kujdestare të cilat do ti aplikojnë masat për mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim, nuk është përmendur se ende nuk është përpiluar protokoli për trajtimin e fëmijëve viktime nga dhuna, nuk janë përmendur masat konkrete (rehabilitim, riintegrim) gjatë ekstradimitit. Gjithashtu, në Raportin aspak nuk përmendet implementimi i

konventës 182 të ONP-së për parandalimin e menjëhershëm të formave më të vështira të punës fëmijërore dhe rekomandimin e ONP.

Konflikti i armatosur i cili e përfshiu Republikën e Maqedonisë në vitin 2001, krijoi një pabarazi edhe më të madhe në shoqëri dhe e prishi ndjenjën e besimit dhe jetesës së qetë. Kjo situatë e tillë ka ndikim të madh edhe ndaj sjelljes dhe komunikimit ndërmjet të rinjve nga të dy grupet etnike më të mëdha: grupin etnik të maqedonasve dhe shqiptarëve.

Shteti nuk i ka hetuar deri në fund indicjet për pjesëmarrjen e fëmijëve në konfliktin e armatosur në vitin 2001. Në atë mënyrë nuk është nxjerrë problemi në dukje dhe nuk u është ofruar ndihmë fëmijëve të cilëve u është nevojitur ndihma e veçantë për risocializim dhe mbështetje.

Zgjidhja e statusit të fëmijëve të cilat i vuajnë pasojat nga konflikti gjatë tetë viteve të fundit, vazhdimisht bartet prej Qeverisë në Ministrinë për punë dhe politikë sociale dhe anasjelltas.<sup>67</sup>

Edhe pse në raportin shtetëror është potencuar se me Ligjin për evidencat në shëndetësi do të parashihet edhe evidence për fëmijë në konflikte të armatosura prapëseprapë një statistikë e tillë mungon në ligj.

Në lidhje me fëmijët azilantë dhe migrues, përveç të dhënave të fituara nga ana e UNHCR-së nuk kemi ndonjë statistikë tjetër nga e cila do të mund të përcaktohet se sa nga to janë fëmijë. Fëmijët azilantë dhe migrantë janë të vendosur së bashku me të rriturit dhe nuk egziston qendër rehabilituese në të cilin do të mund të fitojnë ndihmën e duhur.

---

<sup>67</sup> Komiteti i Helsinkit

## 2. PARANDALIMI

Jurisprudenca vendore shprehimisht ndalon kyçjen e të miturve në ndeshje të armatosura dhe rekrutimin e tyre në njësi të cilat kryejnë veprime luftarake apo veprime tjera të armatosura. Kufiri kryesor për rekrutim dhe kyçje është mosha 18 vjeçare kur personi konsiderohet si i rritur.

Sipas KP, si krim lufte kundër popullatës civile sanksionohet individi i cili gjatë kohës së luftës, ndeshjes së armatosur ose okupimit duke i cenuar rregullat e së drejtës ndërkombëtare do të urdhërojë që të bëhet evidentimi dhe rekrutimi i të miturve më të rinj se 15 vjet në forcat e armatosura ose shfrytëzimin e tyre përmes pjesëmarrjes aktive në veprimet e armatosura. Ndjekja për këto veprime inkriminuese nuk vjetrohët ndërsa është e paraparë dënimi me burg të rreptësishëm prej së paku nëntë viteve ose burg të përjetshëm. Ambasada e Parë e fëmijëve në botë Megjashi zotohet që personat nën moshën 18 vjeçare të mos mund të rekrutohen, mobilizohen dhe të përdoren në veprime të armatosura, as edhe në rrethana të jashtëzakonshme luftarake.

Në sistemin edukativo-arsimor të republikës së Maqedonisë nuk përkushtohet vëmendje e mjaftueshme të disa temave shumë të rëndësishme të lidhura me të drejtat e fëmijëve veçanërisht me kyçjen e tyre në konfliktet e armatosura. Përshkak të kësaj paraqitet nevoja nga lloje të ndryshme të inicijativave dhe aktiviteteve për parandalim të cilat do të jenë nën frymën e mirëkuptimit ndëretnik, rrespektimin e ndryshimeve dhe bashkëpunimin.

Në këtë fushë mungon plani Aksional për masa parandaluese (edukative) dhe edukim në tema të ndryshme për të gjitha moshat, siç janë: komunikimi i padhunshëm, menaxhimi konstruktiv me konfliktet, stereotipet dhe paragjykimet.<sup>68</sup>

---

<sup>68</sup> <http://www.megjashi.org.mk/WBStorage/Files/Brosura%20EIDHR%202005.pdf>

Kuadri pedagogjik në numrin më të madh të rasteve nuk ndërmorri përgjegjësi personale për gjendjen e tillë dhe në atë mënyrë me pasivitetin e tyre poashtu i përmban dhe e toleron dhunën ndërmjet grupeve të ndryshme që u përkasin etniteteve të ndryshme. gjatë kësaj, nevojat themelore njerëzore për paqe, siguri dhe rrespektimin e identiteteve mbesin të pakënaqshme. Ende egzistojnë incidente ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme, si rrahje në transportin publik, fyerje etj.

Gjithashtu, kuadri pedagogjik në shkollat i cili është i interesuar për mbështetjen në komunikimin e padhunshëm ndërmjet fëmijëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre nuk është i trajnuar dhe i organizuar. Një tentim modest për krijimin e rrjeteve paraqet projekti “Shoqërim përmes bashkëpunimit multietnik në 5 klube multietnike në shkollat e mesme në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë”.<sup>69</sup>

Maqedonia e ratifikoi Konventën 182 të ONP (Konventa për ndalim dhe eliminim të llojeve më të vështira të punës fëmijërore) sipas rekomandimit të Komitetit për të drejtat e fëmijëve, por ende nuk ka sjellë Programë për aksion që parashihet me nenin 6 të Konventës. Programet për aksion duhet që urgjentisht të dizajnohen dhe të aplikohen në këshillim me institucionet relevante qeveritare dhe organizata të punëdhënësve dhe punëtorëve, duke i pasur parasysh intereset e fëmijëve të cilët direkt janë të kyçur në llojet më të vështira të punës fëmijërore, familjet e tyre dhe grupet tjera përkatëse të cilat janë të dedikuara ndaj qëllimeve të Konventës dhe të këtij Rekomandimi. Programet e tilla duhet të jenë të drejtuar, inter-alien, ndaj:

- a) Identifikimit dhe refuzimit të llojeve më të vështira të punës fëmijërore.
- b) Veprim preventive gjatë kyçjes së fëmijëve në format më të vështira të punës fëmijërore ose duke i larguar format më të vështira të punës fëmijërore, duke i mbrojtur nga hakmarrjet dhe duke u mundësuar rehabilitimin e tyre dhe integrimin

---

<sup>69</sup> <http://www.megjashi.org.mk/WBStorage/Files/Informator%20br%202023.pdf>

shoqëror nëpërmjet të masave të cilat janë në pajtim me nevojat e tyre edukative, fizike dhe psikologjike

b) Vëmendje të posaçme duhet tu përkushtohet:

- fëmijëve më të rinj
- vajzave
- problemit të situatave punuese të fshehta, në të cilat vajzat janë në rrezik të posaçëm
- grupeve tjera të fëmijëve të cilat në veçanti janë të pambrojtura ose me nevoja të posaçme

r) identifikimi, ndihma dhe bashkëpunimi i ndërsjellë me bashkësitë ku fëmijët janë nën rrezik të veçantë

д) informimin, senzibilizimin dhe mobilizimin e mendimit public dhe të grupeve të interesuara, duke i konsideruar këtu edhe fëmijët dhe familjet e tyre.

Problem serioz në shtet paraqet shfrytëzimi i video-lojrave me përmbajtje të dhunës. Nuk egziston ndalesa për asnjë video lojë edhe pse hulumtimet në botë kanë treguar se negativisht ndikojnë ndaj psikikës së të rinjve, përkatësisht se nuk rrespektohen udhëzimet për kufizimet për atë se cilat shfrytëzues, deri në cilën moshë mundën që ti shfrytëzojnë video lojrat e caktuara. (Eölfenstein 3D, Asheron's Call 2, Doom,...)

### **3. MBROJTJA, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI**

Duke pasur parasush atë se në raportin Nacional aspak nuk përmenden refugjatët nga Kosova nga viti 1999 dhe personat e zhvendosur në brendi nga viti 2001, ky raport Alternativ përmban informata më të hollësishme mu për këto dy grupe, përkatësisht për fëmijët të cilët ishin të gjetur në atë situatë.

#### ***3.1. Refugjatët nga Kosova***

Me fillimin e ngjarrjeve në Kosovë në vitin 1999 dhe dukurinë e një vale të madhe të refugjatëve nga Kosova në Maqedoni,

Qendra për inicijativa qytetare - Prilep (QIQ) filloi të punojë në një projekt të fokusuar mu në këtë problematikë.

Refugjatët nga Kosova ishin të vendosura në kampe për refugjatë dhe në familje në disa qytete në Maqedoni të shpërndara përrreth kufirit me Kosovën dhe Shqipërinë. Tragjedia që u ndodhte prodhonte një sërë efektesh negative sin ë planin individual ashtu edhe në atë kolektiv, duke i rrezikuar vlerat e tyre sociale dhe civilizuese me tendencë të asocializimit të vazhdueshëm dhe ndarje nga koha në të cilën të tjerët jetojnë. Më të rrezikuar ishin fëmijët të cilët më së rëndi i duronin pasojat pasiqë jeta e tyre e deri atëhershme pa brenga, më së paku i kishte pregaditur për egzistimin e tyre jashta ambientit shtëpiak e veç kësaj si shtesë - edhe me një sasi të traumave dhe stresit.

Numri më i madh i refugjatëve i cili ishte i shënuar në vendet urbane, ishte në Tetovë ku ishin të vendosur rreth 20.000 persona refugjatë.

Në Republikën e Maqedonisë ende janë të përkujdesur 2136 persona nga Kosova kërkues të azilit, më herët si persona të përkujdesur humanitar dhe individë të ardhshëm me status të refugjatëve.<sup>70</sup>

### ***3.2 Persona të zhvendosur në brendi (PZHB)***

Raporti i paineresimit dhe indolent i shtetit egziston edhe ndaj personave të zhvendosura nga konflikti, duke i inkuadruar këtu edhe fëmijët që sjell deri te egzistimi i qendrave për persona të zhvendosur në të cilat fëmijët jetojnë në kushte të sigurta, pa mbrojtje shëndetësore dhe mbrojtje sociale dhe pengesa në realizimin e procesit edukativ.

---

<sup>70</sup> <http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Informator%20br%2021.pdf>

Ministria për punë dhe politikë sociale në mënyrë direkte është përgjegjëse për cenimin e të drejtave të fëmijëve - personave të zhvendosur në brendi. Sipas të dhënave të Komitetit të Helsinkit pas pesë viteve nga konflikti i armatosur në teritorin e republikës së Maqedonisë (2001) në qendrat kolektive për përkujdesje në Mars të vitit 2006 gjindeshin 160 fëmijë: 50 në moshë prej deri më 6 vite, 70 në moshë prej 6 deri 14 vitesh, dhe 40 me moshë mbi 15 vjeçare. Nga gjithsej 1130 persona të zhvendosur në brendi në RN, mbi 60% janë nëna dhe fëmijë. Ata janë të vendosur nëpër qendra kolektive, në kushte joadekuate për kënaqjen e nevojave themelore egzistenciale.

Prej fillimit të krizës në Republikën e Maqedonisë e deri te numri i madh i fëmijëve të zhvendosur në brendi ishin të vendosur në qendrat kolektive në të cilat:

\* vendosja në shumicën e rasteve është joadekuate me numrin e anëtarëve të familjeve ndaras - fëmijët jetonin (ndërsa disa nga to ende jetojnë) nëpër dhoma prej 6-12 metra katrorë, dukshëm të dëmtuara, me lagështi dhe jo mjaft të ndriçuara. Në një dhomë jetojnë prej 4 deri më 6 persona (së bashku prindërit dhe fëmijët e tyre).

\* nuk janë mundësuar kushte të shëndosha dhe higjienike për jetë (në të gjitha qendrat higjiena është në nivelin më të ulët të mundshëm, erë e pakëndshme ndjehet nga të gjitha anët, përdoren banjot e përbashkëta të cilat gjenden në një situatë katastrofale).

\* nuk janë siguruar kushte minimale për zhvillimin adekuat të fëmijëve (ushqimi ishte i njëjlojshëm pa asnjëfarë standardesh sipas të cilave do të ketë një kualitet dhe kuantitet i përcaktuar që më parë për fëmijët, ndërsa në disa drejtime u ishte ndarë ushqim me afat të skaduar). Qumështi dhe prodhimet qumshtore vazhdimisht zvoglohen, ndërsa për fëmijët jashtmartesorë aspak nuk ndahet ushqim dhe të njejtat nuk janë të inkuadruar në evidentimin e PZHB.

\* nuk dihet numri i saktë i fëmijëve të lindur dhe të njejtat nuk fitojnë mbrojtje të posaçme dhe kushte më të mira për jetesë.

\* familjet të cilat me shkresa nga Ministria degradohen (nga shkaqe më të ndryshme, shumë shpesh të pasqaruara dhe joadekuate) detyrohen që ti lëshojnë qendrat me atë që nuk u dërgohet ushqim. Me secilin degradim ish-in të përfshira edhe një numër i caktuar i fëmijëve të cilët mbetën edhe pa mbrojtjen minimale të cilën ua ofron qendra kolektive.

\* me degradimin fëmijët detyrohen që të kthehen në një mjedis jo të sigurtë për ta (sipas prindërve: në shkollat ku duhet që të mësojnë nxënësin nënshtrihen ndaj kanosjeve të shumta, bile edhe në rrahje, nuk kanë kushte që të ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, nuk ndjehen të sigurtë që lirshëm të shetisin në vendin ku jetojnë, ndërsa në të njejtën kohë nuk janë siguruar as kushtet materiale minimale për egzistencë dhe mbijetesë).

Qasje ndaj shërbimeve themelore shëndetësore të cilat inkuadrojnë vaksinimin e fëmijëve dhe shërbimeve sanitare - asnjëherë nuk ka pasur, sikurse nuk ka pasur as përkohësisht (e lere më gjithmonë) prezencë të mjekut ose personelit tjetër medicinal. Në asnjë moment nuk janë bërë kontrollime mjeksore.

MPPS, të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe medicinale, e siguron me atë që ua jep karton vjetor i cili në disa ente publike shëndetësore nuk u njihet. për shkak të këtij shkak, jo rrallë, PZHB i paguajnë shërbimet shëndetësore, ndërsa shumë nga medikamentet i blejnë nga mjetet personale.

Zgjidhja përsëri kërkohet në mbylljen e rasteve me çdo kusht dhe hudhjen e përgjegjesisë pa mos mbajtur llogari për gjendjen me fëmijët.

Për ngjarjet me PZHB ish-in të lajmëruara të gjitha organet shtetërore, Kryqi i Kuq, Avokati i popullit, por problemi i tyre ende nuk është i zgjedhur. Edhe pse numri oficial tregon zvogëlimin e PZHB, përsëri potencojmë se ajo është ashtu



përshkak të detyrimit të disa personave që të deregjistrohen si PZHB.<sup>71</sup>

**SHEMBULL 1:**

Me 02.09.2005, në ambasadën e Oarë për fëmijë në botë Megjashi, arriti informimi nga ana e MPPS se në bazë të Konkluzionit të Qeverisë së RM-së nga Seanca e 18-të e mbajtur me 17.02.2003, 16 personave të zhvendosur në brendi të vendosur në qendrën për pranim të Megjashi-t “të cilëve u janë realizuar kushtet për kthimin e tyre nëpër shtëpitë e tyre” u ndërpret statusin e personave të zhvendosur në brendi dhe të gjitha beneficionet që i gëzojnë me këtë status. Ata edhe përkundër asaj se shtëpitë e tyre janë rikonstruuar, sipas tyre ata nuk ndjeheshin të sigurtë që të kthehen në fsh. Araçinë, ndërsa nuk mundeshin që ta lëshojnë qendrën pasiqë vendbanimet e tyre të reja në vendet tjera përreth Shkupit u ishin në ndërtim.<sup>72</sup>

### **3.3 Masa për mbrojtje**

Konkretisht nuk janë të përcaktuara shërbimet të cilat do ti realizojnë masat për mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim. A do të jenë ato Qendrat për punë sociale ose organe të tjera nuk është ende e rregulluar juridikisht.

**SHEMBULL 2:**

Në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve do kishim dashur që ta përmendim si një shembull negative fotografimin e fëmiut i cili mban armë zjarri në kremtimin më rastin e festimit të Ditës së Armatës së Republikës së Maqedonisë (ARM) në Gusht të vitit 2009. Pyetja e cila u parashtrua nga të gjithë ne është se a thua vallë shteti punon për interesin më të mirë të fëmiut dhe çka saktë ajo propagon me lejimin që fëmijët të fotografohen me armë të Armatës dhe të njejtën publikisht ta shpallin dhe shpërndajnë.

Poashtu ambasada e Parë për fëmijë në botë “Megjashi” reagoi përshkak të keqpërdorimit të fëmijëve për qëllime politike, gjatë kremtimit të Ditës së ARM-së. Fëmijët ishin të kyçur në agitacionin

<sup>71</sup> <http://www.mhc.org.mk/default-mk.asp?ItemID=1D74AC764A803F438666D8BF954F8C8A&arc=1>

<sup>72</sup> <http://www.megjashi.org.mk/WBStorage/Files/Informator%20br%2022.pdf>

dhe kampanjën politike për hyrjen e Maqedonisë në NATO në 40°C<sup>73</sup>

#### **4. DISEMINIMI I PROTOKOLIT DHE TRAJNIME**

Shteti ende nuk e ka përkthyer Protokolin në të gjitha gjuhët të cilat përdoren në Republikën e Maqedonisë dhe i njëjti nuk e ka shpërndarë më gjerësisht në publik. Është e nevojshme që me Protokolin të jenë të njoftuar fëmijët, prindërit, shkollat, komunat dhe të gjitha organet shtetërore të cilat direkt ose indirekt punojnë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në praktikë mungojnë trajnime nga të gjitha subjektet e lartpërmendura me qëllim të njohjes më të mirë me të drejtat dhe obligimet e parapara në Protokolin fakultativ.

---

<sup>73</sup> <http://www.megjashi.org.mk/?ItemID=1D35137F296E5448BC765D5A856B644B>  
[http://mhc.org.mk/WBStorage/Files/Report\\_2007\\_07\\_08\\_MK.pdf](http://mhc.org.mk/WBStorage/Files/Report_2007_07_08_MK.pdf)

## REKOMANDIME

- KP të ndryshohet ashtu që si krim lufte kundër popullatës civile do të konsiderohet regrutimi, mobilizimi dhe shfrytëzimi i personave nën moshën 18 vjeçare, në vend të asaj 15 vjeçare - ashtu si është tani.
- KP të ndryshohet ashtu që si krim lufte kundër popullatës civile do të llogaritet regrutimi i fëmijëve jo vetëm në veprime të armatosura por edhe në kushte të jashtëzakonshme.
- Ngritja e vetëdijes në shtet për egzistimin dhe përmbajtjen e protokolit Fakultativ për të drejtat e fëmijëve i cili i referohet inkuadrimit të fëmijëve në konflikte të armatosura (OPAC), në kuptimin që shteti të ndërmerr kampanja të vazhdueshme për ngritjen e vetëdijes, arsimimit dhe trajnim programeve për rregullat e OPAC-ut, të dedikuara për fëmijët refugjatë, migantë, azilant, për kuadrot pedagogjik, personat medicinal, gazetarët, punëtorët social, juristët, gjykatësit, avokatët.
- Zgjidhjen e situatës së Personave të zhvendosur në brendi, e në suaza të kësaj edhe fëmijëve të tyre.
- Plotësimin e sistemit edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë me tema, sikurse janë: komunikimi i padhunshëm, menaxhimi konstruktiv me konfliktet, stereotipet dhe paragjykimet.
- Arsimi paqësor të bëhet pjesë e programeve edukative, si edhe mësimi i dhunës si dukuri dhe mundësitë për transformimin e së njejtës në mënyrë konstruktive dhe të padhunshme. Të trajnohen kuadrot pedagogjik për përpunimin e padhunshëm të konflikteve dhe edukimi të jetë i dedikuar për të gjitha fëmijët dhe mësuesit në të gjitha shkallët e arsimit, duke filluar nga foshnjoret.
- Rregullimi juridik i organit i cili do të implementojë masat për mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim.
- Krijimi i qendrës për rehabilitim për fëmijët azilantë dhe migrantë në të cilin do të fitonin ndihmë adekuate. Sjelljen e

programeve për aksion të drejtuara kah identifikimi dhe refuzimi i formave më të vështira të punës fëmijërore dhe veprim preventive gjatë kyçjes së fëmijëve në llojet më të vështira të punës fëmijërore.

- Të ndalohet shfrytëzimi i video lojrave për të cilat është e dëshmuar se negativisht ndikojnë ndaj psikikës së të rinjve.

# **INFORMATA PËR ORGANIZATAT - ANËTARE TË KOALICIONIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E FËMIUT**

## **1. Asociacioni për iniciativa demokratike (ADI) - Gostivar**

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) është OJQ e cila ka për qëllim që ti integrojë të drejtat e njeriut në zhvillimin politik, ekonomik dhe ekonomik në shoqëritë Juglindore Evropiane. ADI ka për qëllim që ti mbrojë dhe promovojë standardet dhe vlerat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ta ndërtojë dhe përforcojë shoqërinë civile, dhe ti përmbajë qytetarët, refugjatët, PÇB, të rinjtë, mediumet, qeverinë, sektorin privat dhe organizata të tjera nëpërmjet të përfaqësimit, participimit dhe aktiviteteve edukative.

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) është e determinuar që të bëhet njëri nga liderët kryesorë në zhvillimin e demokracisë, lirisë dhe zbatimit në Evropën Juglindore. ADI parasheh ardhmëri në të cilën secili individ ose grup do të jetë në gjendje lirshëm që të participojë në të gjitha sferat e shoqërisë, të bazuar në parimet e njohura ndërkombëtare mbi vlerat dhe të drejtat e njeriut.

Kontakt:

Bul. Braqa Ginovski 61

Hyrja e 3, Kati i 3-të

1230 Gostivar, Maqedoni

Tel: +389 42 22 11 00

Faks: +389 42 22 11 02

e-mejl: [albert@adi.org.mk](mailto:albert@adi.org.mk)

web: [www.adi-macedonia.org](http://www.adi-macedonia.org)

## **2. Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim - HERA - Shkup**

**H.E.R.A.** – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim është organizatë joprofitabile e formuar me bashkim të lirë të qytetarëve, me qëllim të realizimit të së drejtave themelore të grave, burrave dhe të rinjve që të jenë të informuar dhe të mundën lirshëm ta realizojnë zgjedhjen e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe reprodutiv, si edhe përfaqësim për

sigurimin e asaj të drejte.

Gjatë kësaj theks të veçantë vihet mbi informimin, avokimin, ofrimin e shërbimeve ose ridërgimin deri te shërbimet për përparimin e shëndetit seksual dhe riprodhues, infeksionet që barten përmes gjakut dhe nëpërmjet të akteve seksuale, shtatzania e padashur dhe shmangjen e abortit të pasigurtë. Aktivitetet janë të ndërrmarra ndaj të gjithë popullatës, me një kujdes të veçant ndaj të rinjve, të varfërve dhe atyre që nuk kanë qasje deri te shërbimet dhe nuk i realizojnë të drejtat e tyre.

Kontakt:

rr. Dame Gruev 1/3-15, 1000 Shkup, Maqedoni

Tel / Fax: + 389 2 3290 395

E-mail: [hera@hera.org.mk](mailto:hera@hera.org.mk)

web: [www.hera.org.mk](http://www.hera.org.mk) ; [ëëë.sakamdaznam.org.mk](http://ëëë.sakamdaznam.org.mk)

### 3. Iniciativa qytetare e grave Antiko – Kërçovë s

**Antiko** është iniciativa e grave, rrjet i lidereve inter-etnike dhe grave aktive nga lëvizja e Republikës së Maqedonisë. Misioni i saj është promovimi i kulturës, paqes dhe jo-dhunës nëpërmjet të angazhimit shoqërorë të femrave. IQG Antiko në mënyrë aktive punon në lëminë e kundër-diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut/të drejtat e femrave- afirmimin e rëndësisë dhe sigurisë të secilit individ në të gjitha dimenzionet e saj: siguri fizike, socio-ekonomike, rrespektimi i dinjitetit njerëzor dhe e drejta në identitet dhe knë identitet dhe kyçje. Toleranca, solidariteti, multikulturalizmi, barazia, zhvillimi i qëndrueshëm, rrjetimi, aktivizmi qytetar, e drejta sociale janë vlerat themelore në të cilat bazohet puna e saj 10 vjeçare në bashkësitë lokale në Republikën e Maqedonisë.

Kontakt:

rr: Tale Hristov Lamela 1 Lokal 9

1000 Shkup, Maqedoni

tel: + 389 (0)2 2 614 641

faks: +389(0)2 2 60 11 12

i-mejl: [contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk)

web: [www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

#### **4. Koalicioni “të Gjithë për gjykim të drejtë”– Shkup (koalicion i 17 OJQ-ve)**

**Koalicioni “Të Gjithë për gjykim të drejtë”** është rrjet i 17 shoqatave të qytetarëve dhe është e formuar në vitin 2003.

Misioni kryesor i Koalicionit është: Ndjekja dhe rrespektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë nëpërmjet të formave të ndryshme të veprimit në tentimin që të rritet niveli i implementimit të tyre, të inicohen reformat institucionale dhe juridike, si dhe të kthehet besimi i qytetarëve në gjyqet dhe institucionet e tjera të sistemit.

Kontakt:

rr. Maqedonia 11/2-10, 1000 Shkup

i-mejl: [contact@all4fairtrials.org.mk](mailto:contact@all4fairtrials.org.mk)

web: [www.all4fairtrials.org.mk](http://www.all4fairtrials.org.mk)

#### **5. Lajfstart - Manastir**

OJQ Lajfstart nga Manastiri është organizatë e formuar në vitin 1998. Nga vetë fillimi i punës është i drejtuar ndaj projekteve që mirren me edukimin e prindërve dhe fëmijëve nga mosha parashkollore dhe shkollore. Në periudhën e kaluar janë realizuar projektet vijuese: “Rritemi dhe mësojmë së bashku”, “Zhvillim i hershëm fëmijëror”, “Vavilon”, “Arsimimi i të rriturve”, “Zhvillim social i bashkësisë”. Evaluimi tregoi se projektet e përmendura në një masë të madhe ndihmojnë që fëmijët e moshës parashkollore ti fitojnë njohuritë adekuate me qëllim të jenë të pregaditur për fillimin e tyre në shkollë. Prindërit bëhen të vetëdijshëm për të gjitha ndryshimet që e ndjekin rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe janë të informuar për mënyrat se si të përballohen me ata ndryshime dhe sin ë mënyrë pozitive të ndikojnë ndaj të njejtave.

Kontakt:

rr. Vasko karangeleski p.n.

Fakulltet për mësues,

Posta: 137, Manastir

tel/faks: +389 (0) 47 253 637

i-mejl: [lifestartmk@yahoo.com](mailto:lifestartmk@yahoo.com)

## 6. Maqedonia pa diskriminim (bashkësi e 11 OJQ-ve)

Në 16 Qershor të vitit 2009 u mbajt kuvendi themelues i Bashkësisë Maqedonia pa diskriminim. Maqedonia pa diskriminim funksiononte si bashkësi joformale që nga Marsi i vitit 2008.

Vendimi për formalizimin e këtij unioni erdhi si rezultat i nevojave nga veprimi më i organizuar në fushën e promovimit të mundësive të njejta dhe mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë. Maqedonia pa diskriminim ka për qëllim që të kontribuojë ndaj një shoqërie më të drejtë, pa diskriminim, ku të gjithë njerëzit i gëzojnë mundësitë e njejt, si dhe përfitimet nga llojllojshmëria.

## 7. Forumi edukativ rinor - Shkup

Shoqata e qytetarëve **“Forumi edukativ rinor”** është organizatë joqeveritare, jopartiake dhe joprofitabile e formuar në Qershor të vitit 1999.

Misioni i shoqatës është që tu ofrojë mundësi dhe mënyra studentëve, nxënësve të shkollave të mesme, profesorëve dhe prindërve të tyre, që në mënyrë aktive dhe argumentuese të marrin pjesë në diskutimet publike për çështjet që u dedikohen atyre dhe shoqërisë më të gjerë dhe në atë mënyrë të kontribuojnë për etablimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Qëllimet kryesore të shoqatës janë:

- edukimi i të rinjve në moshë prej 15 deri në 25 vjet;
- promovimi i mënyrave alternative të edukimit të të rinjve, nëpërmjet të aplikimit të metodave interactive në ligjerata;
- promovimi i mendimit kritik dhe tolerancës ndërmjet ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme;
- fjalim publik (retorikë), punë ekipore, logjikë, prezentim i argumentuar i qëndrimeve, zgjidhjen e problemeve;
- anticipimi i qëndrimeve të kundërta si njësoj të vlefshme si ato të prezentuara personalisht;
- të hapur ndaj ideve dhe qëndrimeve të kundërta nga ato që janë të pranuar nga të gjithë;
- mbrojtja dhe promovimi i interesave studentore, intereseve dhe të drejtave;
- promovimi i koncepteve të së drejtës, sundimi i ligjit si parime demokratike themelore.



Kontakt:  
bul.Partizanski Odredi 21-2/4, Shkup  
tel: +389 2 3139 692  
i-mejl: [info@mof.org.mk](mailto:info@mof.org.mk)  
web: [www.mof.org.mk](http://www.mof.org.mk)

## **8. Porta e hapur – La strada – Shkup**

**Porta e Hapur La Strada - Maqedoni** është organizatë joqeveritare, joprofitabile e regjistruar në Shtator nën emrin e plotë **Lobi i Femrave dhe Aksion kundër Dhunës dhe tregtisë me Femra**. Porta e hapur si anëtare e La Strada (rrjetit Ndërkombëtar Evropian për parandalim nga tregtia me njerëz në Evropën Qendrore dhe Lindore) punon në parandalimin, mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës psikosociale e dedikuar për viktimat nga tregtia me njerëz.

Qëllimi kryesor i organizatës është që ta përmirësoje pozitën e femrave, ti promovojë të drejtat e tyre duke e llogaritur këtu edhe të drejtën që të migrojnë dhe të punojnë jashta vendit, si dhe që ti mbrojnë femrat nga keqpërdorimi.

Kontakt:  
Posta : 110, 1000 Скопје  
tel: +389 2 2700 107  
i-mejl: [lastrada@on.net.mk](mailto:lastrada@on.net.mk)  
web: [www.lastrada.org.mk](http://www.lastrada.org.mk)

## **9. Hapeni dritaret - Shoqatë qytetarësh për mbështetjen dhe promovimin e teknologjisë informatike për personat me hendikep-Shkup**

Hapeni dritaret është qendër që shërben për personat me hendikep, ku shfrytëzuesit kanë qasje në kompjuter dhe në Internet me ndihmën e adaptimit dhe përshtatjes së teknologjisë sipas nevojave të tyre.

Në hapeni dritaret punojmë me idenë se teknologjitë e reja duhet që ti tejkalojnë barrierat egzistuese, e jo të krijojnë bariera të reja. Ne veprojmë në krijimin e botës në të cilën personat me hendikep do të kenë mundësi - edukative dhe profesionale - për pavarësi më të madhe dhe kyçje në shoqëri.

Kontakt:  
bul. Partizanski odredi 62/1-16

1000 Shkup, Maqedoni  
Tel/faks: +389(0)2 3068 630  
i-mejl: [contact@openthewindows.org](mailto:contact@openthewindows.org)  
web: [www.openthewindows.org](http://www.openthewindows.org)

## **10. Post polio grupi për mbështetjen e Polio Plus - Shkup**

**Polio Plus** është organizatë qytetare multietnike dhe multikonfesionale e personave me ose pa hendikep e cila punon në lidhjen qenësore dhe arritjen e lirive dhe të drejtave themelore të personave me hendikep.

Misioni ynë është forcimi i vetëbesimit të personave me hendikep dhe krijimin e një shoqërie me mundësi të barabarta për të gjithë.

Misionin e realizojmë nëpërmjet të përfaqësimit dhe lobimit për ndryshim dhe përmirësim në legjislacion, arsim, punësimin dhe jetën e pavarur të personave me hendikep nga njëra anë, si edhe ngritjen e vetëdijes publike, afirmimin e kreativitetit të tyre dhe kontributin në bashkësi, nga ana tjetër. **“Polio Plus nuk udhëton vetë”**. Misionin tonë e realizojmë së bashku me të tjerët në shoqëri.

Kontakt:  
bul.Avnoj, nr 64. lok 2  
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë  
tel: +389 02 2400-544  
faks: +389 02 2400-544  
i-mejl: [polioplus@polioplus.org.mk](mailto:polioplus@polioplus.org.mk)  
web: [www.polioplus.org.mk](http://www.polioplus.org.mk)

## **11. Ambasada e Parë fëmijërore në botë Megjashi - Shkup**

**Ambasada e Parë fëmijërore në botë Megjashi - Republika e Maqedonisë është e themeluar me 29 Prill të vitit 1992** si organizatë ndërkombëtare joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijt.

**Ambasada e Fëmijëve Megjashi** punon në rrespektimin e personalitetit të fëmijës përmes mbrojtjes së të drejtave të tyre, përfaqësimit e interesave të fëmijëve dhe përmes pasurimit të jetës me përmbajtje të cilat fëmijërinë e bëjnë të sigurtë dhe krijuese.

**Ambasada Megjashi** me aktivitetet e saj kontriboi në zhvillimin dhe përforcimin e vetëdijes qytetare për të drejtat e njeriut. Ajo e rrënoi heshtjen për vuajtjet e fëmijëve, veçanërisht për keqtrajtimin fizik, seksual dhe ekonomik të fëmijëve, duke shfaqur në publik më tepër raste të

keqtrajttimeve dhe duke i angazhuar direkt për mekanizma për mbrojtjen e fëmijëve.

Kontakt:

Kosta Novakoviq 22a, 1000 Shkup

Republika e Maqedonisë

tel. +389 2 2465 316

faks. +389 2 2463 900

i-mejl: [info@childrensembassy.org.mk](mailto:info@childrensembassy.org.mk)

web: [www.childrensembassy.org.mk](http://www.childrensembassy.org.mk)

## **12. Phurt - Delçevë**

**Phurt Delçevë** është organizatë joqeveritare dhe joprofitabile e cila punon në promovimin e të drejtave të fëmiut dhe të njeriut, dhunën familjare, tregtinë me njerëz.

Kontakt:

ггyл. Skopska nr.3

2320 Delçevë, R.e Maqedonisë

Tel : +389 (0) 33 412 337

Faks: +389 (0) 33 413 041

i-mejl: [phurt@t-home.mk](mailto:phurt@t-home.mk)

## **13. Këshilli për preventivë kundër delikuencës për të mitur (KPKDM) - Kavadar**

KPKDM është e themeluar në vitin 1996, ndërsa aktivitetet kryesore janë me qëllimqë të luftojnë kundër të gjitha formave të sjelljeve asociale dhe sjelljen e të rinjve në Kavadar. Puna e KPKDM kryesisht është e ndarë në dy sektore:

- Sektorin kuridik i cili punon në përmirësimin e pozitës së të miturve në kuadër të sistemit për të drejtat e të miturve, përmes ndryshimeve dhe përmirësimeve të së drejtës për të mitur, legjislacionit, si edhe implementim adekuat të mëtejshëm;
- Sektori për të rinj, qëllimi i të cilit është që ta organizojë kohën e lirë të të rinjve në Kavadar dhe në vendet përreth, i cili u siguron mundësi të ndryshme që të kyçen të rinjtë në forma të ndryshme të aktiviteteve dhe edukimit joformal.

Kontakt:

Salla Sportive "Jasmin" rr. Braça Haxhi Tefovi 28

Kavadar, R e Maqedonisë

Tel/Faks: +389 (0) 93 412 947

i-mejl: [sppmd@mt.net.mk](mailto:sppmd@mt.net.mk), [contact@sppmd.org.mk](mailto:contact@sppmd.org.mk)

web: [www.sppmd.org.mk](http://www.sppmd.org.mk)

#### **14. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë - Shkup**

**Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë (KHM)** është organizatë joqeveritare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pa orientim politik dhe religjioz. KHM bën monitorimin e gjendjes me të drejtat e njeriut, ofron ndihmë juridike qytetarëve në rastet e thyerjes ose kufizimit të të drejtave dhe lirive, bashkëpunon me organizata tjera dhe me organet shtetërore në drejtim të rritjes së promovimit, rrespektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. KHM tenton që të kontribuojë për rritjen e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe përmirësimin e kushteve për praktikim dhe mbrojtje, me çka kontribon në zhvillimin e demokracisë dhe sigurimit të paqes.

Kontakt:

rr. Dame Gruev nr.8/5, 1000 Shkup,

Republika e Maqedonisë,

tel/faks: + 389 (0)2 3119 073, + 389 (0)2 3290 469

i-mejl: [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

web: [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)

#### **15. HOPS Opcione për jetë të shëndoshë - Shkup**

HOPS - Opcione për jetë të shëndoshë është organizatë joqeveritare, joprofitabile dhe jopartiake e cila filloi me punë si projekt i Republikës së Maqedonisë për këmbimin e pajisjeve për injektim në vitin 1997. Prej atëherë ka zhvilluar programe për: zvoglimin e dëmeve bga përdorimi i drogave, preventim nga HIV/SIDA dhe sëmundje të tjera seksuale dhe nëpërmjet të gjakut, riintegrim social dhe risocializim i të rinjve dhe grupeve tjera të ndijshme në Republikën e Maqedonisë.

kontakt:

web: [www.hops.org.mk](http://www.hops.org.mk)

## **16. Shoqata humanitare Nëna - Kumanovë**

Shoqata humanitare ‘Nëna’ nga Kumanova funksionon që nga viti 1992. E formuar si reaksion i nevojës që të ndihmohet në kohën e shkatërrimit të ish jugosllavisë ‘Nëna’ ka organizuar aksione të shumta për refugjatët në luftat në Bosnë dhe Hercegovinë, në Kosovë, në krizën në Maqedoni. Për personat e zhvendosur nga rajoni i Kumanovës, kriva Pallankës dhe vendeve për rreth janë organizuar aksione për distribuimin e ushqimit, ilaçeve dhe mjeteve tjera të përditshme ndërsa një pjesë e aktiviteteve kanë qenë edhe organizim për vendosje në familjet nëpër shtëpi, rikonstruim të shtëpive shoqërore, risocializim të fëmijëve dhe grave, ndërsa pas konfliktit në vitin 2001, edhe organizimin e punëtorive psikosociale për femrat.

Kontakt:

rr. Gjorçe Petrov, nr.33

Kumanovë

tel. +389 (0) 31 421 341

faks +389 (0) 31 411 088

i-mejl: [vavku@fremail.com.mk](mailto:vavku@fremail.com.mk)

## **17. Organizata Humanitare dhe mirëbërëse e Romëve në Maqedoni Meseçina - Gostivar**

**Organizata Humanitare dhe mirëbërëse e Romëve në Maqedoni Meseçina - Gostivar** është shoqatë qytetarësh e cila është e formuar dhe jep kontribut për integrim social, participim efektiv dhe të barabartë në të drejtat demokratike dhe potenciale të rezervuara për bashkësinë e Romëve, në nivel Nacional dhe lokal, nëpërmjet të forcimit të kapacitetit, përmbajtjes direkte dhe përfaqësimit të Romëve.

Meseçina punën e saj e bazon në 4 sektore edhe atë:

- Arsim
- Integrim socio-ekonomik dhe edukim plotësues të grupeve të marginalizuara
- Të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet ndëretnike, tolerancën dhe dialogun
- Informimin, koordinimin dhe zhvillimin e vetëdijes publike dhe politikës

Kontakt:

rr. Braça Gjinoski 26

1230 Gostivar, Republika e Maqedonisë

tel: +389 (0) 42 22 22 71

tel/faks: +389 (0) 42 22 22 72  
i-mejl: [meseцина@mt.net.mk](mailto:meseцина@mt.net.mk)

## **18. Shoqata Humanitare dhe mirëbërëse për Romët në Maqedoni Mesečina - Dibër**

**SHHMRM „mesečina“ Dibër** është organizatë qytetare e depolitizuar, joprofitabile dhe humanitare misioni is ë cilës është:

Zhvillimi i resurseve materiale njerëzore dhe distribuimi i tyre deri te grupet qëllimore në pjesën e veprimit nëpërmjet projekteve dhe programeve të finansuara nga donatorë të ndryshëm nga vendi dhe jashta tij.

SHHMRM „Mesečina“ punon në (sektoret) programet: Arsim, të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet ndëretnike dhe dialog, integrim Ekonomik të grupeve të marginalizuara dhe edukim shtesë, program për ambientin jetësor, Informim, koordinim në vend dhe krijimin e vetëdijes publike dhe politikës, Sektor për ndihmë urgjente (ky sektor punon vetëm në fatkeqësi elementare ose lloje tjera te fatkeqësive).

Kontakt:

rr. Velko Vllahoviq p.n.  
1250 Dibër, Republika e Maqedonisë  
tel: +389 (0) 46 631 496  
faks: +389 (0) 46 631 496  
i-mejl: [meseцина.d@yahoo.com](mailto:meseцина.d@yahoo.com)

## **19. Qendra për bashkpunim Ballkanik “Loja” - Tetovë**

**Qendra për Bashkpunim Ballkanik “LOJA”** filloi që të punojë si organizatë joqeveritare në tetovë në vitin 1999. Në periudhën 10 vjeçare aq edhe sa egziston punon në dy sfera kryesore; kulturë dhe edukim.

Në kuadër të sferës së kulturës organizon ekspozita të fotografive dhe pikturave, prodhon filma dokumentarë të shkurtër dhe organizon kino shfaqje, me çka paraqet vendin e vetëm ku qytetarët e Tetovës mundën që të shkojnë në kinema. Në kuadër të edukimit punon në projekte të ndryshëm të cilat e promovojnë edukatën joformale. Proektet si grupe qëllimore i kanë fëmijët nga foshnjoret dhe profesorët univerzitar. Njëra nga qëllimet kryesore, por edhe mission i organizatës është që nëpërmjet të aktiviteteve të saja të promovojë bashkëpunimin ndëretnik, rrespekt dhe tolerancë. Organizata gjithashtu punon edhe në nivel internacional me çka

në mënyrë direkte merr pjesë në organizimin e më tepër këmbimeve nacionale ku si target grup janë të rinjtë.

Kontakt:

rr. Ilindenska 18-a, Tetovë

tel: +389 (0) 44 352 970

i-mejl: [cbcloja@cbcloja.org.mk](mailto:cbcloja@cbcloja.org.mk)

## **20. Qendra për inicijativa qytetare - Prilep**

**Qendra për inicijativa qytetare (QIQ)** në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, organizatat qeveritare dhe biznes sektorin i motivon qytetarët që të veprojnë në ndërtimin e shoqërisë civile në RM dhe më gjerë. Qëllimi kryesor i QIQ-së është që të gjitha qytetarët të kenë të drejta të barabarta, të jenë të kyçur në proceset e vendimmarrjes dhe të kenë qasje të barabartë në arsim.

QIQ organizon aktivitete të ndryshme dhe projekte që ti arrijë këta qëllime duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve maqedonas në procesin e ndërtimit të një shoqërie më të hapur dhe më demokratike.

Kontakt:

rr. Dimo Narednikot p.n. (ndërtesa Erik)

7500 Prilep, republika e Maqedonisë

tel: +389 (0) 48 400 480

faks: +389 (0) 48 425 125

i-mejl: [ccimk@t-home.mk](mailto:ccimk@t-home.mk)

web: [www.cgimk.org.mk](http://www.cgimk.org.mk)

## **21. Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve - Shkup**

**Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve** është organizatë e cila parimisht merret me hulumtime dhe edukime, të bazuara në qëllimet kryesore vijuese:

- Tu ndihmoje qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që të marrin rolin më aktiv në zgjedhjen e konflikteve që duken të pazgjidhshme, të rrënjosura në dallimet etnike dhe dallimet tjera; dhe
- Promovimin e konceptit të të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, si pjesë e rëndësishme e politikës, transformimit gjyqësor dhe shoqërorë i cili ndodh në shtet.

Arritja e qëllimeve themelore, është e bazuar në marrjen e hapave dhe aktivitetëve të ndryshme në tre lëmitë kryesore: të drejtat e njeriut, zgjidhja e konflikteve dhe marrëdhëniet ndërrnike.

Kontakt:

rr. Dame Gruev 8, Shkup

tel: +389 2 3290 377

i-mejl: [ecrp@mol.com.mk](mailto:ecrp@mol.com.mk)

## **22. Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë**

Qendra për zhvillim të qëndrueshëm “Porta” -Strumicë, është shoqatë qytetarësh, pasardhëse e Qendrës për mbështetjen e OJQ-ve në Strumicë i cili ishte projekt i Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni dhe Agjencionit Evropian për Rekonstruim në periudhën prej vitit 2003 deri në vitin 2006.

Misioni i organizatës është zhvillimi ekonomik i rajonit të Strumicës nëpërmjet mbështetjes së sektorit qytetar, zhvillimin e bujqësisë dhe popullarizimin e përmendoreve kulturoro historike dhe pasuritë natyrore.

Kontakt:

rr. Blagoj Jançev Muçeto p.n.

(Shtëpia e ARM-së) 2400 Strumicë

tel: +389 34 326 832

faks: +389 34 326 831

i-mejl: [mnikolov@sonet.com.mk](mailto:mnikolov@sonet.com.mk)

[rstevanov@sonet.com.mk](mailto:rstevanov@sonet.com.mk)

[ruzica\\_matkova@hotmail.com](mailto:ruzica_matkova@hotmail.com)

## **23. Shellter qendra – Shkup**

Qëllimi i Shellter qendrës është që të kontribojë për përparimin e lënies pas dore të të drejtave të femrave për një kohë të gjatë në republikën e Maqedonisë nëpërmjet të dhënies së mbështetjes, mbrojtjen dhe promovimin e zhvillimit të rendit social, politik dhe juridik në të cilin të drejtat e njeriut rrespektohen, ndërsa të drejtat e grave janë të mbrojtura.

Aktivitetet tona janë të bazuara në programet vijuese:

- dhuna familjare
- keqpërdorimi seksual dhe shëndeti reprodutiv
- Qendra për të drejtat e grave



- Zhvillimi ekonomik i grave

Kontakt:

Bozhidar Axhijata 1-1/6;

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel: +389 2 2772-400; 75 520-639

i-mejl: [contact@sheltercentar.com.mk](mailto:contact@sheltercentar.com.mk); [contact@merc.com.mk](mailto:contact@merc.com.mk)

web: [www.sheltercentar.com.mk](http://www.sheltercentar.com.mk); [www.mwrc.com.mk](http://www.mwrc.com.mk)